

Albanian BookFest, një nismë historike e lindur nën kujdesin e Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës “Vatra”, po shënon një moment që shumëkush e ka pritur prej kohësh: kthimin e librit shqip në zemër të diasporës. Për herë të parë në Shtetet e Bashkuara, libri shqip ngrihet në pedestal jo si një kujtim i largët që merret me vete nga udhëtimet në Shqipëri, por si një realitet i prekshëm, i gjallë, i afërt.

Panairi i Parë i librit shqip në New York

Dr. Pashko R. Camaj

Sekretar i Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës-Vatra

BUSTINA E KAMOMILIT
Pop-Culture Shqiptar mes
Kinostudios dhe Tik-Tok-ut
Andreas Dushi (fq. 5)

SHËNIME MBI LIBRAT

“Rrethi i përsosur”
i Suzana Varvarica Kukës
Nga Giada F. Kuka (fq. 8)

“Aventurat e Jung Xhoshit: Kalabashi i artë”
nga Constant van Graan, “Ombra GVG”

Një aventure sa e bukur
dhe e mrekullueshme po aq
e fortë e dhe egër.

Nga Sonila Strakosha (fq. 12)

Fati i figurës femërore në letërsi
dhe dy gratë që urdhëruan
vrasjen e Gjon Pagëzorit

Nga Orin Maxhari (fq. 22)

Fate Velaj në Panairin
e Librit në Vjenë

(fq. 3)

Një kolazh me poezitë e Migjenit, Camajt dhe Pipës
interpretohet nga studentët

“Teatri poetik” në Universitetin
e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

(fq. 3)

Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe
Albanologjike e Akademisë së Shkencave
të Shqipërisë i bashkohet Rrjetit
Evropian të Enciklopedive

(fq. 5)



Dekalog me poetin Prengë Maca

Bisedoi: Tefë Topalli

(fq. 6)

Poetin Prengë Maca e kam njohur nëpërmjet dy-tri cikleve me vjersha që ka botuar “ExLibris”. Kërkoja ta njoh për së afërmi dhe ai, në mënyrë origjinale, m’u shpreh që, më shumë se të fjalët e tij, mund të bazohesha në disa përmbledhje poetike, të cilat e paraqisnin para lexuesve dhe studiuesve.

Përkthimet “dramatike”
të AKILE TASIT
Nga Stefan Çapaliku (fq. 4)

Memecëria
zanafillore e fjalës
poetike: poezia
e Osip Mandelshtamit

Nga Noel Boci



(fq. 23)

BIBLIOTEKË

Xheni Shehaj (fq. 9)

Letër F-së

Mark Simoni (fq. 14)

Mrekullitë e qyteteve të vogla

Mehmet Elezi (fq. 15)

Anja Karenina

Atë Pjetër Meshkalla S.J. (fq. 16)

Kanga e Aristotelit

Linda Maria Baros (fq. 18)

Asnjë burrë nuk të mbrojti

Përktheu : Anton Papleka

Amshim dhe poezi (fq. 17)

Përktheu: Xhoina Salaj

Yuliya Musakovska (fq. 19)

Fjalët

Poezi | Përktheu: Vlora Konushevc

Marija Dejanovic (fq. 20)

Islandë

Poezi | Përktheu: Alma Braja

Arben Meksi (fq. 16)

Karikatura e së shtunës

In memoriam në 55-vjetorin e ndarjes nga jeta të aktorit

Bexhet Nelku - ky visar i heshtur
në pelikulën e kinemasë shqiptare

Nga Ilir Çumani (fq. 10)

Albanian BookFest, një nismë historike e lindur nën kujdesin e Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës “Vatra”, po shënon një moment që shumëkush e ka pritur prej kohësh: kthimin e librit shqip në zemër të diasporës. Për herë të parë në Shtetet e Bashkuara, libri shqip ngrihet në pedestal jo si një kujtim i largët që merret me vete nga udhëtimet në Shqipëri, por si një realitet i prekshëm, i gjallë, i afërt. Ky festival nuk është thjesht një panair, por një akt themelor, një hap i parë i një rruge që synon të ndërtojë një urë të qëndrueshme ndërmjet brezave, kulturës sonë dhe identitetit shqiptar në tokën amerikane. Ai është një nismë që e vendos Vatrën sërish në pozicionin që ka mbajtur historikisht falë figurave të ndritura si Fan Noli, Faik Konica, Kristo Floqi, Kristo Dako, Qerim Panariti, Xhevat Kallajxhiu, Arshi Pipa e tjere: avangardë e vlerave, arsimit, letërsisë dhe shpirtit shqiptar.

Ideja u lind nga një boshllëk i madh në jetën kulturore të komunitetit shqiptaro-amerikan. Për dekada me radhë, lexuesit shqiptarë në SHBA janë detyruar të presin vizitat në atdhe për t’u furnizuar me libra. Gjenerata të tëra janë rritur pa pasur pranë letërsinë e vendit të tyre, pa mundësinë të prekjen botën e Kadaresë, Fishtës, Camajt, Markos, Meksit, Mustafajt, Kongolit, Zhitit,

Panairi i Parë i librit shqip në New York

ALBANIAN BOOKFEST

Dr. Pashko R. Camaj,
Sekretar i Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës-Vatra

Blushit e dhjetëra autorëve të tjerë. Në këtë realitet, lindi mendimi se diçka e madhe duhej nisur—diçka që do të sillte librin shqip te lexuesi shqipfolës këtu ku ai jeton, studion, punon dhe rrit familjen e tij. Kjo ide u përqaftua menjëherë nga Vatra dhe udhëheqja e saj, duke shënuar nisjen e një projekti që synon të kthehet jo vetëm në një festë vjetore, por në një traditë që do të trashëgohet brez pas brezi.

Albanian BookFest është një dëshmi e forcës së bashkëpunimit në diasporë. Organizata studentore shqiptare pranë universiteteve

më të mëdha amerikane, shoqatat patriotike, shkollat shqipe, autorët e diasporës dhe shkrimtarët janë bashkuar për një qëllim të vetëm: t’i japin librit shqip vendin që meriton. Ky bashkim, i rrallë dhe frymëzues, tregon se komuniteti ynë ka potencial të jashtëzakonshëm kur punon i bashkuar, kur mban gjallë lidhjen me rrënjët dhe kur sheh kulturën si mision kombëtar.

Interesi i madh nga shtëpitë botuese, më prestigjioze të Shqipërisë, Kosovës dhe viseve shqiptare—Onufri, Toena, Buzuku, Dukagjini, Fishta e shumë të tjera—e



ngre akoma më lart peshën e këtij festivali. Disa prej tyre do të marrin pjesë personalisht në SHBA, të tjera do të dërgojnë stenda të plota librash, por e rëndësishme është që për herë të parë, pas kaq dekadash mungesë, lexuesit tanë këtu do të kenë akses të drejtpërdrejtë në botimet më të fundit, në letërsinë më të mirë, në frymën e gjuhës shqipe që i bashkon të gjithë shqiptarët kudo ndodhen.

Ky festival libri nuk është i destinuar të jetë një ngjarje e vetme. Është krijuar me synimin e qartë për të ndërtuar një traditë të re, të fuqishme, të qëndrueshme. Është menduar si një gur themeli i një epoqe të re kulturore për diasporën. Si ideator i këtij projekti, uroj që *Albanian BookFest* të shndërrohet në një aktivitet vjetor që do të udhëtojë edhe në qytete të tjera amerikane, aty ku komuniteti shqiptar është i gjallë, i pranishëm dhe në rritje. Nëse Noli e Konica do të ishin mes nesh sot, ata do të ndiheshin krenarë duke parë se si Vatra vazhdon të jetë, si dikur, zëri dhe ndërgjegjja kulturore e shqiptarëve në Amerikë.

Pikërisht për këtë arsye *Albanian BookFest* është më shumë se një panair libri. Ai është një moment kur diaspora jonë po vendos themelet e një trashëgimie që do të zgjasë për breza. Një hap i parë që do të hapë dyer të reja, që do të krijojë lidhje të reja, që do të frymëzojë fëmijët tanë të lexojnë në gjuhën e të parëve, që do të mbajë të gjallë një kulturë që ka jetuar përmes shekujsh. Kjo nismë i fton shqiptarët nga afër e nga larg të bashkohen në një festë të librit, të gjuhës dhe të shpirtit shqiptar. Është një ftesë për të ndarë gëzimin e librit, për të qenë pjesë e historisë, për të kontribuar në fillimin e diçkaje që do të lërë gjurmë dhe do të kthehet në një pasuri kulturore për komunitetin tonë në Amerikë.

Albanian BookFest është ëndrra që po merr formë, është zëri ynë i përbashkët, është gurthemeli i një trashëgimie që do të krenohemi t’ua lëmë brezave që vijnë.

OPENING: FRIDAY, NOVEMBER 28!

Albanian BOOKFEST® 2025

FEDERATA PAN-SHQIPTARE
E AMERIKËS - "VATRA"



- ◆ Rrënjët Shqiptare ◆ Albanian/American student organizations at: Seton Hall University, Saint Francis College, Montclair State University, Fordham University
- ◆ Shoqata Rozafa ◆ Shoqata Malësia e Madhe ◆ Grupi Rozafati ◆ Shoqata Ana e Malit ◆
- ◆ Qendra Kulturore Nënë Tereza ◆ Shoqata Kraja ◆ Shkolla Shqipe “Alba Life” ◆
- ◆ Shoqata Skënderbej, Inc. ◆ Shkolla Shqipe “Gjergj Fishta” ◆ Shoqata Bijtë e shqipes ◆

email: albanianbookfest@gmail.com

MOTHER TERESA ALBANIAN CULTURAL CENTER
at Our Lady Of Shkodra Church
361 W. Hartsdale Ave., Hartsdale, NY

EVENT HOURS:
Saturday at 12 PM to 7 PM and Sunday 1 PM to 7 PM



Një kolazh me poezitë e Migjenit, Camajt dhe Pipës interpretohen nga studentët

“Teatri poetik” në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Studentët e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” me shfaqjen “Teatër poetik” të paraqitur më datë 18.11.2025 para një publiku të gjerë, që përbëhej nga pedagogë, studentë dhe artdashës të tjerë të interesuar, treguan një anë të panjohur të tyre, pasionin për teatrin dhe poezinë. Në interpretimet që ata realizuan përmes një kolazhi poetik nga vepra e Migjenit, Martin Camajt dhe Arshi Pipës krijuan një atmosferë artistike dhe emocionale që përgjithësisht mungon në universitetet publike shqiptare.

E veçanta ishte se në këtë spektakël studentët: Savjana Vjerdha, Jetmir Mesi, Evis Muriqi, Amelja Krosaj, Jozef Marashi, Sidrit Doda, Nikola Brigaj, Erisona Hoxhaj dhe Kristela Lazri, vinin nga fakultete të ndryshme, si: Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Shkencave të Natyrës, Shkencave të Edukimit, Fakulteti Ekonomik dhe ai Juridik. Pra, letërsia dhe teatri treguan se mund të komunikojnë me të gjitha fushat dhe se studentët të talentuar mund të kërkohen në të gjitha fakultetet.

Në skenë u sollën tema me rëndësi aktuale nga vepra poetike e Migjenit, Camajt dhe Pipës, si: lashtësia dhe zakoni, peizazhi i trishtë alegorik, plagët sociale, mërgimi, harmonia fetare, identiteti kulturor dhe ironia filozofike e politike. Ndërkohë u harmonizuan interpretimi i testeve poetike me elemente dramatike, koreografike dhe muzikore që ishin një befasi për publikun.

Ky spektakël i solli tekstet poetike në një kontekst të ri dhe domethënës të kthimit të vëmendjes drejt vlerave të artit dhe letërsisë, por edhe drejt vlerave shpirtërore, etike e morale të trashëguara. Nuk munguan si interpretimet e çiltra të studentëve të talentuar ashtu edhe gjetjet dramatike skenike, si në rastin e përfshirjes së këngës arbëreshe “Moj e bukura More” si kolonë zanore e spektaklit përmes zërit të këngëtares Savjana Vjerdha, njëkohësisht edhe studente, ashtu edhe episode nga vargjet e Migjenit, “qeshu rini” që në fakt u drejtohen karrigeve që mbeten bosh, sepse “rinia e qeshur” e ka braktisur vendin e saj dhe është larguar në kërkim të një jete më të mirë.

Spektakli u organizua në kuadrin e projektit “Teatri poetik” me mbështetjen financiare të USH-së, nën drejtimin e pedagogut të Departamentit të Letërsisë, Gëzim Puka, aktorit të teatrit “Migjeni” të qytetit të Shkodrës, Astrit Fani, si dhe me konsulencën e pedagogut Arben Prendi. Falë përkushtimit të tyre, pas disa javësh prova me studentët, finalizuan një shfaqje që mund shërbejë si model për aktivitete të tilla, pse jo edhe si nxitje për të krijuar një trupë teatrore me studentët e këtij universiteti apo në bashkëpunim me studentët e universiteteve të tjera.

Nuk mungoi në këtë aktivitet edhe mbështetja e Rektorit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” prof.dr.Tonin Gjuraraj dhe e Zëvendësrektores, prof.dr. Blerita Dragusha, e cila mbajti edhe fjalën hapëse të këtij aktiviteti, duke inkurajuar studentët dhe pedagogët që edhe në të ardhmen të përfshihen në organizime të tilla me vlerë, në mënyrë që ato të bëhen traditë në jetën universitare.



Fate Velaj në Panairin e Librit në Vjenë

Në të njëjtën kohë me Panairin e Librit në Tiranë, u mbajt edhe Panairi i Librit në Vjenë – i cili, pas atij në Frankfurt dhe në Leipzig, është i treti më i madhi në hapësirën gjermanofolëse. Me 72.000 vizitorë (duke pasur parasysh se bileta e hyrjes kushton 24 euro), ky edicion shënoi rekordin e pjesëmarrjes ndër vite.

Në këtë panair morën pjesë të gjitha shtëpitë botuese austriake, si edhe më të rëndësishmet gjermane dhe zvicerane. Po ashtu, të pranishme ishin edhe institutet kulturore të shumë shteteve të përfaqësuara në Vjenë.

Një nga momentet kulmore të panairit ishte prezantimi i romanit “KREUZTANNE” të Fate Velajt (autor i shtëpisë botuese “Onufri”). Për këtë ngjarje, organizatorët rezervuan skenën kryesore të panairit – atë të televizionit qendror austriak ORF.

Për të diskutuar rreth romanit, vlerave të tij letrare dhe risive që ai sjell në letërsi duke trajtuar rrëfimin midis ngjyrave dhe imazheve, në skenë u ngjiten Robert Menasse, shkrimtari i madh austriak dhe fitues i shumë çmimeve ndërkombëtare, si edhe Katja Gasser, kryeredaktorja e kulturës në televizionin austriak.

Në një sallë me 400 pjesëmarrës, mes një dialogu të ngrohtë, plot emocione e reflektime mbi ngjarjet e librit, publiku duartrokiste herë pas here analizat dhe komentet mbi veprën.

Televizioni 3SAT (kanal gjermano–austriako–zviceran), në të vetmin reportazh që i kushtoi këtij edicioni të Panairit të Librit, u përqendrua pikërisht te risia e këtij viti: Fate Velaj.

“Kreuztanne” – romani që shtrin kufijtë e artit rrëfimtari

“Kreuztanne” është pjesa e parë e një trilogjie të bazuar në ngjarje të vërteta dhe në persona realë.

Romani i Fate Velajt shtrin kufijtë e formës së rrëfimit dhe dëshmon sa shumëplanësh mund të jetë romani: ndërmjet autobiografisë dhe fiksionit, historisë së migrimit dhe romanit të artistit, rrëfimit personal dhe vetëhulumtimit, studimit shoqëror dhe realizmit magjik. Teksti lëviz me një gjuhë të butë, poetike dhe njëkohësisht të kthjellët.

Kur i riu Fate vjen nga Shqipëria në Austri, fati i tij duket fillimisht si ai i shumë të rinjve migrantë. Nga kampi i refugjatëve në Traiskirchen, ai përfundon në një motel të humbur me emrin “Kreuztanne”, të fshehur mes maleve. Lexuesi njeh sfidat, vështirësitë, por edhe mundësitë që i shfaqen në këtë vend të ri.

Analizohet jo vetëm mënyra si e sheh shoqëria austriake të ardhurin, por edhe ëndrrat dhe shpresat e atyre që braktisin vendin e tyre për një jetë tjetër.

Por “Kreuztanne” është më shumë se një histori migrimi. Në një vend të panjohur, gjuhën e të cilit protagonist fillimisht nuk e flet, pa miq e pa të njohur, ai nuk ka asgjë tjetër përveçse magjepsjes ndaj botës së re që e rrethon dhe nevojës për të “zhytur duart në ngjyra”.

Të shohësh botën me sytë e Fate-s do të thotë të ndjesh tonet, kontrastet dhe dritëhijet e saj. E gjelbra e pranverës dhe portokallia përvëluese e vjeshtës, e kuqja e gjakut të një kaprolli të aksidentuar në fillim të librit dhe grija e lagësht e një ëndrrë ogurzezë nuk janë vetëm efekte stilistike. Ngjyrat janë simbole të kujtimeve dhe parandjenjave.

Përshkrimet shndërrohen në piktura impresioniste, forma abstrakte dhe peizazhe romantike. Piktura, në këtë roman, bëhet një mjet letrar.

Por ngjyrat e botës nuk janë vetëm mjete paraqitjeje. Në “Kreuztanne” ato shndërrohen në koncepte pothuaj mistike, të rrënjësura thellë në botë: ato lidhin ngjarje, pasqyrojnë intuata dhe i flasin lexuesit.

Kështu, ngjyrat shoqërojnë protagonistin nga ekspozitat e para, te shtatzënia e Klara-s, deri te vdekja tragjike e vajzës së tyre të parë gjatë lindjes.

Me lindjen e vajzës së dytë dhe me vdekjen e babait të autorit përfundon pjesa e parë e kësaj trilogjie, që rrëfen udhëtimin e Fate Velajt drejt të qenit artist.

“Kreuztanne” qëndron diku midis “Portreti i një artisti në rini” të James Joyce-it dhe autofiksionit modern.

Por mbi të gjitha, është historia e një njeriu që lë vendlindjen për t'i ndjekur ëndrrat; një njeriu që ëndërron një ditë të jetojë në një metropol, por që e gjen veten në një udhëkryq malor të Austrisë.

Aty ai detyrohet ta rigjejë veten, të bjerë dhe të ngrihet sërish, dhe në momente tragjdie, dëshpërimi e trishtimi, të mos e humbasë kurrë shpresën.

Është një histori e shkruar me imazhe të lindura nga gjak, djersë dhe lot.

Përkthimet “dramatike” të Akile Tasit

Stefan Çapaliku



Kund pesëdhjet vite më vonë se lindja e teatrit në territorin e Shqipërisë, dhe konkretisht në Shkodër, e më vonë në Korçë, shfaqet një intelektual i ri, i cili kishte vendosur që ta furnizonte skenën paraprofesioniste shqiptare me një tufë tekstesh të reja, bashkëkohore. Këto tekste qenë kurrë të para nga publiku shqiptar, dhe vinin kryesisht nga një kulturë e panjohur më parë, siç qe ajo anglo-saksonia. Ky zotëri i ri, aso kohe 40 vjeçar, quhej Akile Tasi.

Akile Tasi u lind më 1891 në Leusë të Përmetit. Ai ishte vëllai i vogël i ish-ligjvënësit, ish-ministrit dhe ish guvernatorit Koço Tasi. Arsimin e mesëm e nisi në qytetin e lindjes dhe e mbaroi në Boston. Atje u aktivizua me Federatën “Vatra”. Është i pranishëm në gazetën “Dielli”. Më 1929 kthehet në Shqipëri dhe më 1 tetor të atij viti emërohet bibliotekar i oborrit mbretëror. Më 1932 dhe deri më 1941 qe drejtor i Bibliotekës Kombëtare. Më 1943 u zgjodh deputet i Kuvendit Kombëtar dhe u emërua po ashtu drejtor i gazetës “Bashkimi i Kombit”. Më 1944 u emërua Ministër i Kulturës Popullore.

Akile ishte nga ata që nuk pranoi të largohej nga Shqipëria dhe u dorëzua vetë në fund të vitit 1944.

Ekzaktësisht një vit mbas kthimit në atdhe, më 1930, mbasiqë u njoh nga afër me lëvizjen teatrale

të kohës, Akile nisi punën me përkthimet e letërsisë dramatike në ndihmë të teatrit të sapolindur shqiptar.

Po kështu ai, më 1944 përktheu “Princi i lumtur e përralla të tjera” nga Oscar Wilde, që u botuan nga shtëpia botuese “Ismail Mal’ Osmani” në Tiranë.

Akile Tasi u dënua në gjyqin special më 13 prill të 1945 me 20 vjet burgim. Dënimin e vuajti në kampet e punës të Maliqit, Bedenit, Vloçishtit dhe në burgun e Burrelit. Ai vuante nga mëlçia e zezë dhe më pas edhe nga botkini. Kur e kapi kriza e botkinit e shtruan në infermierinë e burgut për dy ditë, dhe fill mbropa si shenjë kujdesi e futën në birucë, me një të ftohtë nën zero. Atje, i morën edhe kapotën dhe pa asnjë batanije a nënshtresë tjetër e mbajtën 7 ditë. Në birucë Akile mori një të ftohur fatal që i dha komplikacione te mëlçia e zezë, duke e kthyer në një cerozapatikë vdekjeprurëse.

Më pas, të gjitha lutjet me shkrim për një lirim të parakohshëm ju hodhën poshtë nga xhahilët komunistë. Vdiq mbas tre muajsh, më 30 janar të vitit 1961.

Sot, 61 vjet mbas vdekjes së tij na bie në dorë një dosje e ruajtur me shumë kujdes nga i nipi i tij, 97 vjeçari Lekë Tasi¹, me 11 dorëshkrime (10

¹ Lekë Tasi (Leusë, Permet, 1929), muzikant, piktor, shkrimtar dhe përkthyes. Person me profil të spikatur veçanërisht në fushë të artit pamor.

dorëshkrime dhe një material i daktilogruar) me përkthime tekstesh dramatike, të gjitha pjesë me një akt.

Po cila është lista e përkthimeve dramatike të Akile Tasit? Këtu po shënojmë listë prej njëmbëdhjet tituj veprash dhe tetë emra autorësh, të përkthyer nga Akile Tasi:

Constance Powell Anderson, “Shkret”
Constance Powell Anderson, “Zemra e Palaços”
Leonard Hines, “Zgjidhja”
J. A. Ferguson, “Campbell i Kilmhorit”.
Serafín Álvarez Quintero “Një mëngjes me diell”
Serafín Álvarez Quintero “Dona Clarines”
Eugen O’Neill. “Litari”.
Frederick Ferris, “Pa titull”.
Hermon Ould, “Kolombi”.
John Brandame, “Lulo Puku”.
John Hampden. “Mbreti thotë fjalën e fundit”.

Vëmë re që në krye të herës se Akile ka përkthyer emra shumë të rëndësishëm të çerekut të parë të shekullit të XX, një pjesë e të cilëve nuk kanë arritur të depërtojnë ende në teatrin e izoluar shqiptar. Kështu përshembull kemi emra si **Hermon Ould (1886-1951)**, i cili si poet dhe dramaturg shërbeu si forca lëvizëse për PEN klubin anglez që nga themelimi i saj deri në vdekjen e tij në vitin 1951. Ai



Akile Tasi, Prizren, 1942



Akile Tasi ne gjyq, 1945

shërbeu, fillimisht si sekretar ndërkombëtar i PEN International në Kongresin e Berlinit në vitin 1926 dhe deri dhe president i PEN International në vitin 1941.

Po kështu edhe autori tjetër **John Brandame**. Ai ishte pseudonimi i Dr. John McIntyre, i njërit prej dramaturgëve më të famshëm skocez, i cili i mbështeti të gjitha dramat e tij në malësitë e vendit të vet. Vepra e tij, si pjesë integrale e traditës është e populluar nga personazhe të prirur ndaj sjelljes së çuditshme, si: “St Leam Fhìn an Gleann” (1932), “Rory Aforesaid” (1926), “Ruairidh Roimh-Ainmichte” (1937), “The Change House (1921)” dhe “An Tigh-Osda” (1950), etj.

Dhe tani le të ndalojmë te disa prej veprave të përkthyer, duke vënë theksin kryesisht te dobishmëria e tyre aktuale në shërbim të teatrit shqiptar.

“**Campbell i Kilmhorit**” është një dramë me një akt e vitit 1913 e shkruar nga John.A. Ferguson, e cila pati shumë sukses fillimisht në Skoci dhe më pas në gjithë Anglinë dhe Amerikën e fillimit të shekullit të 20-të. Përmbajtja e dramës përqendrohet në kontekstin e saj historik, konkretisht periudha pas betejës së Culloden dhe shtypjes së kryengritjes Jakobine. Linjat e zhvillimit dramatik përfshijnë besnikërinë, sakrificën dhe tradhtinë, si dhe ndikimin korruptues të pushtetit shtetëror.

“**Një mëngjes me diell**” është një komedi e shkruar nga vëllezërit spanjollë, Serafin dhe Joaquin Alvarez Quintero. Ngjarjet e shfaqjes zhvillohen në një park në qytetin e Madridit në Spanjë ku realizohet takimi i rastësishëm i dy të dashuruarve të moshuar, Dona Laura dhe Don Gonzalo. Në zemër të shfaqjes është ironia e hidhur e vetë jetës. Të dy personazhet, që kishin qenë të dashuruar kur ishin të rinj, fati nuk i lidhi së bashku dhe ata nuk u panë më kurrë, deri në një mëngjes me diell në një park shumë dekada më vonë. Laura, e cila quhej Virgjëresha e Argjendit, tani është 70 vjeç, rri ulur në një stol dhe ushqen pëllumbat. Gonzalo vjen atje dhe i ndërpret rutinën, pa e njohur se kush është. Gonzalo i tremb zogjtë që Laura po ushqente duke e bezdisur pa masë. Të dy fillojnë të bisedojnë me njëri-tjetrin me tone të hidhura dhe sarkastike. Më pas rinjohja e tyre realizohet nëpërmjet citimeve të një libri që dikur e dinin përmendësh. Pastaj e kuptojmë se ata janë të vetëdijshëm se kush është personi tjetër, por ego nuk i lë të deklarohen. Kah fundi i tekstit kuptojmë se pse të dy e mbajnë sekret identitetin e tyre. Gonzalo dhe Laura largohen nga parku me një buzëqeshje, të rinuar pas takimit të tyre. Akti i të dyve që përkulen për të mbledhur lule është një kujtesë e së kaluarës së tyre të përbashkët, duke premtuar të takohen përsër.

“**Litari**” është një dramë me një akt nga Eugene O’Neill që flet për një fermer koprrac, Abraham Bentley, i cili i ngre një kurth djalit të tij plangprishës që po kthehet, Lukës. Kur Luka kthehet, konflikti ndizet dhe nis manipulimi i temave të hershme të O’Neill për mosfunksionimin familjar, lakminë dhe luftën midis baballarëve dhe bijve. Drama, e shfaqur për herë të parë në vitin 1918, ishte një pararendëse e veprave të tij të mëvonshme, më të famshme, dhe eksploron temat e identitetit irlandezo-amerikan dhe aludimet biblike, të tilla si historia e Abrahamit dhe Isakut.

Në përfundim të këtij përshkrimi të shkurtër mund të themi se aksioni i përkthimit të këtyre pjesëve dramatike nga ana e Akile Tasit, qe një gjë e jashtzakonshme për kohën. Ne nuk kemi dieni nëse ndonjë prej këture pjesëve të jetë vënë në skenë, por gjithsesi, ne mund ta konsiderojmë këtë aksion intelektual si fillimet hipotetike të teatrit modern shqiptar.

Gjuha e përkthimeve nuk ka pothuajse asnjë dallim me shqipen e sotme dhe të gjitha pjesët mund të luhen sot e kësaj dite në skenën shqiptare.

Faleminderit Akile Tasi. Ti e bërë tënden, dhe bashkëkombasit tuaj “ta shpërblyen” mundin...

Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë i bashkohet Rrjetit Evropian të Enciklopedive

Pas aplikimit në fillim të nëntorit, të gjitha vendet anëtare të Rrjetit votuan unanimisht për pranimin e QBEA-së si pjesë e tij.


Rrjeti Evropian i Enciklopedive (European Encyclopedia Network) është krijuar më 2022. Misioni i tij është t’u mundësojë anëtarëve të ndajnë përvoja rreth gjendjes aktuale dhe modelit funksional të enciklopedive, të identifikojnë fusha të mundshme për përmirësim dhe bashkëpunim dhe të kontribuojnë në rolin e enciklopedive për ofrimin e qasjes në informacion të besueshëm, të verifikuar dhe të lehtë për t’u gjetur, si dhe në rolin e tyre në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe kulturor, veçanërisht në lidhje me një sasi vazhdimisht në rritje të informacionit nga burime të ndryshme, shpesh të pabesueshme, dhe të kërkojnë qëndrueshmërinë financiare dhe teknike të projekteve.

Pjesë e këtij rrjeti janë disa prej instituteve enciklopedike dhe leksikografike më të rëndësishme dhe me traditë më të konsoliduar, si Treccani i Italisë, Brockhaus Enzyklopädie e Gjermanisë, Miroslav Krleža i Kroacisë e të tjera.

Aderimi i QBEA-së pranë EEN është një hap i rëndësishëm drejt bashkëndarjes së përvojave lidhur me enciklopedinë dhe fjalorin, dy prej projekteve madhore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

QBEA është krijuar në zbatim të VKM Nr. 821, datë 28.12.2023 “Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave në Republikën e Shqipërisë” dhe VKA nr. 3, datë 10.01.2024 “Për ngritjen e Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike”.

Aktualisht, qendra mbështet tre projektet madhore të albanologjisë, Historinë e Shqiptarëve, Fjalorin e Madh të Gjuhës Shqipe dhe Enciklopedinë shqiptare.



*Bustina e Kamomilit është një rubrikë joperiodike e shqyrtimit të disa situatave, prej shqetësimit të të cilave shpëtojnë vetëm pasi t’i kem shkruar.

Pop-Culture Shqiptar mes Kinostudios dhe Tik-Tok-ut

Andreas Dushi

Këtë panair, në një stendë, dikush në moshë fare të re po kërkonte një libër që, mesa duket, ishte botuar kohë më parë. Njeriu pas banakut të stendës i tha kërkuarit se libri nuk gjendej, por ai, i bindur, me kopertinën e librit në ekranin e telefonit, përsëriste se e kishte botuar ajo shtëpi botuese, ndaj aty do të ishte me patjetër. “Gërmo Tare, gërmo!”, tha njeriu pas banakut. Kërkuari i ri ngriti kokën. “Ça the?”, e pyeti. Tjetri pas banakut përsëriti sërish frazën që, rioshi s’e kuptoi. Unë u largova.

Kudo, ajo pjesë e gjuhës që mund të përmbledhet nën etiketën “Pop-Culture” sendërohet kryesisht mbi televizionin dhe kinematografinë. As rasti ynë s’ka si të bëjë përjashtim. Ndonëse brezat kanë ndryshuar dhe dinamikat që shoqërojnë secilin prej tyre bëhen gjithnjë e më të vrullshme, produktet e Kinostudios “Shqipëria e Re” nuk janë harruar. Të gjithë ne e kemi përdorur, të paktën një herë “Edhe akullore, edhe çokollatë” nga “Dy herë mat”, “Pupupupupu” nga “Pallati 176” (kjo, kam përshtypjen, s’ka qenë e Kinostudios... nejshe), “Shitën gomarin, blenë biçikleta e ç’u duket vetja.” nga “Zonja nga qyteti” dhe sigurisht, pompuar nga “Portokallia”, “Po me urën ç’patën xhanëm?” nga “Kur zbardhi një ditë”. Ka edhe plot të tjera, por s’është se po bëjmë një antologji me batuta filmash.

Ndërsa sot, meqë kinematografia shqiptare është pothuajse e paqenë dhe e nxjerr kokën me forcë vetëm kur një VIP krijon ndonjë komedi, ky burim i pop-culture-s është mbyllur ose ka ngecur diku. Edhe televizioni, prej vitesh, ripërtyp vetveten pa krijuar ndonjë gjë origjinale, përveç emisioneve që, njëjloj si kinematografia shqiptare, e nxisin shoqërinë vetëm për aq sa zgjasin dhe menjëherë harrohen. Në këtë kontekst, vërej se në Shqipëri, detyrën për ta furnizuar pop-culture-n e kanë marrë memet.

Faqe Instagrami dhe adresa Tik-Toku, në dy shtigje të ndryshme, e mbushin ditëpërditë me ca fraza parafabrike që mandej përdoren ndër diskutime jo vetëm informale: Njëri shteg është marrja e pasazheve nga emisionet televizive dhe nxjerrja e tyre jashtë konteksteve ku janë thënë për të krijuar ilaritet (e, mirë, media, disi, vazhdon t’i shërbejë pop-culture-s) dhe tjetri, ripërdorimi i fjalëve që personazhet e njohur në këto rrjete thonë kur flasin me njëri-tjetrin. Kështu, edhe në këtë nënshtresë me ndikim të rëndësishëm e njëkohësisht, si tregues domethënës i asaj çka shoqëria pëlqen, vërehet shkëputja e hershme e asaj hallke të komunikimit të njohur si “Arti i Pestë”. Unë besoj se, po të ekzistonte kinematografia dhe mundësia për të krijuar idhuj të vërtetë, nëse gjuha do të përdorej si mjet i shprehjes artistike nga skenaristë dhe do të lakohej ashtu sikurse duhet prej regjisorëve, mosdija, mediokriteti dhe mbi të gjitha e sidomos banaliteti i njerëzve të Tik-Tok-ut nuk do të gjente vend në diskursin e përditshmërisë sonë, as në kafene e jo më ndër medime serioze.

Prandaj, sa më shumë mendoj, aq më tepër bindem se shoqëritë funksionojnë sipas ligjësive strukturaliste dhe mjafton një lajthitje, sado e vogël, në cilindo hap të strukturës për të krijuar lëkundje në strukturën si një e tërë. Ose, për ta thënë më poetikisht, unë i besoj teorisë së fluturës që po rrahu flatrat në njërin anë të globit, mund të shkaktojë një katastrofë në anën tjetër. Flutura s’di të them cila është, por katastrofën e dëgjoj çdo ditë, sa herë përsëritet fjala “megalluks” e ku di unë.

1. *Në takimin e parë bashkë, mësova se keni kryer shkollën e mesme të Politeknikut, Tiranë; një shkollë profesionale shumë cilësore për kohën, por që nuk premtonte dhe aq për një edukim letrar në krijimtari; si shpjegohet që jeni përshkuar nga pasioni për letërsi?*

Kur mendoj jetën time dhe bëj një bilanc, çfarë ndodh me jetën e njeriut, mes asaj që bëjmë dhe asaj që duam, e ndermend gjithnjë thënieën e Gëtes:

“Të tjera duam,
Të tjerë na duan,
Në të tjera përfundojmë!”

Është e vërtetë se kam mbaruar një shkollë teknike më të mirën në vend, ku mbeteshe në klasë edhe nga letërsia. Në vitin e parë mësuesi i letërsisë na dha në këtë lëndë hartimin e parë. Unë e bëra në një vjershë dhe e dorëzova i pari. Ai e pa fletën, ma bëri me shenjë të prisja e pasi e lexoi, ngriti sytë e më tha, a është e jotja? Tunda kokën në shenjë pohimi. E ke shkruar përpara? Jo, në klasë, u përgjigja unë. Mirë më tha ai, bëj një tjetër me çfarë të duash ti, një temë që e zgjedh vetë!

U ula në bankë, bëra një vjershë dhe ia dhashë mësuesit. E lexoi, më pa në sy, vazhdoi leximin deri në fund, hapi regjistrin tek përfundimtarja e vitit dhe vuri një dhjetë. Të lumtë, më tha, ndiqe poezinë! Është një ëndërr e bukur! Atë çast u bëra i lumtur!

E kundërta më kishte ndodhur në qytetin, ku kam kaluar fëmijërinë. Kam bërë prova të shkruaj që i vogël. Ishim një grup nxënësish brenda një gare me vjersha. Ngadalë, ngadalë disa prej nesh u dorëzuan, por, mbetëm tre veta në fund të garave, ku shumë prej tyre u lodhen. Ne rezistuam, qëndruam rob të letërsisë, në lakun e poezisë.

Në klasën e shtatë kisha mbushur një fletore me vjersha, por nuk guxoja t’ia tregoja njeriut. I bindur, se po bëja gjënë e duhur, marr fletoren me poezi dhe trokas në deren e kabinetit, ku ishte mësuesi i letërsisë. Kam një fletore me vjersha, i thashë. Ulu, më tha ai. Ndërsa isha me një emocion fëmije para një gjykimi të një njeriu që mendoja, se do të më vlerësonte. Ai, pasa e lexoi fletoren time me vjersha, uli syzet në tavolinë, më pa sikur donte të më peshonte me kujdes dhe ma dha fletoren. Mirë, mirë.

Unë u nisa drejt derës, kur dëgjova zërin e tij të thërriste ermin tim. U ktheva me dorën në dorezën e derës, pa e ulur atë për ta hapur. -Ku i ke kopjuar këto?- më tha ai.

Më sytë e mbushur me lot, hapa derën dhe nuk e dëgjova më, ndërsa ai më thërriste nga brenda kabinetit të tij. Ndihesha si i shurdhuar nga zemërimi, nga gjykimi që sapo kisha marrë. - A kam mbaruar shkollë për letërsi? Para demokracisë, me një rekomandim nga lidhja e shkrimtarëve, bëra lutjet për të ndjekut Fakultetin e letërsisë. Nuk isha fort i preferuar, për shumë arsye dhe..... sekretarja e parë e atëhershme i hoqi vizë emrit tim, por ishte gabuar. Unë vazhdova të jem student i letërsisë gjithë jetën, edhe tani në këtë moshë jam një student i dashuruar me letërsinë dhe i përkushtuar asaj....

2. *A mund të flitet për një gjen trashëgimie nga prindërit e tu, apo të afërm të tjerë, në kallëzime, fjalë apo kuvende të urta, qoftë edhe brimtarë mortesh?*

Ati im ishte vëllai më i vogël i tre vëllezerve, nga një fshat, ku mendohet të ketë qenë shkolla e parë shqipe, më 1632, një shkollë laike, nën kujdesin e kishës. Të tre vëllezërit ishin instrumentistë të shkëlqyer të çiftelisë, fyellit, lahutës dhe zumbares.. Të tre këndonin dhe në shtëpi gjithmonë gjendeshin varur në mur instrumentat

(Poetin Prengë Maca e kam njohur nëpërmjet dy-tre cikleve me vjersha që ka botuar “ExLibris” gjatë dy viteve të fundit. Kërkova ta njoh për së afërmi dhe ai, në mënyrë origjinale, m’u shpreh që, më shumë se te fjalët e tija, mund të bazohesha në disa përmbledhje poetike, të cilat e paraqisnin para lexuesve dhe studiuesve. M’i solli të 7 vëllimet dhe kërkoi të dinte pse isha tërhequr ta njihja vjershërinë e tij. E kisha pëlqyer vargun e këtij krijuesi, para së gjithash nga gjuha lakonike e shprehjes dhe thelbit të motivit pse shkruan dhe kujt i drejtohet.....)

DEKALOG ME POETIN PRENG MACA

Bisedoi: Tefë Topalli

muzikorë të krahinës. Xhaxhain tim të madh, në një libër të shkruar për minierën e Rubikut, autori e ka quajtur *Shaljapini* shqiptar. Ai këndonte me një zë koke shumë të veçantë. Në fshat thuhej, se edhe me këndue në mort, ai nuk ta prish mortin. Në shtëpi, në fshat, këndoheheshin pjesa nga “Lahuta e malcis”, e cila ruhej fshehur në arkat e veçantave karakteristike të rrobave. Gjyshja ime ishte një vajtimore e rrallë, pra një krijuese e vajeve, të cilat improvizoheshin në çast, në këto raste, por e kam me të dëgjuar, sepse unë nuk pata fatin ta njoh, pasi ajo ndërroi jetë në mesmoshën e jetës.

Gjyshin tim, e thërrisnin në raste të veçanta, në ndarjen nga jeta të njerëzve të shquar, me bërtit në raste të tilla, një zakon jo fort i hasur në zonën tonë, por që ndodhte gjithsesi, ndoshta edhe si huazim prej krajinave të tjera. Uroj të mos kem gabuar në këtë gjë që them! Kur Eftim Dheri erdhi në një ekspeditë muzikorë në qytetin tonë fundor, ai u habit nga im atë, për tingullin e veçantë të çiftelisë, kur e dëgjoi dhe i bëri një kompliment të veçantë që qarkulloi në gjithë qytetin. *Ti je mjeshtër!* - i tha ai. Im atë kishte një bibliotekë modeste dhe ishte i dhënë pas librave. Meqënëse program i radios së atëhershme ishte shumë i kufizuar, im atë na lexonte me detyrim, gjysëm ore në ditë, “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur” dhe “Komisarin Memo.” Dhe bash në këtë ambient, ndjekur nga njëri - tjetri, mbeta përgjithnjë në kurthin e bukur të letërsisë.


Në këtë kurth gjendem njësoj edhe sot, si atëheri, gjithnjë, veçse ndërroj trajtë e asgjë tjetër. Dashuritë e vërteta kushtojnë shtrenjtë! Kjo është dashuria ime për letërsinë.

3. *Në botimet tuaja mbi 30-vjeçare, natyrshëm, ka shkëlqim dhe hijedrita përgjatë vargjeve; a do të dëshironit që,*

në librat shkollorë të ishte përzgjedhur ndonjë poezi e juaja; ç’mund të thonit që nëpër këto tekste nuk ka përfaqësime të krijuesve margjinarë (kështu po i quaj për arsye gjeografke), por vetëm një numër i kufizuar klasikësh tanë?

Natyrisht ka ardhur koha që shumë krijues duhet të jenë në tekstet e librave shkollorë, ka shumë poetë që e meritojnë këtë vend. Duke u seleksionuar, mendoj se ndonjë prej poezive të mia mund të jetë nëpër tekstet, sidomos pjesa e tyre që kanë një mënyrë të ndërtuar, duke u mbështetur paksa në folk. Mendoj, se kjo është puna e komisioneve të specializuara në vlerësimin e krijimtarisë së poetëve, për të cilët besoj se e kanë cilësinë e lartë të nivelit poetik. Ata që programojnë lëndët e gjuhës e të letërsisë në arsimin parauniversitar, ata duhet ta njohin këtë shqetësim...Fakti që shqipja është gjuhë e një populli të vogël, në hapësirën folëse ballkanike, gjykoj se është arsyeja, se pse poezia jonë mezi i kalon kufijtë e vendit.

Është e vërtetë, se emrat të veçantë e kalojnë kufirin e gjuhës së bukur shqipe, ndërsa flasin në gjuhë të tjera, por për mua Poezia dhe poetët e një vendi janë një pyll i mrekullueshëm, ku secila pemë dallon nga tjetra, duke përbërë kështu poezinë dhe poetët e një kombi. Kështu, i sheh gjithë bota poetët respektivë të vendeve të tyre. Mendoj, se ne duhet të mësojmë prej tyre në këtë fushë. Pyetja juaj është shumë e drejtë, ndaj duhet bërë e mundur zgjerimi i vendosjes nëpër tekste dhe uroj të ndodhë, duke ndryshuar politikat dhe qasjet e institucioneve përkatëse mbi këtë çështje jo pa rëndësi rëndësi. Kam pasur miqësinë e shumë poetëve, si Gjok Beci, Bardhyl Londo, Petrit Ruka, të cilët nuk janë më. Ata janë autorë të poezive të larmishme e plot vlera, lartësimi të kombit e vlerave të tij më të



mira.. Është i gjatë rrjeshti i atyre, të cilët e meritojnë të jenë nëpër tekstet shkollore, për vlerat e tyre të padiskutueshme, këngën e tyre në gjuhën shqipe, të cilës i kushtuan kohën e jetës së tyre.

4. *Si brez krijuesish në letërsi, i takoni atyre shkrimtarëve që kanë lëvruar dhe lëvrojnë vargun tradicional; si keni përqaftuar një tjetër lloj vjershërimi të lirë, shpesh, edhe pa shenja pikësimi, gjithnjë me shkronja të vogla...a mos ka lidhje me strofën kushtuar poezisë: “nuk e di/se si ndodh kështu;/a të krijoj unë/apo më krijon mua ti,/nuk e di se si!”*

Çdo njeri mendon se e gjen atë çfarë e përcakton si individualitet, herë - herë me kalimin e kohës ndryshojnë dhe format e shprehjes, ndryshon dhe logosi poetik. Është fakt, se në vëllimet e para kam më shumë poezi me vargun tradicional, por edhe më vonë nuk është se e kam tradhëtuar atë. Të shkruash në mënyrë tradicionale dhe të jesh modern, kur e bën këtë gja, kjo është çfarë vlen. Kam lexuar shumë poezi dhe vargu i lirë shpesh është çfarë e kanë shkruar poetët e mëdhenj të botës. Në një libër të përkthyer nga shkrimtari dhe përkthyesi i talentuar Agron Tufa, të një libri poetik të Paul Celane, kam lexuar dhe më ka mbet në mendje një poezi e tij:

*“Ta marrim fjalën,
Ta pastrojmë, ta lajmë
Ta kthejmë me fytyrë nga qielli!”*

Vargu i lirë e kursen atë çfarë në shumë poezi thuhet me aq shumë fjalë, të cilat nuk është se e bëjnë atë më të vleratë. Tek vargu i lirë gjejmë lirinë e një organizimi ndryshe, sa shpesh sjell ndërmend me këtë ndryshim stiles, teorinë mbi asimetrinë simetrike.

Përmbajtja është stofi me anë të cilit krijuesit e ndryshojnë modelin e prerjes, duke ruajtur harmoninë njëkohësisht; e kjo gjë ndodh sipas stinëve të ndryshme, sugjeruese të stileve si pasuri. Mbaj mend një dyvargsh të Ungaretit, i cili ishte pjesëmarrës në luftën e parë botërore. Më ka mbetur në mendje, si një gjetje e jashtëzakonshme, e thënë me pak vargje. Me anë të kësaj poezi ai thotë të gjitha për vete, për kohën, për botën. Këto dy vargje brenda një poezie të tij të shkurtër nuk mund t’i harroj kurrë:

*“Unë jam një qingj,
Veshur me lëkurën e ujkut.”*

Mendo një ushtar, si Ungareti i madh, me pushkë në dorë, duke pritë armikun.

Janë të rralla rastet dhe emrat e tyre të dëgjuar, kur jeta e një shkrimtari të madh nuk kalon nëpër vështirësi të panumrta të vetë krijuesit, shenjat të cilat ne i marrim shumë të rafinuara artistikisht, nëpërmjet personazheve të tyre, në rastet e poezisë



përmes rrjeshtave, ku ndjehet pulsi i shpeshtë, revolta e zemëruar, një zemër e ndjeshme në dashurinë, humbjen e saj, jetën dhe vdekjen, arti i madh i jetës njerëzore. Në këto raste ne e harrojmë, se çfarë stili ka përdorur autori, pasi na rrëmben arti i tyre. Po a mund të përkthehej “Mbreti i Tulës” në varg të lirë. Njëmijë herë do të ishte e pamundur. Një poet si Mjeda është shembulli i një poezie prej mjeshtri të madh dhe besnik i vargut klasik...I paarritshëm deri më sot!

5. Krijimet tuaja poetike nuk i shkojnë lexuesit të ndara në motive, siç bëhet në shumë përmbledhje me vjersha, a mund të flisni për motivet apo leitmotivin që ju shtyn në vargjet tuaja?

Libri ka një bosht ose më mire duhet të ketë një bosht. Unë i punoj shumë poezitë, sa një pjesë të madhe prej tyre i mbaj përmendsh. Natyrisht që nuk kam asgjë për ato që i ndajnë në cikle, por secili bën zgjedhjen e vet. Në jetën tonë janë të gjitha, gjërat banale të jetës, gjërat e shenjta, gjërat monotone, prej të cilave ushqehemi, dashuria, urrejtja, bashkimet, ndarjet, shpresat, dëshpërimet dhe ato vetë nuk janë fort të sistemuara, kjo është arsyeja që ne nuk e dimë kur do të na ndodhë njera ose tjetra. Kjo është arsyeja se pse nuk e ndaj librin me cikle, është zgjedhja ime të jenë bashkë të gjitha, por kjo nuk do të thotë se kam bërë zgjedhjen perfekte. Tek libri i fundit e kam bërë një seleksionim, njëfarë ndarje, të cilin ai që e lexon do ta vërejë e ta dallojë lehtë.

Në krye të çdo ndarje kam një poezi të shkurtër e me korsi të dallueshme që përcakton frymë e atyre pasuese.

6. Në bisedën tonë, kujtoj se më përsëritët shpesh “ky jam unë!”, lexuesve tuaj në poezi, dëshironi t’u përcillni veten tuaj (unin) apo edhe mesazhe kohe, shqetësimi, ardhmërie...?

Mendimi im është se ne duhet të shkruajmë veten, pavarësisht, se jo gjithnjë shkruajmë për vete. Përherë kam menduar dhe mendoj, se “poetë janë qenie qiellore, të zbritura në tokë me leje të jashtëzakonshme.” Nganjëherë gjykoj, se ne jemi ajo qenia ndërmjetëse, e cila shërben për të përcjellë kumtin përmes formës së zgjedhur tek secili, kumtin e diçkaje të rëndësishme jashtë nesh, që jehon përbrenda në mënyrë të pashpjegueshme. Desha ta përmend një gjendje të tillë në një poezi :

*Kur e shkruaj poezinë,
Mendoj se është e imja,
Pasi e publikoj atë,
E kuptoj , se jam i Asaj!*

Poezia e vërtetë e shkruan poetin. Poezitë më të veçanta janë ato, që në mënyrë të pavetëdijshme gjejnë formën e larmishme për t’u shfaqur para lexuesi. Libri duhet të jetë ti, nëse nuk ndodh kjo, mendoj se nuk janë në nivelin e duhur dhe nuk bëhet fjalë për një krijimtari të stilit të veçantë, se në fund të fundit në jemi stili vetë.

7. Në disa përmbledhje tuaja me vjersha, keni një ndarje formale me titullin “shkurtima”, një fjalë që gjendet vetëm në Fjalorin e vitit 1984, jo në Fjalorët e viteve të fundit; kështu, e përdorur prej jush në femërore, na vjen si neologjizëm; a mendoni se mjaft “shkurtima” ngjajnë si aforizma, apo hajku japonez? Pse ky pëlqim, kur ekziston rreziku që ato t’i shkojnë lexuesit si gjysmëproza?

Është e vërtetë, se tek librat e fundit, kam këtë emërtesë, e cila më ka ardhë natyrshëm, për llojin e asaj çfarë kam quajtur ashtu. Në



një bisedë në televizion me tregimtarin e veçantë Lazër Stani, bashkëbiseduesi i bëri një pyetje, se pse nuk ka një roman, por tregime të gjata, të cilët, sipas intervistuesit, tregimet tij kishin lëndën e një romani. Ai u përgjigj: nëse e thotë tregimi çfarë duhet, pse ta përcjell me një roman. Për mua Lazër Stani është një prozator nga më të talentuarit.

Shkurtimat janë një gjini e parapëlqyer e imja, për arsye, se unë kam bindjen se lexuesi i kujdesshëm dhe admiruesi i poezisë, kur lexon këto *shkurtima*, e mendon se si është ajo çfarë mund të ishte përtej atyre, nuk mjaftohet vetëm me leximin, por intensiteti i shprehjes ia prish monotoninë që provojmë kur lexojmë poezi të gjata, që sillen rreth thelbit. Në çast, kjo e shtyn lexuesin në imagjinatën e refleksionit të situates së krijuar.

Nuk mundohem kur shkruaj, unë mundohem kur punoj mbi vargun, pasi e shkruaj, me qëllim që të gjej një rregullim e sistemim të poezisë, të arrij zgjedhjen e fjalëve, sistemimin e tyre; kështu, në një farë mënyre, përcaktuese e poezisë, është se ajo shkruhet “pa dashje”.

8. Pyetje, si e ngjashme me një tjetër: vërejtje se në dy përmbledhjet “Koha mes nesh” (2008) dhe “Duke të pritur ty” (2020), ka vjersha shumë të bukura, mbështetur me rimë e metër; një lloj krijimi që në vëllimet e viteve të tjera, deri më sot, pothuaj, e keni braktisur, pse ndodh kjo?

Tek librat “Zjarr në eshkë” dhe “Ëndrrat në varka prej letre” gjenden shumë poezi me rimë, gjë që nuk e kam bërë me qëllim, por ato vetë e kanë kërkuar formën e tyre, për vetë natyrën e secilës. Ashtu kanë ardhur tek unë...Asnjëherë nuk e kam si qëllim në vetvete, ta braktis rimën, formën e rregullt të poezisë, por ajo që ndodh më vjen vetiu, është si të zgjedhësh mjetin, për të thënë diçka, për të deklaruar diçka. Vetë libri është një lloj deklarate e krijuesit, aq më tepër ai nuk e tërheq dot më atë që deklaroi, që shkruan.

Nuk pretendoj të jem në majat e krijimit, por duhet të jem i qetë dhe i sigurtë se kam bërë maksimumin e asaj që zotëroj.

9. Nuk shohim se në krijimet tuaja ka përpjekje për ndonjë poemë, lloj më i gjatë letrar në vargje, mos shpjegohet kjo me animin nga proza: tregime, novela,

apo edhe në narrativën e gjatë, siç është romani i vetëm juaji?

Nuk mendoj se ka ndodhur gjithnjë kështu. Kur ajo çfarë dua të them qëndron më gjatë, ma detyron vetë gjininë e poemës. Tek libri poetik “Ëndrra të vizatuara në qelq” janë katër poema, të cilat e kanë pasur vlerësimin e lexuesve, miqve të mi. Për mua, dallimi mes poezisë e prozë nuk është pengesë e pakalueshme. Proza kërkon përqëndrim, punë të madhe me gjuhën, kërkon impenjim dhe njohje të asaj çfarë trajton dhe përpiqesh ta tregosh. Kam provuar duke shkruar një roman “Një zemër e kursyer”. Skedat e këtij romani i kam pasë prej vitesh, nuk preferova t’i shkruaja thjesht si kujtime në qytetin ku kam kaluar fëmijërinë. Për çdo njeri, qyteti ku ka jetuar është magjik, natyrisht edhe për mua ndodh njësoj.

Për të mos qenë thjesht një libër kujtimesh, rasti e solli të gjej një mënyrë për ta trajtuar, si një roman të mirëfilltë. Më ndodhi që nuk e ruajta dot skemën e menduar në fillim të romanit. Personazhet “merrnin frymë” ndryshe nga sa mendoja unë, duke vepruar në situatë të ndryshme, të reja, jo *aq të bindura* ndaj meje, nuk më mbetej gjë tjetër, veçse t’i ndiqja pas në jetën e tyre. Jam autor i një libri me tregime, libër që pat zgjuar vëmendje nga autorë të njohur të letërsisë shqipe. Kur ia dërgova librin një autori mjaft pretendues në letërsinë e sotme, ai më tha diçka shumë të veçantë, gjë që as më kishte shkuar ndërmend ndonjë herë.

“Për arsye jashtë letrare, ju jeni i panjohur, por proza juaj më ka pëlqyer shumë!”

Nuk po e them emrin e tij, për shkaqe etike, por asokohe u ndjieva i vlerësuar, e natyrisht paksa i çuditur, se ku ndodhemi nganjëherë mes ushtrisë së madhe të autorëve jo për fajet tona, njëkohësisht jo për nivelin e letërsisë sonë...Ndoshta, ndoshta, për arsye krahinore, nëse mund të shprehemi kështu !

10. Jo pak shkrimtarë pohojnë se lexues dhe kritikë të parë të krijimeve të tyre, kanë bashkëshortet; Zonja e juaj është universitare e mësuese me përvojë në degën Gjuhë shqipe-Letërsi; a ndjeheni ju i mbrojtur në vështrimin gjuhësor për vjershërinë tuaj dhe është ajo konsulente juaja?

Bashkëshortja ime ka kryer studimet e larta për Gjuhë shqipe – Letërsi.

Më mbetet në mendje një takim me të madhin Petro Marko, me grupin letrar të shkollës në “ Harry Fullcin” e atëhershëm, sepse ne kështu e thërrisnin aso kohe, nën zë.

Petra Marko na tha : *“ Poezia është një tokë magjike. Të gjithë ata që shkruajnë mundohen të shkojnë atje. Duhet shumë talent e do shumë punë, por, po hyre atje, asnjëri nuk e zë më vendin tënd. Atje ka vend për të gjithë poetët që dallohen mes të tjerëve.”*

Pasi mbaroi takimin , ai më kërkoi, më thirri me emër, pasi kishte lexuar një poezi në këndin tonë letrar: *“ Prengu, më tha ai. Arti i letërsisë kërkon t’i kushtosh dashurinë, kohën, jetën. Nëse do të dish ta duash, do të jetë e jotja kjo “vajzë” e bukur me emrin letërsi.”*

E ndiej edhe sot dorën e tij mbi kokë, sepse janë disa gjëra që ndodhin një here dhe janë të përgjeshme. Kur shkruaj, dua të jem vetëm. Mendoj, se vetmia është atdheu i krijuesit.

Kur shkruaj, më bren dyshimi i asaj që po bëj, nganjëherë ndodh një periudhë, sikur kanë mbaruar gjithë fabulat dhe poezitë, por pastaj në pak kohë ndodh të hapet një tjetër derë dhe gjithçka shkëlqen ndryshe nën diellin e një optimizmi shpresëdhënës.

Natyrisht, pasi i shkruaj, libri do të jetë në duart e gruas sime, për të parë gjuhën. Është e pamundur të mos bësh gabime, kur shkruan, sepse krijimi të rrëmben, gjë që e bën të domosdoshme korektorin letrar. Ndodh, jo në pak raste, të marr edhe sugjerime, që e ndryshojnë për mirë poezinë. Ndërsa pres korigjimin, më pushton një frikë e lehtë, a ia ka vlej të ajo e shkruara apo jo. Pastaj vjen rasti i marrjes së korigjimeve. Korektorja ime, nuk më lavdëron, është e kursyer, por unë di ta lexoj atë që mendon ajo mbi librat e mi, sepse kemi dyzet vite së bashku. Ati i Letërsisë për mua është një fe. E besoj se ata që kanë shkruar librat e mëdhenj të letërsisë botërore e kanë pasur atë gjë të shenjtë, i kanë kushtuar kohën e jetës së tyre, pra jetën e tyre, sepse ne si qenie njerëzore jemi veçse kohë e asgjë tjetër.. Poezia është zhanri që të shkruan, ajo gjen atë shtegun, duke të zbuluar, ndërsa të jep lirinë për të treguar gjithçka ndodh Brenda teje. Arti në përgjithsi, poezia është çfarë të gëzon kur e shkruan dhe të bën të lumtur, kur e “humb tek admiruesi i poezisë dhe tek lexuesi.. kur ajo “bëhet” e tjetërkujt Dashuria është ngjarja, e cila, që të ndodhë, duhet patjetër të jenë dy vetë.

Edhe Arti i letërsisë është një Dashuri e madhe”

“Rrethi i Përsosur”, libri me tregime i autores Suzana Varvarica Kuka, që pati debutimin e tij në Panairin e Librit 2025, shënon hyrjen e saj në letërsinë shqipe, pas një karriere të gjatë si skulptore dhe historiane arti. Ky fakt nuk është thjesht biografik: është çelësi për të kuptuar mënyrën se si ajo shkruan.

Por fillimisht kush është Suzana?

Suzana Varvarica Kuka ka një rrugëtim kompleks artistik që përfshin skulpturën, studimin dhe krijimin letrar. Ajo kreu studimet në Akademinë e Arteve të Bukura në degën e Skulpturës Monumentale dhe ka punuar në fusha të ndryshme të arteve vizuale dhe filmike — si në Kinostudion “Shqipëria e Re” si piktores kostumesh, përkundër dëshirës së saj origjinale për të punuar vetëm në skulpturë. Gjatë kohës së saj në Kinostudio, ajo ka studiuar e punuar në terren, duke vizituar vende të ndryshme të Shqipërisë.

Përvoja në film dhe udhëtimet e shumta ndikuan thellë në perceptimin e saj: ajo mësoi të lexonte njerëzit, personazhet dhe natyrën, dhe më vonë këtë perceptim e solli në letër. Karriera e saj gjatë tranzicionit shqiptar (vitet 1990) është gjithashtu pjesë e formimit si artiste që duhet të rindërtojë veten e identitetin e saj artistik në kushte të vështira institucionale dhe sociale.

Për disa dekada, ajo ka qenë studjuese dhe kuratore arti pranë Galerisë Kombëtare të Arteve, ku ka kontribuar në kërkime të rëndësishme mbi historinë e artit shqiptar të shekullit XX, në ndërtimin e arkivave dokumentare dhe në organizimin e ekspozitave dhe retrospektivave kushtuar autorëve kryesorë të skenës shqiptare, për shumë prej të cilëve ajo ka botuar monografi studimore dhe ese, të cilat kanë zënë vend në trashëgiminë tonë kulturore.

Në punën e saj si skulptore, Varvarica Kuka është e njohur për trajtimin e trupit dhe formës njerëzore si hapësira reflektimi. Kjo marrëdhënie midis materialitetit dhe ndjesisë shfaqet edhe në krijimtarinë e saj letrare. Ajo i qaset figurës njerëzore jo si përfaqësim, por si proces — si kërkim i asaj që fshihet në sipërfaqe. Pikërisht ky vizion kalon natyrshëm në prozën e saj.

Përmes këtij debutimi letrar, autorja zgjeron fushën e krijimtarisë së vet, duke e zhvendosur konceptin e formës nga materiali tek fjala. Kjo e bën zërin e saj të veçantë në letërsinë bashkëkohore shqiptare — një zë që vjen nga dora e një skulptoreje, por që mendon si filozofe dhe shkruan si poete.

Rrethi si simbol filozofik dhe estetik

Rrethi është një nga figurat më të vjetra dhe më të ngarkuara me kuptime në historinë e mendimit njerëzor. Në çdo epokë dhe kulturë, ai ka shërbyer si simbol i unitetit, përjetësisë, harmonisë dhe lidhjes mes qiellit dhe tokës. Ai është forma e parë që njeriu njohu në natyrë — nga dielli e hëna, tek unazat e ujit e gjer tek sytë — dhe që më pas u kthye në formën më të përsosur të mendimit abstrakt.

Në Greqinë antike dhe Romën klasike, filozofët dhe arkitektët e përdornin rrethin për të shprehur përkryerjen. Rrethi tek Pitagora dhe neoplatonikët simbolizonte unifikimin e të kundërtave — fillimi dhe fundi, qendra dhe periferia, drita dhe hija. Ai ishte figura që përmbante botën në vetvete.

“Rrethi i Përsosur” i Suzana Varvarica Kukës

Nga Giada F. Kuka

Në matematikë, rrethi është figura e përsosur: çdo pikë mbi vijë është e barabartë në largësinë e saj nga qendra. Ai është simetri absolute — nuk ka fillim dhe fund të prerë. Në këtë pamje, rrethi teksa “mbyllet”, ende është i hapur — sepse vazhdon qarkullimin e të gjitha pikave rreth qendrës. Kjo metaforë matematikore është e pasur për përdorim literar: edhe kur duket se diçka mbyllet, ajo vazhdon brenda vetes lëvizjen. Në mënyrë paradoksale, rrethi — ndryshe nga katrori — nuk ka fillim as fund. Ai përfaqëson të përjetshmen, të pandalshmen, atë që nuk mund të matet me logjikën gjeometrike të kufizuar.

Në njeriun Vitruvian të Leonardo da Vincit, ky tension midis rrethit dhe katrorit bëhet metaforë e marrëdhënies midis kozmosit dhe trupit njerëzor. Leonardo kupton se është e pamundur që rrethi të vendoset plotësisht brenda katrorit, sepse janë dy sisteme të ndryshme matjeje: njëri përfaqëson rendin tokësor, tjetri dimensionin hyjnor. Për ta tejkaluar këtë kufi, Leonardo shtoi vetë njeriun si figurë qendrore — me krahët dhe këmbët e hapura që prekin njëkohësisht katrorin dhe rrethin — për të treguar se njeriu është qendra matëse e universit, ura midis materies dhe shpirtit, midis tokës dhe përjetësisë.

Ndërsa në filozofinë japoneze, rrethi i vizatuar me një tërheqje të vetme të fuqës — një linjë që mund të jetë e mbyllur ose e pambyllur — quhet ensō. Ai përfshin idenë që “perfeksioni” nuk është absolut dhe i ngurtë, por i përkohshëm dhe i hapur — një formë që pranon papërsosmëritë dhe vazhdimin. Ensō nuk kërkon që të mbyllet për të qenë i plotë.

Këto parime historike dhe filozofike të rrethit na ndihmojnë të kuptojmë pse Suzana zgjedh këtë simbol si titull dhe qendër filozofike. Ajo shpreh se perfeksioni nuk është pastërtia absolute, por zhvillimi i vazhdueshëm i formës që shikohet me sy të vëmendshëm. Si në ensō, tregimet e saj nuk kërkojnë të mbyllen në fund, por të jenë një qark që vazhdon — një dialog midis artit, trupit, heshtjes dhe fjalës.

Për heroinat e saj — gratë e braktisura, të heshtura, të ngulitura në përditshmëri — rrethi nuk është kurth, por strehë. Është një mënyrë për të rivendosur rendin në kaos, për të gjetur qendrën në një botë që të shtyn drejt periferisë. Për artisten që i ka krijuar, është mënyra për të parë jetën si proces — jo si figurë të përfunduar, por si formë që vazhdon të marrë frymë. Në këtë kuptim, rrethi nuk është kufi, por ekspozim — ai e bën të dukshme atë që njeriu është

qendra e përvojës së vet, me pikëpamje që përshkruan vetminë, marrëdhënien me instinktet dhe mënyrën se si arti mund të rindërtojë lidhjen.

Brenda realizmit magjik të Suzana Varvarica Kukës

“Rrethi i përsosur” nuk është një përmbledhje tregimesh në kuptimin klasik të fjalës, por një seri skicash letrare — tekste të shkurtra, të përqendruara, që funksionojnë njëkohësisht si imazhe dhe si rrëfime. Ashtu si një skulptor që hedh në letër vizatimet e para, duke kapur linjat e domosdoshme të një figure, edhe Suzana i qaset botës përmes një shikimi të prerë e të përqendruar tek detaji. Personazhet e saj nuk janë thjesht njerëz: ato janë trupa, lëkura, zëra, shenja. Një grua e braktisur rri e mbrojtur nga qentë e rrugës; një vajzë e humbur shfaqet si Venerë urbane; plehurat bëhen metafora e dhimbjes së përsëritur; përditshmëria e qytetit kthehet në një koreografi të zhurmshme ku çdo hap është i paracaktuar.

Ky është realizëm magjik i tipit të veçantë: realja mbetet e pranishme në gjithë ashpërsinë e saj, por papritur merr një përmasë të dytë, të padukshme, që shfaqet si alegori apo si metaforë e dhimbshme. Një qen nuk është thjesht qen; një trup nuk është thjesht trup. Gjithçka është njëkohësisht konkrete dhe simbolike.

Stili është i thjeshtë, por kurrë i thjeshtëzuar. Përshkrimi është i saktë, shpesh klinik, si bisturi; por pas tij qëndron një emocion i ngjeshur, një tronditje e përmbytur. Ky kombinim e afron autoren me prozën poetike të Clarice Lispector-it, me thjeshtësinë e mbushur me tension të Marguerite Duras-it, me vështrimin alegorik të José Saramago-s, dhe me aftësinë për ta parë realitetin si metaforë të Italo Calvino-s.

Në këtë debutim letrar, Suzana Varvarica Kuka na fton të hyjmë në një univers ku fjala bëhet figurë, ku shikimi bëhet rrëfim, ku çdo tregim është një skicë e prerë mbi letër — e thjeshtë në dukje, por e pasur në thellësi. Ka një moment, në secilin prej tregimeve të këtij libri, ku gjërat e zakonshme ndalen — dhe heshtja fillon të marrë formë.

Në “Rrethin e Përsosur”, realiteti është një sipërfaqe e lëmuar, por poshtë tij dridhet gjithmonë diçka — një kujtim, një dëshirë, një e pavetëdijshme që kërkon të dalë në dritë. Ky është realizmi magjik i Suzana Varvarica Kukës: jo magjia e ndodhisë së pamundur, por magjia e të zakonshmes, kur e sheh me vëmendje të plotë.

Si skulptore, ajo di se çdo formë lind nga heqja, jo nga shtimi. Ashtu janë edhe tregimet e saj: të shkruara me kursim, por me peshë. Çdo fjalë është e domosdoshme, çdo hapësirë e heshtur ka një kuptim. Në këtë mënyrë, proza e saj bëhet një akt meditimi: për trupin, për vetminë, për përpjekjen për të dalë nga rrethi i përsëritjes që jeta shpesh na imponon. Dhe ndoshta ky është edhe mesazhi më i thellë i librit — se rrethi i përsosur nuk është ai që mbyllet, por ai që vazhdon të kërkojë formën e vet. Në jetën, në dashurinë, në artin tonë, përsosmëria nuk qëndron në mbyllje, por në përpjekje. Në atë moment të vogël, kur dora e artistit — apo e njeriut — ndalon për një çast dhe pyet: A është kjo mjaftueshëm? Apo duhet të vazhdoj? Kështu, “Rrethi i përsosur” nuk është thjesht një libër tregimesh. Është një mënyrë për të parë botën: me sy që nuk mjaftohen me sipërfaqen, me duar që kërkojnë formën e brendshme të jetës.



“Rrethi i përsosur” — Metafizika e braktisjes

Në tregimin që mban titullin e librit, “Rrethi i përsosur”, ideja e formës dhe e përsëritjes merr dimension metafizik. Një grua ndjen se jeta e saj sillet në një qark të pambarimtë. Kjo grua është braktisur nga rrethi shoqëror, i cili e kishte mbajtur dikur të lidhur me njerëzit, por që tani e ka lënë krejt të vetme. Menjëherë rreth saj lind një rreth i ri, i krijuar nga qentë e rrugës, gjithashtu të braktisur, që e ndjekin, e rrethojnë dhe i ofrojnë dashuri instinktive dhe mbrojtje. Ky rreth nuk është i përsosur në kuptimin universal të fjalës, por ai është i përsosur për këtë grua, për nevojat e saj, për vulnerabilitetin dhe mbijetesën e saj.

Në matematikë, rrethi simbolizon harmoni, simetri dhe ciklin e jetës, ku çdo pikë ka lidhje të barabartë me qendrën, duke treguar se çdo rreth krijohet për t’i shërbyer asaj që gjendet në qendër. Filozofikisht, ai na kujton se perfeksioni nuk është një ideal abstrakt, por një koncept që lind nga konteksti dhe nevojat specifike – dashuria, mbrojtja, lidhja e njerëzve dhe instinktet e natyrës mund të formojnë një rreth që funksionon për dikë, edhe kur gjithë bota e ka braktisur. Psikanalitikisht, gruaja e panxënë përjeton një mbrojtje të re, një strukturë që lind nga instinktet dhe përkushtimi i qenve– një dashuri që është njëkohësisht ngushëlluese dhe nënshtruese, një formë e veçantë e përkujdesjes që nuk vjen nga njerëzit, por nga një botë tjetër me dinamika sociale krejt primitive. Qentë nuk janë thjesht kafshë; ata janë dashuria instinktive që lind nga braktisja, mbrojtja që nuk pyet për moral apo rregulla.

“Bisha A” — Anatomia e instinktit

Në “Bisha A”, Suzana Varvarica Kuka kthen përmbys çdo mit familjar që lidhet me pastërtinë, butësinë dhe nënën e shenjtë. Këtu, nëna është një luaneshe e vërtetë, që nuk njeh ndjenja të buta, por vetëm instinkt, dominim dhe trashëgimi. Në sytë e saj, “bisha e re” — vajza — është pasardhësja që meriton dashurinë dhe vëmendjen e saj, sepse ngjan me të. Ajo është pasqyrimi i forcës, egrësisë, dinakërisë, aftësisë për të sunduar. Në një skenë që lexuesi e ndien si alegorike, ajo i thotë vajzës: “Ti je si unë.” Kjo është një deklaratë dashurie e ftohtë, një vulë gjenetike, por edhe një ndëshkim për të tjerët. Ndërkohë, vëllai i madh, luani, është qenie e butë, reflektuese, që nuk përkon me modelin që nëna njeh si të vlefshëm. Pikërisht kjo e bën atë të padukshëm në shtëpi. Ai përjashtohet jo pse është më pak i dashur, por sepse nuk përsërit energjinë e nënës. Në këtë mënyrë, Suzana Varvarica Kuka përmbys një mit themelor të shoqërisë patriarkale: këtu nuk është babai që sundon, por nëna e egër që i përzgjedh pasardhësit sipas instinktit të vet të pushtetit.

Ndërsa babai-luan qëndron në prapaskenë, i mpirë, i zbutur, duke përfaqësuar atë që Jung do ta quante archetypin e babait të rënë — një figurë autoriteti që nuk e ushtron më funksionin e tij mbrojtës. Në këtë boshllëk lind një mutacion energjish, ku feminiteti bëhet forca dominuese, por jo përmes dashurisë — përmes kontrollit.

Filozofikisht, “Bisha A” është një studim mbi natyrën e pushtetit në marrëdhënie, mbi mënyrën si dashuria, instinkti dhe dominimi janë të pandashëm në strukturat familjare e shoqërore. Në plan psikologjik, është një tregim mbi komplekset prindërore, mbi mënyrën se si prindërit projektojnë veten tek fëmijët dhe dashurojnë më shumë pasqyrimin e tyre sesa vetë fëmijën.

Në këtë tregim, autorja e kthen familjen

në një ekosistem të instinktit: aty dashuria nuk është morale, por biologjike; pushteti nuk është i imponuar, por i lindur; dhe drejtësia nuk ekziston, sepse natyra nuk njeh drejtësi — njeh vetëm vazhdimësi.

“Jo, nuk do të desha të isha Eoli” — Etika e vëzhgimit

Ndërkaq te tregimi “Jo, nuk do të desha të isha Eoli”, tre prostituta udhëtojnë në traget, secila me historinë e vet, me barrën dhe lirinë e vet, dhe përmes tyre autorja vëzhgon fatin njerëzor — jo për ta gjykuar, por për ta kuptuar. Kur ajo thotë “Jo, nuk do të desha të isha Eoli,” është si të refuzojë rolin hyjnor të atij që fryn erërat e fatit. Autorja zgjedh të mos jetë zot mbi të tjerët, por dëshmitar. Kjo është filozofia e tregimit: të mos marrësh pushtetin mbi jetën e tjetrit, por ta njohësh jetën përmes pranisë së saj. Në fillim, narratori mendon se do të donte të ishte Eoli, zot i erërave, të mund të drejtonte stuhitë, të ndryshonte kursin e anijes dhe të shpëronte vajzat. Por shpejt kupton se fuqia absolute është një iluzion për njeriun: kudo ti çojë, edhe sikur të kthejë tragetin, edhe sikur të ndryshojë rrugën e tyre, asgjë nuk do të ndryshonte. Çdo brig, çdo qytet, çdo hap mbart të njëjtën dhimbje dhe realitet të shndërruar nga nevoja për mbijetesë.

Në fund, ajo kupton se ndoshta njeriu s’duhet të kërkojë të jetë Zot i erërave, por dëshmitar i tyre. Sepse ndoshta, kur përballemi me fatkeqësitë e të tjerëve — me ata që janë më ndryshe, më të humbur, më të lodhur — nuk na kërkohet t’i braktisim, t’i gjykojmë apo t’i drejtojmë, por t’i kuptojmë. Sprovat e tyre mund të kenë një qëllim që ne s’e dimë; dhe ndoshta, mënyra si i trajtojmë ata është, në të vërtetë, sprova jonë.

Bukuria dhe erotizmi i vajzave nuk është thjesht një mitizim i bukurisë apo një idealizim i trupit; janë trupa të shndërruar nga një realitet makabër, të shënuar nga historia e tyre si prostituta, ku çdo lëvizje dhe çdo pjesë e trupit tregon dhimbjen dhe shkatërrimin. Vetëm se një skulptore i sheh ndryshe: i sheh si modele në studion e saj, si trupa që mbartin linjat dhe hijeshinë e një vizatimi, të kapura me kujdes dhe respekt. Ndërsa kushdo tjetër i sheh thjesht këto vajza të zhveshura, ose gjykon, ose dëshiron, pa e kuptuar historinë dhe dhimbjen e tyre. Në këtë tregim, lakuriqësia nuk është thjesht një gjendje fizike, por një akt i dhimbshëm zbulimi. Këto gra, të zhveshura nga çdo mburojë, janë ekspozuar jo vetëm para syve të botës, por edhe para dritës që nuk di të falë apo të harrojë. Shoqëria i sheh si “prostituta” — trupat e tyre bëhen njëkohësisht projekcion i dëshirës dhe përçmimit. Por narratori i sheh ndryshe: jo si trupa të përdorur, por si modele në studion e saj, ku çdo shenjë, çdo rrudhë, çdo shikim i lodhur bëhet pjesë e një forme të shenjtë. Për botën, ato janë “vajza të zhveshura”; për artisten, ato janë forma njerëzore të një dhimbjeje që kërkon të kuptohet.

Tërësia te “Rrethi i përsosur” është një simbol që shfaqet si përfundim i këtij vështrimi pa gjykim. Ai përfaqëson momentin kur forma dhe kuptimi përputhen, kur artisti arrin ta shohë njeriun përtej moralit, përtej mëkatit, përtej rolit që i është dhënë. Në këtë rreth, gjithçka është e barabartë — prostituta dhe shenjtorja, modeli dhe piktori, mëkati dhe arti. Rrethi bëhet kufiri që s’e ndan, por i bashkon. Ai është simbol i mëshirës, sepse brenda tij nuk ekziston më paragjykimi, vetëm kuptimi. Në mënyrë të heshtur, ai rrëfen se bukuria e vërtetë s’është në pastërti, por në pranimin e të papërsosurit.

Dhe në fund, “Rrethi i përsosur” nuk është më vizatim, por vetë mënyra se si artisti mëson të shohë — pa dëshirë, pa gjykim, por me dhembshuri.

XHENI SHEHAJ

Letër F-së

(Nuk e di vendndodhjen e saktë. Me shumë gjasa në një nga qiejt)

I kja jote më theu në mijëra copa. E kisha menduar të largët, aq të largët sa nuk besoj se ka njësi matëse për të. E megjithatë ndodhi. Një fundtëtori. Me diell por i ftohtë. I ftohtë si rrahjet e zemrës tënde që po luftonin për jetën. I ftohtë si fryma ime që mend po ndalej, teksa të shihte në grahmat e fundit. T’u avita shpresëhumbur, me lotët mbledhur në sy, me duart që më dridheshin, për të të mbyllur sytë. Oh, dritë!

A i ke ndjerë të gjitha këto? Apo shpirti yt i bardhë po fluturonte qiejve në liri?

Njëzet e katër orëshin e kalova si në jerm. Sillesha mes njerëzve, nga dhoma në dhomë. Tymosja, lotoja, pa zë. E ndjeja praninë tënde tek sillej në dhomën ku rrinte arkëmorti. Dëgjoja vajet e grave, shihja trishtimin në sytë e burrave, prisja ngushëllimet e të gjithëve dhe nga brenda më vinte të ulërija. Një majë mali, vetëm, unë dhe dhembja ime për ikjen tënde. Unë dhe lotët e mi. Zhgënjimi im ndaj Zotit, dreqit, fatit, jetës. Lufta ime e brendshme për ta pranuar. Ende sot nuk e kam pranuar. Ti e di.

Nuk di të të them çfarë më dhambi më shumë: shkëputja e shpirtit tënd nga kjo jetë apo përcjellja në banesën e fundit tokësore. Nuk e di as nëse e ke dëgjuar britmën time teksa ndahesha prej teje. U përpoqa, të betohem. Por fytyra jote e zbehtë, qetësia që të kishte pushtuar, kurmi yt i ftohtë provokuan dhembjen time. Nuk munda dot pa të puthur, prekur, larë në lot. Mes tyre kaloi, shpëtoi dhe britma ime e dhembjes. Shpresoj të mos të të kem prishur qetësinë. Siç shpresoj që të më kesh dëgjuar e të kesh kuptuar se çfarë dhembje ke lënë tek unë.

Një vit e pak pa ty. Ndryshe e shoh jetën, veten, përditshmërinë. Nuk ka ditë që nuk të mendoj. Zërin, të qeshurën tënde i kam ende të gjalla në dhomat e kujtesës sime. Jeta vazhdon me të njëjtat probleme, halle e mërzë. E njëjta rutinë, i njëjti ritëm. Uroj që ti atje ku ke zënë vend të kesh një tjetër stil jetese. Hera - herës të shoh në ëndërr. E lehtë, e qetë, buzagaz, ashtu siç ishe në të vërtetë. Pastaj zgjohem vrikthi dhe më vjen të qaj. Herë të tjera ngre kokën dhe shoh qiellin. Se di nëse ke zënë vend në një pjesë të dukshme a je strukur në një cep nga ku mund të shohësh por jo të të shohin. Është e drejta jote, sidoqoftë.

Por të gjitha këto që të thashë nuk janë asgjë krahasuar me frikën time më të madhe. Dhe kjo vjen në ditët kur më mbytet malli e shpirti shkrehet në vaj. Atëherë më kaplon një frikë aq e madhe sa më duket se nga çasti në çast do humbas mendjen. E fus veten në labirinte të ngatërruara dhe medeoemos duhet të ndodhë një zhurmë a çfarëdoqoftë që të më kthejë në botën njerëzore. Frika që më mbërthen mendjen ka të bëjë me mundësinë e takimit me ty. Sa janë shanset që ne të takohemi në botën ku ti je tani? Po sikur, unë të degdisem në një tjetër cep e ti në krah të kundërt, si do t’ia bëjmë? Si do e gjejmë njëra - tjetrën? Ja kjo më tërbon. Ma mjegullon arsyen, m’i mpin ndjenjat dhe s’më lë të marr frymë.

Por dua ti besoj ndjesisë që më thotë se ti sheh e di gjithçka për mua. Ndaj e braktis veten në krahët e kësaj ndjesie dhe qetohem. Qetësia ime zgjat sa një udhëtim një javor. Dhe gjithçka përsëritet. Më thonë se ende se kam pranuar ikjen tënde. Kanë të drejtë. Nuk do pranoj kurrë ikjen tënde. Edhe pse kjo do të sjellë një jetesë gjysmake por siç dhe e përmenda në krye, ikja jote më theu në mijëra copa. E tashmë nuk mund t’i ngjis të gjitha.

Por edhe këtë ti e di. Ashtu siç di se sa shumë përpiqem të mbush zbrazëtinë që le pas. Përpiqem.

Nuk di në duhet të të them lamtumirë a mirupafshim. Po zgjedh këtë të dytën, tingëllon më butë, ngjall shpresën se kur të jetë koha e duhur do të rishihemi. Deri atëherë, fluturo qiejve e gëzoju lirisë.



Tirana e viteve '60 ishte një qytet në lëvizje të përhershme, ku ritmet e jetës përzienin historinë me ëndrrën për të ardhmen. Ishte një kohë ku çdo mëngjes dukej sikur riniste nga e para dhe çdo mbrëmje mbyllej si një faqe libri që i shtohet kronikës së qytetit.

Në ato vite, qyteti sikur zgjohej me një lloj padurimi të brendshëm, si një djalosh i ri që ka ende shumë për të thënë. Bulevardet hapeshin si skena të mëdha teatri, ku njerëzit kalonin si personazhe të një drame kolektive, duke i dhënë kuptim çdo çasti. Aroma e vjetër e qytetit, ajo që përzihej me kohën, me pasionet, me ëndrrat, dukej sikur frymonte në çdo dritë që ndizte qyteti në agim.

Rrugët e shtruara me pllaka shkëlqenin në diellin e mëngjesit, sikur mbanin në sipërfaqen e tyre kujtimet e hapave që kishin kaluar aty. Dyqanet e vogla shpërndanin aroma të bukës së sapopjekur, ndoshta aromën më të ngrohtë që mund të ketë një kryeqytet. Në kafenetë e ngushta, që mezi mbanin zërat e njerëzve brenda tyre, shpërthenin bisedat artistike, debatet politike, ëndrrat rinore dhe pasiguritë e kohës, duke u përzier me retë e holla të duhanit që ngjiteshin lart drejt tavanit.

Dhe aty, në atë harmoni të çuditshme midis zhurmës dhe qetësisë, midis rrëmujës së jetës dhe finesës së shpirtit qytetar, Tirana ngjante me një atelie të gjallë emocionesh, ku arti ushqehet nga detaji më i zakonshëm i përditshmërisë.

Çdo fytyrë që kalonte në rrugë kishte një histori për të treguar; çdo vështrim mbante brenda një ëndje pafajësi feminare, një kujtim, një ëndërr vezulluese të heshtur.

Ecejaket e kalimtarëve, thirrjet e fëmijëve dhe zërat e tregtarëve përziheshin me muzikën e radios që dilte nga dritaret me kanate të hapura, duke krijuar një melodi urbane, ritmike dhe të papërsëritshme të jetës së përditshme. Tirana e asaj kohe ishte një orkestër e madhe ku çdo njeri kishte rolin e vet, një qytet që gumëzhinte dhe jetonte me pasion, me energji dhe me një lloj naiviteti të bukur.

Në këtë simfoni të papërsëritshme, arti ishte më shumë sesa një profesion, mënyra me të cilën njerëzit e mbushnin boshllëkun e sotëm me shpresën për një të nesërme edhe më të bukur. Teatrot dhe kinematë e vogla, sipas kohës, ngjanin me tempuj të shenjtë, ku publiku hynte për të kërkuar emocionin, identitetin, forcën, një dritë të re në përditshmërinë e tyre.

Dhe pikërisht në këtë qytet të zhurmshëm e të madh, ku çdo rrugë

In memoriam në 55-vjetorin e ndarjes nga jeta të aktorit

BEXHET NELKU - KY VISAR I HESHTUR NË PELIKULËN E KINEMASË SHQIPTARE

Nga Ilir Çumani



kishte historinë e vet dhe çdo cep mbante një kujtim, një djalosh elegant, plotë hijeshi, me sy të zjarrtë dhe shpirt të ndjeshëm, nisi të shkruaj historinë e tij të shkurtër, por të paharrueshme. Quhej Bexhet Nelku.

Ai lindi në Tiranë, më 8 janar të vitit 1937, në një kohë kur arti shqiptar ishte ende në kërkim të identitetit të tij, ndërsa qyteti rritej mes ngjyrave të reja urbane dhe sfidave të kohës. Në këtë kryqëzim të epokave, në këtë ndërrim të kohërave, u formua talenti i një artisti që do të linte gjurmë të paslyeshme në teatrin dhe kinemanë shqiptare.

Në fëmijërinë e tij, Tirana ishte ende një qytet i vogël, me rrugë të qeta e shtëpi të ulëta prej qerpiçi, ku fëmijët luanin deri në mbrëmje, nën dritën e zbehtë të llampave. Askush s'e dinte atëkohë se ai djalë i qeshur kishte brenda frymën e një artisti që do të shndërronte jetën e tij në një rrëfim të jashtëzakonshëm. Por ai e ndiente. Në heshtje. Në vështrim. Në mënyrën si ndiqte gjërat që të tjerët i kalonin pa i vënë re.

Qysh në vitin 1957, kur ende ishte nxënës në Liceun Artistik "Jordan Misja", ai dha provën e parë të talentit të tij të rrallë me interpretimin në dramën "Orët e Kremlinit".

Atë mbrëmje, në sallën e vogël të teatrit, kur dritat zbeheshin ngadalë, një heshtje e rëndë, pothuaj ceremoniale, mbulonte publikun. Çdo fjalë e Bexhetit, çdo pauzë, çdo lëvizje ishte si një valë drithërimesh që përhapej mbi shikuesit, duke i përfshirë në një botë emocionesh që ai e zotëronte me një siguri, finesë dhe elegancë të admirueshme.

Kishte diçka të papërkthyeshme në mënyrën si dilte në skenë: një natyrshmëri e butë, e ndërtuar mbi një shpirt të qetë dhe një mendje të thellë... të thellë.

Publiku e përqafohej, e ndiqte dhe e besonte. Ai kishte arritur diçka që shumë artistë të tjerë e kërkojnë për gjithë jetën: lidhjen e menjëhershme me spektatorin.

Ishte një aftësi që nuk mësohej vetëm me shkollë; ishte një dritë thellësisht e brendshme që përshkonte çdo gjest dhe tingull të fjalës së tij, duke e bërë teatrin të gjallë, frymëmarrës dhe të paharrueshëm.

Pas diplomimit, në shtator të vitit 1963, Bexhet Nelku u pranua aktor në Teatrin Popullor. Në çdo skenë ku shfaqej, ai transformohej në një univers të ri, ku realiteti dhe emocioni bashkoheshin natyrshëm, pa kufij, pa sforcim, si një artist që e ka të shkruar talentin në ADN-në e tij shpirtërore.

Në prapaskenë, kolegët thoshin se ai kishte një mënyrë krejt të veçantë për t'u përgatitur: heshtte, qetësohej, mblidhte veten, sikur përgatiste shpirtin e tij para se të takonte shpirtin e personazhit. Dhe kur dilte në skenë, dukej sikur nuk ishte më ai – por qenia e re që sapo kishte lindur.

Në vetëm shtatë vite jete artistike, Bexheti interpretoi në 20 pjesë teatrore. Ishin mesatarisht tre role në vit, një ritëm i çuditshëm për intensitetin emocional që kërkonte secila prej tyre. Me po atë natyrshmëri, ai hyri edhe në botën e filmit, duke marrë role të pakta, por të mbetura në memorien kolektive.

Në ato vite, arti nuk ishte luks, por mision. Dhe Bexheti e mbante këtë mision me përgjegjësi të admirueshme. Ai nuk luante për famë, për duartrokitje, për lavdi. Luante sepse skena ishte arena e tij natyrale, tempulli ku ndjehej i lirë, i vërtetë, i mbrojtur, i sigurt në gjithçka bënte.

Shkëlqimi i tij nuk qëndronte te numrat e roleve, por te cilësia, te forca e karaktereve që krijonte, te thellësia e shpirtit kur u jepte jetë personazheve të

tij, te autenticiteti i papërshtueshëm me të cilin ai e kthente interpretimin në një përjetim.

Ndër rolet e tij më të suksesshme janë: "Cuca e maleve" – Prifti, "Fytyra e dytë" – Muhameti, "I pazëvendësueshëm", "Shokët", "20 ditët", "Mbreti Lir", "Muri i madh i pakapërcyeshëm", "Tri të shtëna pushke", "I teti në bronz", "Detyrë e posaçme" – Nipi i Gjergjit, "Kur zbardhi një ditë" – Kapiteni gjerman dhe "Vitet e para".

Në çdo rol, ai sillte një nuancë të re: një shikim, një drithërimë, një pauzë që fliste më shumë se dhjetë fjali. Kishte mjeshtëri në mënyrën si e mbante trupin, si i jepte skenës peshë, si e kthente një monolog në një betejë të brendshme.

ROLET QË SENDËRTUAN DHE MEMORIZUAN PROFILIN E TIJ ARTISTIK NË KINEMA

Në filmin artistik, sado pak role të ketë pasur, portreti i tij mbetet i skalitur mjeshtërisht te "I teti në bronz", ku luan personazhin e mësuesit, dhe sidomos te episodi "Ura", në filmin "Kur zbardhi një ditë".

Atje, tek kapiteni gjerman, Bexheti interpretonte duke u përballur edhe me sëmundjen e tij të rëndë – dhe kjo ia shtonte rolit një dimension krejt tokësor, prekës, të dhimbshëm, të vërtetë.

Në ato momente, kamera kapte jo vetëm aktorin, por edhe njeriun. Dhe pikërisht ky njeri, i goditur nga jeta, por i pa tradhëtuar dhe i palodhur në shpirt, i dha ekranit disa nga çastet më të singerta dhe dinjitoze të kinemasë shqiptare.

Në filmin "I teti në bronz" (1970), roli i tij i mësuesit-guerrilas lidhet rreth një çasti që s'zgjat as sa një rrahje qepallash, por që peshon sa një dramë e tërë. Ai



Aktori Bexhet Nelku, në rolin e mësuesit te filmi "i teti në bronz" - 1970



Aktorët Bexhet Nelku dhe Robert Ndrenika në filmin artistik shqiptar "I teti në bronz" - 1970

është aty, duke mbajtur fatin e misionit në xhepin e brendshëm të kostumit, kur papritur shfaqet përballë Lefter Lefteri – tradhtari që, me një shikim të vetëm, e sheh, e njeh dhe i shmanget si gjarpër që ka ndjerë kërcitjen e hapit.

Këtu nis ajo që e bën figurën e Bexhet Nelkut unike.

Në fytyrën e tij nuk ka shpërthim, as lëvizje, as gjest të tepruar. Ka vetëm një dridhje të padukshme në thellësi, si valë e lehtë që përplasat në breg dhe zhduket menjëherë. Ai e dëgjon brenda vetes krismën e rrezikut, por nuk e lejon asnjë shenjë të arrijë në sipërfaqe. Ky është vetëkontrolli i tij, kjo është forca e tij morale, ky është thelbi i mjeshtërisë së tij interpretuese.

Në sytë e aktorit shfaqet menjëherë një dritë e mprehtë: vetëdija se është zbuluar. E megjithatë, sytë nuk humbasin qartësinë. Aty përplasen disa fate njëherësh: i grupit guerrilas që i ka besuar detyrën, i qytetit të shtypur nga pushtuesit, dhe i vetë mësuesit që tani rri pezull në një hapësirë të rrezikshme, ku çdo sekondë është teh i mprehtë.

Pikërisht këtë dramë e luan Bexhet Nelku me një maturi dhe inteligjencë artistike aq të lartë, sa roli e tejkalon kufirin e thjeshtë të interpretimit dhe bëhet dëshmi e karakterit njerëzor. Ai nuk e bën skenën të madhe, por të thellë; nuk e shton zërin, por e zhyt brenda vetes. Dhe aty, brenda, rritet një peshë që e mban i vetëm, sepse mësuesi i tij i brendshëm nuk e lejon të humbasë dinjitetin, edhe kur rreziku e ka kapur për krahu.


Në atë çast, qetësia e tij e jashtme është si një akull që nuk çahet, ndërsa brenda lëviz një stuhi që vetëm një aktor i pjekur mund ta kontrollojë. Ai nuk është thjesht një njeri që lufton, por që përpiket të ruajë vetveten përballë një fati që po i afrohet.

Dhe pikërisht këtu qëndron kulminacioni i tij artistik: në aftësinë për të luajtur dramën e madhe me një lëvizje të vogël; për të mbushur heshtjen me tension; për ta bërë rrezikun të ndihet pa e treguar.

Në atë sekondë, Bexhet Nelku na jep një portret të përkryer të njeriut që e mban frikën brenda, por nuk e lë të sundojë. Një figurë që ngrihet jo me zë, por me dinjitet. Një aktor që, edhe pse s’u lejua të jetojë gjatë, arriti të ngjisë artin e tij në ato lartësi që mbeten të paharrueshme. Dhe ai është ende aty, në atë shikim që sfidon frikën. I thjeshtë, i heshtur, i pathyeshëm.

Ndërsa në episodin “Ura” të filmit *Kur zbardhi një ditë* (1971), Bexhet Nelku jep një performancë që tregon dimensionin e një mjeshtërie të rrallë aktoriale. Ai interpreton Kapitenin gjerman të kapur rob, një rol që kërkon balancim mes autoritetit të ndërthurur me ndjenja të brendshme të frikës dhe pafuqisë. Që në hyrjen e tij në skenë, gjesti dhe postura e Nelkut flasin më shumë se dialogu: çdo lëvizje, çdo kënd i kokës, çdo shikim reflekton një psikologji komplekse, atë të një njeriu të përballur me humbjen e kontrollit, por që përpiket të ruajë dinjitetin.

Nga ana filmike, mizanskena në fshat është e dizajnuar me kujdes. Ambienti, ndriçimi dhe kornizat kamemale nuk janë thjesht sfond; ato forcojnë tensionin psikologjik të episodit. Kamera shpesh fokusohet tek fytyra e Nelkut në momente heshtjeje, duke i dhënë publikut mundësinë të lexojë emocionet e tij të brendshme – frikën, shqetësimin, por edhe një farë krenarie që refuzon të shuhet. Çdo kënd kamerash, çdo ndriçim i butë ose i fortë, duket sikur dialogon me aktoren, duke theksuar brishtësinë e



At e bir aktorë - Einar Nelku dhe Bexhet Nelku. Bexheti në rolin e Kapitenit gjerman, në filmin artistik shqiptar “Kur zbardhi një ditë” - episodi: “Ura” - 1971



Aktori Bexhet Nelku, në filmin artistik shqiptar, “I teti në bronx” - 1970

situatës dhe kompleksitetin e karakterit.

Artistikisht, aktori arrin të krijojë një kontrast subtil midis asaj që tregon jashtë – një ushtarak i rrethuar nga robëria – dhe asaj që ndjen brenda. Kjo dyfishtësi i jep karakterit dimensione njerëzore dhe e largon nga një portret stereotipik i “armikut”. Një veçori e spikatur është përdorimi i heshtjes: çdo heshtje është e ngarkuar me kuptime, dhe Nelku e bën heshtjen një element narrativ po aq të fortë sa dialogu. Momente të vogla si një tundje e kokës, një shikim i fshehur pas qepallave, ose një frymëmarrje e ndalur, hapin për publikun një univers të tërë emocionesh dhe mendimesh të pashprehur.

Nga perspektiva psikologjike, performanca e tij përçon përplasjen midis instinktit për të mbijetuar dhe tensionit moral që lind nga ndërgjegjja. Shikuesi ndjen çdo dyshim, çdo kontradiktë brenda karakterit, dhe kjo e bën lojën e Nelkut të thellë dhe prekëse. Ai nuk është thjesht një roli “i mirë” apo “i keq”, por një figurë e plotë psikologjikisht, e cila ngjall empati dhe reflektim. Psikologjia e Kapitenit është një kombinim i frikës, tensionit të pashprehur dhe i një dinjiteti që ngjan si mbetje e së shkuarës, duke i dhënë interpretimit një dimension universalisht njerëzor.

Gjithashtu, performanca e Nelkut mund të analizohet në një kontekst më të gjerë artistik. Ajo sfidon stereotipet e zakonshme të filmit të Luftës së Dytë Botërore, ku shpesh armiku paraqitet vetëm si i keq dhe i njëdimensionuar.

Nelku sjell nuanca, sjell një portret të personazhit me brishtësinë, pasigurinë dhe ndjeshmërinë e tij njerëzore. Kjo i jep skenës një ndjesi autenticiteti dhe e afron shikuesin emocionalisht me situatën, duke e bërë çdo moment të tensionuar, por edhe të thellë.

Loja e Bexhet Nelkut në këtë episod është një demonstrim i aftësisë së tij për të bashkuar elementet artistike, filmike dhe psikologjike në një performancë të kompletuar. Ajo që duket si një skenë e thjeshtë në një fshat të largët, përmes tij shndërrohet në një studim të gjallë të njeriut dhe të emocioneve njerëzore, duke lënë një gjurmë të qartë në kujtesën e shikuesit. Çdo detaj, - nga një rrotullim i lehtë i syve, deri te një heshtje që zgjat disa sekonda - shërben për të ndërtuar tensionin dhe për të treguar kompleksitetin e natyrës njerëzore, duke e bërë performancën e Nelkut një shembull të shkëlqyer të aktorit që e ndjen rolin deri në thellësinë më të imët të tij.

PEDAGOGJIA DHE TRASHËGIMIA E TIJ

Bexheti nuk ishte vetëm një aktor i filmit dhe i skenës; ai kishte një dhunti tjetër, po aq madhore: ishte një pedagog i jashtëzakonshëm në Institutin e Lartë të Arteve (ILA). Atje, ai jepte lëndën e “Fjalës artistike” – artin e të folurit, artin e intonacionit, frymën e fjalës, heshtjen e domosdoshme që i jep peshë çdo drame.

Në auditor, ai nuk fliste si profesor; fliste si një njeri që donte t’u jepte

studentëve çelësin e një bote sekrete. Sytë e tij ndizeshin sa herë tregonte se si një pauzë e vogël mund të ndryshojë gjithë ritmin e një monologu. Studentët e kujtojnë ende pasionin e tij, seriozitetin dhe butësinë me të cilën i drejtonte.

Ai u mësonte studentëve se zëri nuk është thjesht mjet komunikimi, por instrument muzike, udhërrëfyes emocional, dritë që shkon drejt zemrës së publikut. U shpjegonte se heshtja mund të mbajë brenda saj një univers të tërë tensioni, një ndjenjë që flet më fort se çdo dialog.

Edhe pse koha nuk i fali mundësinë të shfaqte gjithë potencialin e tij në kinematografi, fati e deshi që rruga e artit të vazhdonte përmes të birit, Einar Nelku, i cili në vitet ’80 u bë një prani e hijshme si aktor në disa role dytësore, duke trashëguar pasionin dhe pastërtinë artistike të të atit.

Në fund të jetës së tij, ai u nda nga jeta më 21 nëntor 1970, vetëm 33 vjeç. Tirana humbi një ndër talentet më të ndjeshëm, ndërsa publiku kujtonte ende zërin e tij, sytë e tij, heshtjet e tij të fuqishme.

Kjo humbje e parakohshme nuk ishte thjesht fundi i një jete, por ndërprerja e një rruge që kishte nisur të ndriçonte teatrin shqiptar. Ai iku i ri, por iku i plotë. La pas jo një karrierë të gjatë, por një kujtim të thellë, të pandryshueshëm.

Shfaqjet e tij rrinin të gjalla në kujtesën kolektive, si një film që nuk shuhet kurrë.

Humbja e tij ishte një boshllëk për familjen, kolegët, miqtë dhe për të gjithë artdashësit që besuan se ai ishte vetëm në fillim të një karriere të gjatë dhe të ndritur.

Çdo shikim i tij, çdo frazë, çdo hap në skenë dëshmon se arti i vërtetë nuk matet me kohëzgjatje, por me intensitet, me dritën e brendshme, me gjurmën që lë pas.

Në pak vite, ai arriti të thërrmojë kufij, të zgjojë emocione, të skalitë figura që mbeten të pashlyera. Ishte prej atyre artistëve të cilët as koha, as harresa nuk i prek.

Ai është i pranishëm sa herë kthejmë kokën pas, sa herë kërkojmë dëshmi të një arti të pastër, të vërtetë, të paepur.

Ai nuk kishte nevojë për dekada mbi skenë; mjaftuan pak vite që ranë si trokitje të forta mbi ndërgjegjen estetike të brezit të tij – dhe kështu u bë i pavdekshëm.

Bexhet Nelku mbeti jo vetëm aktor i madh e unik, por simbol, shembull, kujtesë e një arti që kërkon përkushtim, finesë, butësi, e mbi të gjitha, shpirt. Ai vazhdon të jetojë në çdo rol, në çdo emocion që ngjalli, në zemrën e çdo shikuesi që e pa dhe u prek prej tij.

Ai na kujton se një jetë e shkurtër mund të jetë e përgjeshme; se arti, kur lind nga thellësia e shpirtit, ka forcën të sfidojë kohën; se edhe kur një yll ndizet vetëm për pak vite, ai mund të shpërthejë në një vezullim ngjyrash që nuk shuhet kurrë.

Dhe pikërisht këto yje të rrallë, edhe nga largësia e kohës, vazhdojnë të ndriçojnë udhët e kujtesës sonë.

Në çdo rreze drite që bie mbi kujtimin e tij, në çdo heshtje skenike ku dikur frymoi zëri i tij i brendshëm, ai mbetet një **visar i heshtur**, si një rubin i çmuar i kinemasë dhe teatrit shqiptar.

Aty, në pelikulën e historisë kinematografike, ai rron ende. I qetë, i dritshëm, i papërsëritshëm. Ngase arti i vërtetë nuk shuhet kurrë, edhe kur jeta e një artisti si ai mbyllet shumë herët. Ndaj edhe trashëgimia e tij, sot e kësaj dite, vazhdon të marrë frymë si një prejëllimë e pathyeshme në udhën e artit shqiptar.

Sapo nis të lexosh faqet e para Skupton që librin do ta mbash në dorë sepse që në hyrje të tij gjuha dhe rrëfimi i rrjedhshëm por dhe përshkrimet e gjalla të mbajnë ngulitur dhe faqe pas faqeje një intuitë e çuditshme të flet duke thënë se asgjë nuk është ashtu siç duket, dhe në fakt kjo ndodh.

Kalabashi i artë është një histori ku lexuesi nuk arrin dot të shuajë kureshtjen; edhe pse në çdo rresht dëshiron të zgjidhë enigmën e radhës, rreshti tjetër hap një dritare të re kurioziteti dhe magjepsjeje.

Nëse në faqet e para kupton menjëherë faktin se historia e Xhoshit të ka përpirë në botën e magjisë së rrëfimit, në vazhdim e ke të qartë se ky nuk është veçse fillimi dhe çfarë vijon më tej del jashtë çdo parashikimi.

Duke ecur me djaloshin përmes një natyre sa të rrezikshme aq të mrekullueshme në luginën e egër dhe në të njëjtën kohë mahnitëse të Kalimbulës pa dashur e gjen veten në vendin e personazhit dhe kupton se po provon të njëjtat ndjesi të tij: frikën, dëshpërimin, zhgënjimin si dhe shpresën, forcën, kurajën, kënaqësinë, dashurinë por dhe dëshirën e fortë për të zgjidhur enigmat e mëdha që paprimtas i kanë rrethuar jetën, për të zbuluar pse-të dhe pikëpyetjet të cilat si bimë të çuditshme kanë mbirë papritmas rreth tij.

Shumë interesant është fakti se si në rrëfimin real ndërthuret aq natyrshëm ai imagjinari; duket sikur dy botët janë bërë bashkë të gërshetuara dhe gjithë personazhet mpleksen me këtë magji duke marrë me vete edhe atë që e lexon.

Libri të rrëmben brenda florës dhe faunës, botës së egër, xhunglës afrikane dhe ndërsa shfleton të ngjan se ke përballë totujkun, hutën, hipopotamin, zogjtë e larmishëm, lumin, perëndimin, tingujt që dëgjohen befasi e të gjitha këto i ndjen dhe i përjeton nën lëkurë duke hyrë vetvetiu brenda kësaj natyre të egër e duke u bërë si pa kuptuar pjesë e saj. Por kjo nuk mjafton, në disa raste vetë personazhi i krahason njerëzit me koalën apo kastorin duke i bashkuar me shumë dy dimensione dhe duke i ngatërruar në një rrëfim magjepsës. Mitologjia shkrihet herë herë me jetën reale, me shkencën, duke dhënë edhe mesazhe të rëndësishme. Lexuesi ndërkohë, nëpërmjet aventurave shpesh të pabesueshme e të rrezikshme të Xhoshit, kupton sa e ligë dhe e pamëshirshme mund të jetë ndjenja e lakmisë dhe e etjes për pushtet. Nuk është sigurisht vetëm aventura në natyrë që të habit e rrëmben. Në rrëfim vijnë sa rrjedhshëm e natyrshëm aq dhe mrekullisht burri i urtë Ngandu në prezantimin e të cilit mjeshtëria e autorit nuk zhgënjën.

Përktheu Sidita Dano, Ombra GVG

Aventurat e Jung Xhoshit: Kalabashi i artë Autori Constant Van Graan.

Nga Sonila Strakosha

Ngandu është në njëfarë mënyre edhe një mbështetje, forcë dhe udhëheqje shpirtërore për Xhoshin.

Përfaqëson mirësinë dhe urtësinë e megjithatë i drejpërdrejtë, e vë djalin përballë të vërtetave e rreziqeve të paevitueshme, sepse

jeta është e tillë dhe djalit i duhet të zbulojë e sfidojë ato vetë.

Shumë interesante dhe enigmatike shfaqet Nxheri e cila herë duket një vajzë fare e zakonshme e më pas ngjan një krijesë e çuditshme që flet me kafshë dhe njeh xhunglën



si të qe padrone e saj. Të njëjtin përjetim të lë Masheba që me prezantimin, sjelljen dhe qëllimet të cilat do të realizojë transmeton jo vetëm te Xhoshi por dhe te lexuesi mesazhe të rëndësishme.

Kush mban librin në dorë kurthëzohet i pushtuar nga shumë emocione e ndjesi njëherësh: dhembshuria për djaloshin, mahnitja për natyrën e përshkruar si dhe fantazinë e pasur, trembja mbi rrezikun e radhës, ankthi për fatin e djaloshit Xhosh është më e rëndësishmja kureshtja që nuk gjen fund e s arrin të zbehet.

Ky libër kujton letërsinë e realizmit magjik por këtu misteret që mbajnë pezull pa gjetur zgjidhje përfundimtare vijnë me një vrull e intensitet të jashtëzakonshëm. Aventura, misteri, përshkrimet e pasura, fantazia pa kufi dhe mitet të cilat i ngjeshen normales të detyrojnë ta mbash librin të hapur për të zbuluar çka fsheh kapitulli i radhës. Kalabashi është pjesë e mitologjisë në Afrikë, simbol i jetës, i botëkuptimit, vazhdimësisë së saj. Pra ndërsa Xhoshi vihet dëshpërimisht në kërkim të nënës e të këtij objekti, kërkon pandashmërisht të gjejë vetveten, të kuptojë përkatësinë e vërtetë të tij e të familjes. Autori e vë adoleshentin lexues në këtë histori përballë emocioneve të forta, e trajton atë njëlloj si të rritur kur i tregon rrezikun e vdekjes, forcën për të zbuluar të vërtetë të dhimbshme, përballjen me frikën dhe njohjen e shpirtit njerëzor në gjitha dimensionet.

Meritë e tij është se përveç udhëtimit brenda një aventure fantastike lë vend dhe për shumë ndjeshmëri, emocion, dhembshuri. Kush mban në dorë librin mezi pret ta shohe Xhoshin të qetë, duke ngrënë një vakt të ngrohtë ashtu siç ai e sheh në ëndërr, por çuditë me sa duket nuk mbarojnë kurrë sepse deri në fjalën e fundit historia është një befasi më vete dhe kur e mbyll, ende lexuesi është duke mbajtur frymën në pritje për të shfletuar librin e dytë.

Kush do të lexojë këto faqe do të hyjë brenda një aventure sa të bukur e të mrekullueshme po aq të fortë e të egër. Do të njohë e kuptojë më shumë natyrën, zakonet, folklorin, mitet, gjuhën, bestytinitë, kulturën e një vendi. Do duket se bisedon e ka afër kafshë të cilat nuk i njeh apo nuk ka dëgjuar ndonjëherë dhe mbi të gjitha do të mbajë gjallë e pezull e do të zhvillojë, kureshtjen dhe fantazinë.

Një libër ku rrëfimi magjik, mitologjia, aventura, forca e natyrës, emocion, imagjinata shkrihen bashkë te personazhet duke kaluar shpesh te ta kufijtë e reales e duke ditur në të njëjtën kohë prezantojnë tërësisht njerëzorë.

Karikaturë nga Arben Meksi



Unë kam lindur në një qytet të çuditshëm që e kishte komoditetin dhe luksin e përrallave. Dhe që atëherë më është krijuar ideja se në qytete me një atmosferë të tillë jo vetëm mund të tregohen dhe të dëgjohen përrallat, por dhe me një lehtësi të jashtzakonshme mund të prodhoheshin rrëfime nga më fantastiket.

Të këtij tipi janë qytetet magjike, në të cilët ka dëshirë ta shkojë fëmijërinë e tij kushdo. Im atë më pati treguar për një poet të famshëm që pati thënë se “qyteti më i madh i botës, nuk është gjë tjetër veçse qyteti më i vogël i botës, por që ka burrat dhe gratë më të mëdhenj të botës”. Isha fëmijë dhe nuk e kuptoja metaforën e thënies, (të gjitha i merrija në kuptim të parë). Ndaj sa herë që e dëshiroja qytetin tim si më të madhin e botës, dilja në rrugë dhe vija re me dhimbje se burrat dhe gratë e mëhallave të vjetra, nuk qenë ndryshe vetëm si të gjithë njerëzit e vendeve përrreth. Dhe kjo asnjëherë nuk më jepte shpresën se, së paku një ditë qyteti im i lindjes do të qe më i madhi në botë. Kur u rrita dhe ca, dhe e kuptova metaforën, madje ia mësova edhe emrin atij poetit të dikurshëm (Uollt Uitman), u mundova të numroja plot njerëz të mëdhenj, të përmendur dhe të shquar të vendit tim, por që asnjëherë nuk mjaftuan ta bënin dot qytetin më të madh nga ç’ ishte. Dhe në fund të fundi, tek e mbamja më ka ardhur mirë. Nganjëherë madhështia ia humb formën dhe intimitetin vendeve të vogla, i prish urbanistikën e historive dhe ngjarjeve të vjetra, bën të harrueshëm emrat dhe ndodhitë më të mrekullueshme që ndryshojnë nga të gjitha historitë e tjera të botës.

Legjenda nga më tronditëset silleshin rreth mëhallave të vjetra të qytetit tim. Qe një atmosferë ku rrinin bashkë të gjitha. Rugica të ngushta me kalldrëm dhe kuaj e karroca që bridhnin natën si fantazma, plaka që thuhej se bënin magji dhe pak më tutje mejhanet plot me të dehur që pinin e dëgjonin ndonjë këngëtar që i binte violinës së tij të vjetër dhe këndonte këngë për ushtarë që humbën dhe s’u kthyen dot kurrë më në shtëpi. Aty përrreth qe kinemaja rrangalle me një sobë të madhe zjarri në mes dhe me filmin që jepej pa përkthim, vetëm i rrëfyer nga punëtori i kinemasë, që i dinte ndodhitë, mbasi e kishte shikuar filmin qysh një ditë më parë. Pak hapa më tej shtëpisë sime qe varri i braktisur dhe pa asnjë eshtër, (hapur e vjedhur në ndonjë natë të errët nga njerëz të çuditshëm), pra varri bosh i Heroit më të rëndësishëm të shqiptarëve. Tek tuk qenë ca hane të zymtë ku kalonin natën ardhacakë të largët që s’ dihej kurrë as se nga vinin dhe as se për ku qenë nisur, misteriozë dhe të frikshëm. Ndoshta shitës ikonash, apo matrapazë shamiash dhe mallrash të kushtueshme.

Qyteti kishte patur në mes një vorrnajë të vogël me njerëz të panjohur, të humbur dhe të largët që vdekja i pati zënë pikërisht rrethinave të mëhallave të vjetra. Diku binin këmbanët e mëdha të kishës që lajmëronin për mort apo për meshë, ndërsa në anën tjetër muezini këndonte nga minareja lutjet e akshamit. Nëpër rrugicat e ngushta sillej nëpër muzg me bidonin e vajgurit në dorë ndezësi i kandilave të rrugëve. Në një konvikt të vjetër rrëzë kalasë mesjetare rrinin ca kongolezë që shteti i pati strehuar atje. Historitë e jetës së tyre qenë legjenda më vete, dhe dukej se qyteti im e kishte fatin që t’u shtonte historive të veta edhe ato të kongolezëve. Në një shtëpi të vogël, të ulët e të mbledhur kruspull (taman mrrolur si vetë banorët e saj),

MARK SIMONI

Mrekullitë e qyteteve të vogla

ese



jetonin vëlla e motër dy pleq bjelloruse që fati i pati tretur e hedhur pikërisht aty në qosh të mëhalles sime të vjetër, dhe rreth tyre qenë thurur histori nga më të llahtarshmet. Deri pas mesnate nga larg dëgjoheshin këngët e magjypëve që ose gjuanin bretkoca, bënin aheng e pinin raki në breg të lumit, ose kur ktheheshin vonë nga kinemaja këndonin këngët e filmit që sapo kishin parë. Përrreth mëhallave, apo të dalë aty këtu përbrij shtëpive të vjetra, qenë muret antik të qytetit të lashtë, të rëndë, të murtë, me hijen e misterit në to. Poshtë tyre hapeshin ca tunele të errët dhe të frikshëm, që herë thuhej se kishin qenë burgje e hapsanë të tmerrshëm, e herë të tjera thuhej se të dërgonin tek thesare të çmueshme, dhe njerëzit që kishin kërkuar patën ngelur brënda në to njëherë e përgjithmonë. Rreth këtyre mureve gërmonin njerëz të ardhur nga larg, të veshur krejt ndryshe nga burrat e qytetit tim.

Në fëmijët vraponim nga njëra mëhallë në tjetrën për të këmbyer pulla poste, kacavareshim mbas pajtoneve që dërgonin nuset nëpër dasma, i viheshim pas bandës së qytetit që luante muzikë për festa e përvjetore, dhe bënim me vete edhe ne sikur po u binim veglave, mblidhnim mbrapa mureve të vjetër të kinemasë copa nga filmat e dëmtuar dhe pasi i prisnim me kujdes me gërshërë i fusnim në palë të librit taman ashtu siç bënim dhe me pullat e postës, laheshim pa leje në lum apo bënim ndonjë zullum fshehtas mësuesve dhe prindërve. Sec kishim një dëshirë të fshiheshim nëpër trapazanët e shtëpive të vjetra, nën

tjegullat dhe atje të bisedonim me shokët për sekretet tona që përherë mbylleshin me betimin, (duke bërë be’ për kokën e më të afërmve dhe më të dashurve), se nuk do t’ia tregonim kurrë të fshehtat askujtë, sido që të ndodhte.

Dhe e gjithë kjo skenë e këtij teatri, kjo atmosferë e mbushur me ngjarje të fshehta, të errëta, mistike, ky qytet me rrugicat e ngushta, me dugajat e vjetra, me sherret, dashuritë, thashethemet dhe inatet, (që i jepnin shije dhe sharm mëhallave të vogla), me shtriga, magjistarë e fantazma, me shtëpitë karakteristike me oborr, pusët me çikrik e avlli, me ato odat e mëdha me oxhaqe dhe me dritaret me kangjella të zbukuruara, me fallgjorë, ahengxhinj e këngëtarë të verbër, me plakat mbuluar me degërmija të bardha si shenjtoret, dhe me burrat hokatarë që talleshin me çdo gjë të kësaj bote, me të vdekur dhe endacakë, me ngjarje të kobshme dhe me hare të papara, me gjuetarët që ktheheshin në muzg nga kënetat me rosa e pata të egra varur pas biçikletave, me mallkime e bekime njëkohësisht, qenje të çuditshme mistike dhe vajtime të thekshme grashë, me makinën e postës që sillte më të rrallë ndonjë lajm a letër, me motorrin e dritave që bënte kiametin e zhurmës, me trumën e benzinës apo me mullirin e vjetër të zjarrit. Të gjitha këto qenë një materie që do t’i kishte lakmi çdo banor i botës dhe me të cilën mund të prodhoheshin përrallat më të mrekullueshme e të çuditshme që ka dëgjuar ndokush.

Por nuk qe e thënë të shkonte gjatë. Një tërmet, nga më të tmerrshmit që ka

rënë në vendin tone, në 1979 rroposi çdo gjë, duke rrënuar përfundimisht dhe pa mëshirë qytetin tim, dhe duke e bërë atë për pak minuta rrafsh me tokën. Çdo gjë u shëmb, ra përmbys, s’që më, vdiq si të mos kishte qenë kurrë, asnjëherë. Shtëpitë, dugajat, mejhanet u kthyen në gërmadhë, xhamia, kisha, zyrrat, shkollat, kinemaja, u rrënuan krejt. Por bashkë me të gjitha, me raftet, teshat, librat dhe albumet e fotografive, enët e kuzhinave, sepetet e vajzave që s’u bënë dot nuse, muret e rëndë rroposën nën vete njëherë e përgjithmonë dhe kujtimet e historitë tona të fëmijërisë, materien e tregimeve dhe legjendave, që në kokat tona i fantazonim dhe pastaj me to bënim përralla. Vetëm tek tuk ndonjë fill i hollë tymi apo ndonjë curril tubi uji dilte nga gërmadhat, si fryma e fundit e dikujt që po jepte shpirt. Tashmë qyteti kishte rënë, qe i rëndë dhe s’mundej më ta ngrinte dot askush. Me të u rropos dhe çdo gjë e tij. Vetëm një shkretëtirë rrënojash e gërmadhash shtrihej në atë vend ku pati qenë e gjithë bota ime. Të mbledhura kruspull, aty këtu për ditë e ditë të tëra rrinin plakat me të zeza që qanin nën zë, burrat që silleshin vërdallë, rreth e rrotull rrënojave me sytë e hapur tej mase si të çmendur, qentë dhe macet që vajtonin me lëngatë dhe kërkonin gërmadhavë s’ dihej se çfarë, kuajtë që hingëllinin si të tërbuar dhe vraponin me rropamë dhe humbnin nëpër terr, nuk dihej se ku.

Kur po shkruaja këto për qytetin tim mu kujtua një qytet tjetër shumë i largët, me një lloj fati tjetër, por i mallkuar me po të njëjtin trishtim e vetmi si dhe vendi im i lindjes. Famagusta e famshme dhe tronditëse njëkohësisht, qyteti që u braktis me një urdhër të prerë dhe mbeti shkret brenda pak minutash. Njerëzit ikën nga aty përgjithmonë, pa mundur të marrin dot asgjë. Në oborre shtëpish, varur në tel, prej vitesh thahen e lagen po të njëjtat rroba, përbri kangjelave kanë mbetur akoma po ata kukullat e vajzave të vogla dhe që sot ato vajza janë bërë nuse, rrëzë mureve të mbështetura janë biçikletat e vogëlushëve, ndonjë dorashkë e humbur apo këpucë e mbetur në rrugë nga ikja në alarm, patinat, ndonjë top i vetmuar, librat e përrallave që nuk mundet t’i lexojë më askush në këtë jetë. Në atë qytet bosh çdo gjë ka mbetur si në atë ditë, sendet, makinat me çesla në to duke pritur prej vitesh për tu ndezur, lodrat që tashmë kanë dalë nga moda, fotografitë që janë vjetruar, kitarrat dhe violinat që i ka marrë malli për gishtat e njerëzve. Trishtimi, harresa dhe pluhuri e kanë mbuluar atë vend të braktisur dhe të ndalur njëkohësisht. Kalendarët me ditët, muajt, vitet, s’kanë më kuptim në atë qytet, kanë mbetur varur kalendarët e vjetër që nuk tregojnë më dot asgjë. Edhe përrallat kanë ngecur dhe nuk thuhet më, s’ka se kush t’i tregojë. Sahatët e varur në mure janë lodhur të punojnë sa kanë mundur deri në grahmat e fundit, por dhe ato kanë mbetur tashmë. Ato dhe kohën nuk mundet askush më ta kurdisë. Vetëm shira, netë të gjata dhe gjethe të vyshkura bien në atë qytet të braktisur, dhe asgjë më, asnjë piptimë e zë.

Legjendat dhe përrallat janë të lidhura me jetën e qyteteve, madje nuk bëjnë dot asgjë nëse nuk shkojnë pas fatit të tyre. Janë vetëm fëmijët që e prishin këtë rregull, duke i ruajtur ato me një insistim të madh në kujtesën e tyre, madje dhe duke i zbukuruar, bërë më interesantë dhe duke i rritur qytetet edhe më të mëdhenj nga ç’ishin në të vërtetë. Fëmijët janë bekimi i madh i qyteteve dhe ndodhive të tyre.

Se ç’kish ndodhur një ngatërresë me dhomat Snë hotel, kryetari i delegacionit rrudhi ballin e m’i lëshoi sytë: të zuri, taksirat e ke me fjetë sonte në ambasadë. Isha më i riu dhe thjesht person teknik, përkthyes. Para se të fluturonim për në Zanzibar, na patën shtruar një darkë në mjediset e ambasadës në D. Më kishin ngelur në mendje dy gjëra, të cilat do të kisha rast me i pa sërish atë natë. Hardhucat e vogla, që lëviznin për kokërr të qejfit poshtë e përpjetë mureve në sallonin e gjerë të pritjes, dhe Anja, gruaa fort e bukur e sekretarit të parë, i vetmi diplomat aty, përveç ambasadorit.

Sapo shkela në holl, pashë një hije që rrëshqiti shkallëve për në katin e epërm. Mbas pak Anja zbriti, veshur me fund të bardhë me do lule të kaltra, pak mbi gju, dhe me bluzë rozë, me dy pulla zbërthyer. Paskesh fluturuar për të ndërruar fustanin. Në ambasadë më kish prurë i shoqi me makinë. I shoqi përshëndeti duke dalë, por s’e kishim mendjen, veç kur dëgjua motorin që u ndez në oborr. Anja buzëqeshi, si ju shkoi udhëtimi? Solli *Johnnie Walker*. S’kishte shumë zgjedhje në menynë e pijeve, por ç’nevojë kish? Përballë syve të mëdhenj të Anjas nuk të shkonte mendja për zgjedhje të tjera. Fshehur nën një trishtim ikone, sytë e saj dukeshin të paarritshëm. Sapo e ngacmonte për mirë diçka, shpërthenin kornizën kishtare me një përflakje të kaltër në vjollcë, dhe ashtu në liri të plotë bëheshin të papërballueshëm. Po më dukesh si Ana Karenina, i thashë me zë gazmor. Krejt rastësisht, gjatë darkës së parë patëm zbuluar se paskeshim të njëjtën datëlindje, çka dukej sikur na bënte më të afërt. Gjithsesi jam Anja, jo Ana, tha. Pruri kikirikë dhe pistashe. Ana Karenina e Sofi Marsosë, thashë, duke nënkuptuar bukurinë e aktores, gjethe e njomë molle. Ndalua te Ana, lere Marsonë, shqiptoi. Lëpeja e përhimët i mblodhi sërish nën vete sytë e bukur.

Ndezim nga një cigare?, tha pasi kishim kthyer gotën e dytë. Këtu në holl pinë. Me një lëvizje të çlirët, të pafajshme, hoqi këmbën mbi këmbë, fundi fërfëlloi dhe diku në thellësi feksi një vetëtimë e bardhë. Kam duhan bio me kuti, thashë, më fort për të larguar turbullimin që ma shkaktoi ajo çka pashë, bashkë me një ndjenjë faji, që më kishin shkuar sytë andej. E mbështjellim me dorë.

Mbas dritares u dëgjua një zhurmë e shkurtë. Sytë e Anjas u fshehën thellë në ikonë. Iu duk se kërceu dikush nga muri?

- Hajduti.

M’i lëshoi sytë qortueshëm.

- Mos ra ndonjë arrë kokosi, u tërhoqa.

Në oborr s’kishte palma, as arra kokosi.

- Do të më ndihmosh me ba diçka për darkë? Kemi peshk.

Qiti prej raftit një shishe verë të bardhë. Kemi edhe të kuqe, janë të Afrikës së Jugut. Sytë e saj u çelën si dritë Mesdheu. Ikona që i rrethonte qe bërë copë e grimë.

- Prit të të jap një përparëse. Se mos stërpikesh.

- Je fantastike. Rrallë më ndodh me pi një gotë qumësht, pa e nderuar këmishën me një njollë ashtu kot.

- Gje një vajzë që të do fort. Përndryshe do ta kesh pisk me njollat.

Cijati dera e hollit, u shfaq një hije e përhimët, pak e kërrusur. Vizatim i bërë me tym në ajër.

- Më fal, m’u drejtua i shoqi. Jam i detyruar të të lë vetëm me Anjan. Ambasdori do të darkojë me delegacionin, duhet të shkoj edhe unë. Më çoi me marrë diçka.

- Anja është shumë e sjellshme. Mund të kishim qenë shokë klase. Edhe në të njëjtin grup, në kopsht.

- Më në fund, tha Anja. U erdhi rasti me u marrë me diçka.

E kish fjalën për ambasadorin dhe të shoqin. Çoi duart e i mblodhi flokët e hapur mbi shpatulla. Fiongoja fër-fër, si zog, iu qetësua mbi qafë.

- Ambasada mbulon gjysmën e kontinentit, është e vetmja në krejt Afrikën e Zezë. Dhe ende s’e kam marrë vesh ç’punë bën. Po, shpërndan librat e udhëheqësit. Vepra e njëzetë, vepra e tridhjetë, fjalimi në. Dhe pret me u thye ndonjë këmbë.

- Po më flet me rrotulla. Duke vrarë mendjen ç’po thua, unë do të thyej ndonjë pjatë.

- Vrau këmbën një i partisë së këtyre, të vendit. Sekretar politik, diçka kësisoj. U tha duke luajtur futboll, u fol për atentat terrorist.



As njëra, as tjetra. Qenkesh rrëzur në Francë, diku në Pirenej, në një qendër skish. Ani pse zyrtarisht nuk thuhet.

- Ç’lidhje ka kjo me ambasadën?

- Ambasadori u mbyll një ditë të tërë duke shkruar njoftimin për qendrën. Me një propozim. Që homologu në Tiranë t’i shprehë solidaritet për këmbën e thyer. Dhe t’i urojë shërim të shpejtë. Gatuan ndonjëherë në shtëpi ti?

- Në shtëpi më thonë shefi i pijeve.

- Letra nga homologu në Tiranë erdhi, dhe ja ku u doli një punë. Duhej dorëzuar me protokoll. Një tufë lulesh dhe doemos një dhuratë. Simbolike, punim në filigran.

Afroi një pjatë me porcelane të vogla.

- Të pëlqejnë erëzat?

- Në Zanzibar i përdornin shumë.

- Karafil i Zanzibarit është me famë.

- Kujtoja se është shkurre ose barishte, si karafilat e vazove. U bëka në lisa të lartë, që tundin degët në qiell.

- Përmjëmend?

- Kanë edhe diçka tjetër.

Ajo u mendua. Unë ia plasa të qeshurit.

Djeg.

- Piperi?

- Na prunë tri lloje specash të vegjël, në Tiranë u thonë specak kinezë. Në tri ngjyra. Të gjelbër, të kuq, të zinj. Lamë nam duke u gazitur, mikpritësit qeshnin me lot vetëm pse qeshnim ne, pa e ditur pse. U bëmë budallenj fare. Të dy palët.

- Unë mund ta di pse?

- Nuk ta them dot.

- Merre këtë thikë. Ajo që ke në dorë është bërë sharrë, nuk pret. Pse nuk ma thua dot?

- Në shqip tingëllojnë mbrapsht, kuptim tjetër për tjetër. Do të shembeshe gazit. Bëmë gjithfarë lojna fjalësh. E lëmë kuptimin, po emër sendi me bisht pasthirmash si klithma të shkurtë, ke dëgjuar?

- Në suhaili?

- Po.

- Kujdes, kjo thika tjetër është anzë. Dhe mos qesh tepër, të prishet gjumi.

- Ani, rrimë zgjuar. Apo ti nuk duron dot, shkon me fjetë?

- Këtu janë dy fjeta për miq, njëra me ballkon. Ajo me ballkon është më e këndshme. Me rrjetë të re mushkonjash.

- Vijnë ndonjëherë miq?

- Kurrë.

- Pse kaq shumë mushkonja, ka ndonjë ujë afër?

- Gjelbërimi. Lagështia e ajrit, si në romanet e Markezit. Mund të lundrojnë bretkocat në ajër, shkruan diku.

- E bukur si mushkonjë. Krahasim i rrallë, i guximshëm. E kam lexuar në një poezi për gruan.

- Më duket e sajove ti.

- E ka shkruar një shok imi.

- Po t’i kishe parë mushkonjat këtu, nuk do

ta kishe shkruar këtë varg.

Në oborr u dëgjua prapë një zhurmë, sikur u rrëzua diçka. Sytë prej ikone u fshehën në një qiell të ftohtë.

- Dal të këqyr?

- S’, mohoi me krye.

- Nuk të shoh dot të trishtuar. Prej hutimit do të grij ndonjë gisht në sallatë.

- Ktheje dorën, jo. Gëzohem, ende s’e paske grirë. Çoji këto pjata në tryezë.

- Unë s’po duroj dot, fillova me hangër. Ëm, sa e shijshme

- Po ha me përparësen e kuzhinës veshur?

- Deri ta gjej atë vajzën, që më do fort.

- Gëzuar pra. Për vajzën që të do fort.

- Dhe për vajzën që na përgatiti këtë darkë me pesë yje.

- Faleminderit që erdhe sonte. Në Tiranë ka buisur pranvera.

- Këtu është pranverë tërë motin.

- Këtu është det mërzie. Gjithçka e programuar njëtrajtshëm. Të njëjtat fytyra, vetëm dy ose tri. I njëjti diell pa ndjenja, as më i ngrohtë, as më i ftohtë. E njëjta zagushi. I njëjti shi që bie gjithmonë në të njëjtën orë të drekës, zgjat fiks gjysmë ore, as më shumë, as më pak. Shi qullan, i mefshët, s’di ç’është bubullima. Njerëzit nuk lënë takim në orën kaq e aq, thonë shihemi para shiut ose pas shiut. Stinët këtu janë thjesht marrëveshje, *convention*.

Cingërroi telefoni. Shkurt, u ndërpre.

- Nuk shkojmë kund. Nuk lejohet me lëvizë pa qenë vetë i dytë, jo të një familjeje. Le që ku me shkue. Lagjet e rrethinës plot shkretanë me gërbulë, si ata të Nënës Terezë. Mbështetur në derë të kasolleve, ta këputin shpirtin. Më andej savanet. Tigra e luanë.

- Këta ia vlen me i pa!

- Ia vlen me i pa një herë, si turist. Por a mund ta ndash jetën me egërsirat? Të vetmet dalje janë pritjet e rralla, kur e thërrasin ambasadorin në Tiranë për analizën vjetore, një herë në mot. Im shoq mbetet *i ngarkuar me punë*. Të pëlqen vera?

- E mrekuallueshme.

As që e kisha mendjen te vera.

- Ambasada qenka e bukur.

- Punë fati. E kishte ambasada angleze, zyra të një seksioni ekonomik a ndoshta të konsulltores.

- E mbyllën?

- I ndodhi aksident një gruaje të tyre. Nuk mund të rrinin më këtu.

Nuk iu përgjigj vështrimi tim pyetës për aksidentin.

- Ua kam harruar fytyrën prindve. Një telefonatë një herë në muaj kushton sa dreqi. Më këput malli për mbrëmjet e Tiranës. Shetitja në bulevardin *Dëshmorët e Kombit*, kur kthehen studentët në shtator, të kujtohet ajo tangoja e bukur *Kthehu në shtator?* E jepte Radio-Tirana, si pjesë orkestrale. E një kompozitori amerikan, s’po më vjen

ndërmend emri.

- Prit, ta kujtoj unë.

- Edhe dimrin e ka të bukur Tirana. Dajti mbushur me borë, në qytet çelin mimozat. Unë e lashë fakultetin përgjysmë. Gjithçka përgjysmë.

- Përveç Anjas.

- Pikërisht Anjan e lashë përgjysmë.

- Para meje është një Anja e plotë.

- Në fakt nuk quhem Anja. Im atë më pati vënë emër rus, nuk e dua. Më pëlqen shkurt, Anja. Këtu është fundbotë.

- Pashë një skenë në aeroport në Tiranë, o Zot! Një çift shkonin diku në Amerikë Latine, burri diplomat. Kishin dy djem ndonja 7-8 vjeç, e ëma s’ndahej dot prej tyre, qante me gulshe. I puthte sikur po i pinte, herë njërin, herë tjetrin, duke i rrokur bashkë përnjëherësh me të dy krahët. Ata të ngrirë. Të verdhë, kukullza dylli. Kushedi ç’rrenë u kishin sajuar. Shpella e Ali Babës, lodra me avionë, blua si të zogjve. Me të nda prej fëmijëve! Tmerr.

- Hm.

- Druajnë se diplomatët kërkojnë azil. Prandaj.

- I vetmi tmerr, prej të cilit kam shpëtuar.

Dhe. Dhe me gjasë do të shpëtoj.

Ikona u bë ngjyrëplumbi.

- S’e kuptoj, pse bëjnë të pamundurën me shkue nëpër ambasada këta njerëz, thashë, pa menduar se mund ta lëndoja Anjan. Nuk lënë gur pa luajtur, boll me dalë jashtë, qoftë edhe në qoshen më të humbur të planetit. Në fund të mandatit sjellin disa sende që nuk i gjen në Tiranë, një televizor me ngjyra, një frigorifer, këpucë e fustane të blera nëpër pazare të tipit *Pleshti*, a ia vlen?

Cingërroi telefoni, kësaj here me këmbëngulje. Anja hurbi verën qetësisht dhe u çua. Po më jep këshilla për darkën, i ka thënë ambasadori, tha duke ulur dorezën. Çoi vetullën e djathtë. Ata vonohen, hapim edhe një shishe? E provojmë këtë të kuqen.

Ma zgjati shishen dhe bëri me shenjë nga hapësja. Mezi ma kapi syri pas një pjate. Qeshi ftohtë.

- Pati ardhur një delegacion, i Bashkimeve Profesionale më duket, sa kisha mbërri këtu. Jo, nuk duam verë, thanë kur po shtronim darkën. Vazhdojmë me uiski, verë kemi plot në Tiranë. Kujtonin se uiski pihet gjatë bukës, siç kanë filluar të bëjnë me rakinë te ne, harrojnë se rakia është apertiv. U ve dot faj?

- Po kësaj tape kokëshkretë i ve dot faj? Do me u flijue idiotësisht. Po thërmohet.

- Lashë gjithçka përgjysmë. I ati punon në një ndërmarrje të tregtisë së jashtme, futi mik, ma çoni djalin në ambasadë. Humba dy gjërat më të shtrenjta. Humba... dashurinë. Humba edhe familjen.

Bam!, kërciti shishja. Sytë e saj dolën nga ikona. U futën prapë.

- I ke vënë re këta drurët gjigandë, që rrethojnë ambasadën? Janë luleshqiponja. Gjethet hapen si re shiu, e terrojnë oborrin.

- Pini të dielave kafe nën hije të tyre?

- Bah!

Ia ngula sytë, për të marrë vesh pse.

- Janë plot gjarpërinj. Të fola për atë gruan angleze. Po kalonte në kopsht, një frushullimë, një gjarpër pingul në qafë. Jo, s’po e zgjas.

- Uf!

- Sa dal në oborr, ndiej si më rri helmi i tyre vjerrë mbi qafë. I ndiej kur rrëzohen nëpër degë.

- I ndien a të bëhet se i ndien?

Këqyri orën.

- Uji është me orar. Në mëngjes ik shpejt, unë lahem në darkë. Edhe në darkë shterr. Besoj s’na tradhton për nja tre çerekë ore.

Mblodhëm enët shpejt e shpejt.

Te dera e fjetës sime më zgjati një peshqir. Shampo e sapun ke aty. Shpejt, përndryshe do të flemë mbuluar me shkumë. Tharëse flokësh nuk të duhet, i ke prerë kaçurrelat shkurt.

M’i rrëshqiti majat e gishtave mbi flokë. Sytë e saj shtatë qiej.

Pas njëzet minutash erdhi, mbështjellë me *penjuar* a ndoshta me një re qumështore pak të hapur, e mbante brishtësisht me majat e gishtave te gjoksi. Pashë një cicë të bardhë që kërceu, duke lëvizur gjuhën si nepërkë. Ndryshe nga ç’më kish ndodhur në sallon, kur syri shqoi pahiri një vetëtimë të bardhë diku në derë të thellësive, teksa Anja lëvizi këmbën mbi këmbë e i fërfëlloi fundi, tashti nuk u ndjeja fajtor.

Kanga e Aristotelit

Në mes dy skajeve ekstreme,
materje pa formë, pa akt,
dhe Ent Suprem, akt i pastër infinit,
qëndron Natyra.

Krejt një botë në lëvizje,
krejt një shkallë hjerarkike,
ku qenia e ulët pushon
në gji të qenjes ma të naltë.

Asht parimi i shkakut jashtë – veprues,
që të çon te shkaku i Parë,
universal, etern, i pashaktuem,
te qëllimi i sendeve,
te forma e botës,
te principi i jetës së saj,
te shuma e proceseve jetike të saja,
te kushti inherent i rritjes së saj,
te arritja e përsosmënisë naturale
që i jep gjallëni Gjithësisë
dhe zgjon tërheqjen e mbrendësis së
Natyres,
kah ajo Mendje,
“Mendim i mendimit”,
mendim etern – infinit!

Natyra ndien thellësisht
këtë tërheqje nga Aj,
bota asht krejt e përshkueme
prej dishirit ndaj Perëndisë,
si dashnorja për dashnorin e vet.
Çdo gja në natyrë ka diçka hyjnore,
kjo asht forma e sendeve
që burimin tek Aj e ka
dhe tek Aj priret...

Kanga e Isaisë

Zgjohu, zgjohu ti, o fisi i Jakobit,
harpën tande ban sot që të tingëllojë,
ngrehnju të gjitha, o ju bija të Sionit,
kanga juej deri në qiell le të ushtojë!

Nga një Virgjin e trollit të Davidit,
një Fëmi do t’u lindka në këtë dhe,
emni i tij: “Engjull këshilli e misteri”,
emni i tij: “Perëndia me ne!”

I përfoluni, i pritun ndër shekuj, që po
vjen,
si ma i miri ndër bijë,
ka mbi supet fuqinë e sundimin,
drejtësia edhe paqa i kanë prijë.

Rufe s’ka, s’asht i rrebtë si duhia,
por a’ i kandshëm si vesa në agime,
urdhni i tij: sillni shpatat në parmenda,
ktheni shtizat për kosa, në punime!

Nën gjurmë të tij burojnë ujnat në shkret-
ina,
me freski, me lulëzim shpërthen jeta,
ky asht Bariu, kullotë delet në bar të
njomë,
të vogël kingjin e mba ndër duer të veta.

Nga njaj Fëmi paska dritën i verbti,
ndigjon shurdhi, po flitka memeci,
si kaprolli sakati vrapueka,
që deri dje me tërfurça veç eci!

Mali i shenjtë, përmbi malet ma të naltat,
ngrehu sot!
Qe vegoi drita jote, vegoi rrezja mbi bijtë e
premtimit:
eni të ecim në këtë dritë gazmendplote!

Ti Lajmëtar, që bje “Lajmin e Mirë”,
Lësho pa frikë me fuqi zanin tand,
thuej: “Një Bir Shpëtimtar na kje dhanë”
dhe jehona të marrë dhenë anëkand!

Popujt mbarë vrapojnë e thërrasin:
të vemi “Malit të Shenjtë së bashku përp-
jetë,
të ecim, të ecim në shkëlqimin prarues,
neve sot na dha Lajmin e Mirë fletë!”

ATË PJETËR MESHKALLA S.J. *Kanga e Aristotelit*

Atë Pjetër Meshkalla, emri i të cilit është skalitur në shtegun ku kalojnë tërë guximtarët shqiptarë, ishte një poet i mrekullueshëm, me një thellësi domethënëse ku arrihet nëpërmjet një përvoje estetike, filozofike e panteiste krejt të veçantë. Prandaj, për të drejtuar lexuesin në këto hapësira që bashkë me kënaqësinë e leximi nxisin edhe procesin e mendimit, përzgjedha këto pesë poezi, si një derë e sigurt para se të gjindesh në universin e brishtësisë emocionale të një njeriu aq të fortë sa Meshkalla, emër tanimë edhe i lidhur, prej tre dekadash, me shkollën jezuite në Shkodër.

(A.D)

Mos t’i ndahemi dritës, të vrapojmë,
qe, po çfaqet e Zotit lavdia,
rruga e tij asht mëshira e shërimi,
ligji i ri: vllazënimi e dashnia.

Jeta

Qatë ditë që ti na u linde,
me ty u lind vdekja, o djalë,
e jeta u shkep
prej teje kinde – kinde
porsi shkep
që deti gërryer me valë
pa u ndalë...

U gëzove
në puhinë e prandverës,
mbas erës
kërkove
n’për hije gjelbërore,
këngësore,
dhe u ule
me zogj e me lule,
plot shend
me ngrehun kuvend,
dhe i pëvetë:
“sa gëzohet në këtë jetë?”

Një lule po të vyshket përbri...
po çelet një tjetër në njomësi...
një tjetër porsa veç ka mbijë...
Zogjët në çerdhe kah jeta cicërojnë,
pa pupla shtrijnë qafën, t’u kojë
shujtë nana, në sa puplat këtë e lëshojnë.

Hapat shpejton, nuk rri udhëtari,
shpejton dorën
për të mbledhun nëpër shteg
tufa visari,
për të pamartë kunorën,
pse në atë breg,
që synë ia ka tërhjekë,
ku do me prekë,
e di, se e vërtetë jeta e pret,
se vdekja ma s’e vret:
as rininë, as pasuninë,
tenja as ndryshku
ma s’ e grijnë!

Harroj

Porsi e Drinit binjake rrjedh vala,
herë e turbullt, rrëmbyese, e kaluesit
i kërcënohet me ushtimë, e s’njeh fala
kah me gjire përpjise e rrethon.

Hera këthiellët, e kandshëm vështuesit
i pëshpëritë, tue lëmue bregun, si të thotë:
“Tash kalo në pasqyrë time... pse kote?”
njashtu jeta, tue ndrumun, kalon.

Por njeriu, kur të zezë morden tue u hjed-
hun,



nëpër shkumbë heton ngjatas, i mjeri
të mbramen frymë, me duer nalt, di me
mbledhun
ndihmë nga Qielli kërkon, me premtim...

Këthiellët uji... tue kënduemun kësihëri
po kalueka, shpërvjelë, nëpër va...
balli i qeshka, rrezikun s’dro ma...
harroi Zotin, që thirri në ngushtim!

Jetë e re

shpirti asht mbushun me dëshirë,
më ndriti mendjen e vërteta,
vuejtjet më duken gurrë me hire.

Lindi Krishti në zemrën time,
më pruni pagje e dashuni,
më veshi forcë e ngushëllime,
zhdukua errësinë e burgut të zi.

Unë dikur me mburrje shkojshe
për pusina, kurtha e leqe,
krime në terr unë farkëtojshe,
hodha vrapin për rrugë të keqe...

Epshi e faji janë veriga
që tue të lëmue, të skllavërojnë,
shpirti s’ka qetësi në punë të liga
që veç rrathët më fort shtërngojnë.

Mallkue kjoftë për jetë mbrapshtia,
rruga e turpit sot kjoftë pre,
u thyen prangat, këthej liria,
shtegu u hap për jetë të re!

Shën Injacet

Grigjë shenjte, fatlume
e Krishtit, qëndro,

asht dora hyjnore
që të ruen, s’ke pse dro.

E ferrit kur mënia
mbi ty randë gjëmoi,
Lojollën Jezusi
për ndihmë t’a dërgoi.

Të kjoftë lumënia,
të kjoftë lumënia,
o Zot, ma e nalta,
o Zot, ma e nalta!

Në ballë emnin e Jezus
njaj të zgjedhnes ushtri,
Injaci tue i primun,
i sjellë fesë lavdi.

Me vuejtje e fitore,
si Krishti në Kalvarë,
ushtria e fatosit
ka dyndë botën mbarë!

Të kjoftë lumënia,
të kjoftë lumënia,
o Zot, ma e nalta,
o Zot, ma e nalta!

Rrëmbime...

Sa të kënaqë vetmia
e një bote në qetësi,
të rrëmben shoqënia
e kthiellët e pa mashtri.
Me vjollca e zymyla,
dallëndyshta e bylbyla,
nëpër lëndina,
nëpër çetina,
në madhëstlinë magjepsore
të natyrës virgjinore!

Kroni lehtas shqit
nëpër hijet e pyllit,
gjethi fëshfërit
tue sjellë jonet e fyellit;
tufat blegëruese
dhe oxhaqet tymuese,
bigat e kreshtat,
shkëmbijtë e breshtat,
bashkasi ligjërojnë
në atë gjuhë që ata e kuptojnë.

Në gjire i patrandshëm,
dielli rreh kandshëm,
terrinn shëtitë,
hana në dritë.
Hyjet vezullojsa,
zogjët cicërojsa,
shpirtin ngacmojnë
dhe e naltësojnë.

Ju, o lisa mali,
gurra kristali,
në rreze përshkohi,
e njomësohi...
Vala mbas vale,
o det, ku u ndale?
mendja zatetë,
e shpirti tretë...

E shpirti tretë,
me fletë rrëmbimi,
lart, në një tjetër jetë
lart, ke ai ded përfundimi,
ke ma i pari Burim,
pranë Jetës pa fillim!

Këndo (Shën Mërisë)

Përmbi lila e karajfla,
jesemina e felsigena,
mbi hieshinë e drandofillit,
që s’ia del në lule kurrnjena.
Më ngreh plot andje Lulja e Qiellit,
që më vegoi tek sytë i çila
edhe u vuna për shtegtim.

Shoqe s'kanë në lëndina të blerta,
bimët e njoma lloj – lloj fara,
ke i ndritë vesa prej agimi,
thue se engjujt me duer të mbara,
i kanë veshë me ngjyra am'shimi,
me njom'sinat e përherta,
si ata vetë ndër vëllaj të Tenzot.

Flladi lehtas tue lëmue barin,
tue përkundun landët e zgjueme,
balsam hapë, kënaqësi përtrise,
bashkë me harmoninë e gëzueme
të zogjve, që me kangla grise
nëpër çuba e lisa daren
fluturim prej gembì në gemb.

Gurgulloni përroje, këceni,
tue lodrue për krepa e curre,
e të kulluet si argjandi udhëtoni,
nëpër bare e nëpër shkurre.
Por, ndër fusha tekta të shkoni,
leni atë turr, në kristal që keni,
të pasqyroni çka u rrethon...

Leni atë turr, e më gjegjni, u luta:
në ato pyje prej kah vini,
në atë kupë qielle vezullore,
pse ma ngjatas atje i bini?
A thue patë mbi ndoj terthore,
këso visaresh, që ma e buta
stinë ndër fusha derdhi këtu?...

Ju po heshtni, pse nuk bëzani,
në këtë heshtje diçka më thoni,
se visaret bashkë qëndisni,
se kangë të madhe bashkë këndonì,
për Njatë që Hyji e bani
Zojë Gjithësije pa kund cak.

Folni, folni! Merr pre' Empirit,
në hapësi të Zotit madhni plote,
mbushë me vizëllime prej djamanti,
në bjeshkë e biga që s'dronë mote,
prej kah u darët, o përroje argjanti,
mje në këto logje të njomë dëshirit,
Kunorë Zojës Natyra i rri!

Lart nga diellat brohoria,
derdhet brigjeve anembanë,
e u përgjigjet fusha e mali,
ke i këndojnë Virgjinës Nanë,
që madhëni e njomësi u falë:
pa njatë dritë që i jep Maria,
s'qesh natyra, vyshket në terr!

Vyshket edhe zemra e shkretë,
porsi bari për nën kosë,
kur i ambli syni i së Lumes,
rrezet mbi krye tim i sosë...
Por kur fëtyra i qeshë së Bekuemes,
ngjallem, e me tokë e me dete,
lavdinë Nanës ia këndoj!

O kujtime!

Sa e përvëloni zemrën time!
Më këputi malli për me ndie
prej organi 'i melodie...
tretun bote, për kaq mote,
vdekë, e pa venomë *

bjeri fort njatij metali,
që mbi retë e bardha të vijë,
në burgun tim ai za harmonije,
dhe të shprazet si tallazet,
brenda të errtës dhomë!

Bjeri, bjeri,
der'sa të hapet përnjëheri,
njejky varr që më ndryen për së gjalli,
e në Kishë festën vetë ta shpalli,
dhe si 'i herë në gëzim pranvere,
kangës bashkë të ia thomë!

Amshim dhe poezi

Përzgjedhi dhe përktheu: Xhoina Salaj



“Vdekja s’është asgjë”
- Henry Scott-Holland

Vdekja s’është asgjë.
Nuk ka peshë.
Veç jam larguar pak,
në një dhomë tjetër.

Asgjë s’ka ndodhur.
Gjithçka mbetet siç ka qenë.
Unë jam unë dhe ti je ende ti,
dhe jeta jonë e dashur e përbashkët
mbetet e paprekur, e pacenuar.
Çfarëdo që ishim për njëri-tjetrin,
vazhdojmë të jemi.
Thirrme me emrin e vjetër, ashtu si dikur.
Folu për mua siç flisje përherë,
pa tone të ndryshuara,
pa trishtim në zë dhe harroje zinë në fjalët
e tua.

Qesh, siç qeshnim bashkë me shakatë e vogla.
Luaj, buzëqesh, mendo për mua, lutu për mua.
Emri im le të jetë fjalë e zakonshme në shtëpi,
siç ka qenë përherë, pa peshë, pa hije.

Jeta është ende ajo që ka qenë.
Asgjë nuk ka ndryshuar.
Ka vetëm një vazhdimësi të plotë, të qetë.
Vdekja? Një aksident i vogël, i pavlerë.
Pse të më harrosh, vetëm se s’më sheh?
Unë jam këtu, po të pres,
veç për pak çaste,
diku afër,
pas qoshes.
Çdo gjë është mirë.
Asgjë s’është lënduar e asgjë s’është humbur.

Një çast i vetëm dhe gjithçka do të jetë
sërish si më parë.
Dhe sa shumë do të qeshim me dhimbjen
e ndarjes, kur të takohemi prapë!

“Pamja nga rruga pa kthim”
- Alison Tafel

Flladi i lehtë s’pëshpërit më,
uji ulërin madhështi të trishtë.
Këmbët i dridhen e i përkunden
mbushet me frymë se mbërrin çasti i grizhdë.
Gishtat shkëputen nga ura,
shpejt do ta përpijë lumi mallkim.
Sytë i mbyll, po prapë i hap një grimë,
të shohë ç’është pamja nga rruga pa kthim.
Një erë e ngrohtë, një diell veror,
një lumë si brerore mbretërore.
Një valë e ëmbël të pushton, të mashtron,
e sjell një qetësi fisnikërore.
Po fluturon tani.
Ndryshe nga toka, tani sheh kudo gëzim.
Gjithçka vaj do to të ishte,
po të mos merrje rugën pa kthim.
Përpëlitëm t’i shpëtoj tokës që më thërret.
Ç’mund ta ndalë tani këtë rënie?
Do të jepja gjithçka që gishtërinjtë të preknin
zenitin atje lart, gjithë ëndje.
Po s’mund të ndodhë, gjëma është bërë,
heshtja përmyt të fundit tingëllim.
Para se të hidhja hapin duhej ta kisha parë,
pamjen nga rruga pa kthim.
Vërtet duhej të kisha menduar për
pamjen nga rruga pa kthim.
Do të doja ta kisha ditur,
si dukej pamja nga rruga pa kthim.

“E mbaj zemrën tënde me vete”
– E. E. Cummings

E mbaj zemrën tënde me vete (e mbaj
në zemrën time) askund s’rri pa të (kudo
që
shkoj vjen edhe ti me mua, e dashura ime;
dhe çfarëdo që të bëj, është vepra jote,
zemër)

S’kam frikë
nga asnjë fat (sepse ti je fati im, o xhan)
nuk dua
asnjë botë (sepse shumë e bukur je ti bota
ime, besnikja ime)
ti je çfarëdo domethënieje të ketë pasur
hëna
dhe çfarëdo që të ketë kënduar dielli

Ja fshehtësia më e thellë të cilën s’e njeh
askush
(ja rrënjët e rrënjëve dhe pipthat e
pipthave
dhe qiejt e qiejve të drurit të quajtur jetë
që luhatet
më shumë se sa që mundet zemra të
shpresojë
ose sa mundet mendja të fshehë)

e mbaj zemrën tënde me vete (e mbaj në
zemrën time)

“Mos rri në varrin tim e mos qaj” -
Mary Elizabeth Frye

Mos rri në varrin tim e mos qaj,
Nuk jam aty. Nuk fle.
Unë jam një mijë erërat që fryjnë.
Unë jam shkëlqimet e diamantit që borën
mësyjnë.
Unë jam drita e diellit mbi grurin e pjekur.
Unë jam shiu i vjeshtës i mekur.
Kur zgjoresh në heshtjen e mëngjesit,
Unë jam nxitimi i shpejtë lartësues
i zogjve të qetë në fluturim rrethues.
Unë jam yjet e butë që ndriçojnë në natën
e hekurt.
Mos rri në varrin tim e mos qaj,
Nuk jam aty. Unë nuk kam vdekur.

“Larg syve të mi”
- Henry Can Dyke

Po qëndroj buzë detit. Një anije bri meje
hap velat e bardhë në flladin e erës dhe
niset me shpejtësi
drejt oqeanit të kaltër. Është një pamje
bukurie dhe force.
Qëndroj dhe e shikoj derisa, më në fund,
varet si një pikël
reje e bardhë, pikërisht aty ku deti dhe
qielli takohen e bëhen një.

Pastaj, dikush pranë meje thotë: “Ja, iku.”
Ku iku?

Iku larg syve të mi. Vetëm kaq. Ajo është
po aq e madhe në direkt
dhe në trup, sa ç’ishte kur u largua nga
unë.
Dhe është po aq e aftë të mbajë barrën e
saj me shpirtrat e gjallë drejt portit të
saj të caktuar.
Masa e saj e zvogëluar është tek unë, jo tek
ajo.

Dhe, pikërisht në çastin kur dikush thotë:
“Ja, iku”,
sy të tjerë po e shikojnë të afrohet, zëra të
tjerë
gati të bërtasin: “Ja ku po vjen!”

Dhe kjo është vdekja...

ISLANDË

Do të shtegtoj në Islandë
si një tufë zogjsh, si dy tufa gruri
që ecin drejt diellit
derisa të fiket, lëkura e tyre
e lidhur me fije të buta
në marramendje

Them: është e sigurt
nuk do të thotë: siguri

do të thotë:
trupi im është i lidhur
dhe pluskoj si një amebë
e lirë
si një jelek shpëtimi
pa njeriun
që po mbytet
Kjo bërthamë bosh
është Islanda:
nevoja ime
të ngrohem
e hedhur në ujë

dëshira ime
të të shoh
e copëtuar nga bomba
në barkun tim

duart e mia
mbajnë dylbi
dhe më vëzhgojnë nga bregu
në shpërthimin
që më thërret

të harroj emrin tim

*

Islandë

Qëllimi për t'u bërë e ftohtë
Të kem vetëm mendime shterpë
dhe të shqiptoj vetëm fjali të thjeshta
të përplasem mbi një shkëmb kripe të
njomur
dhe të ha qull tërshëre pa kripë

të vesh çorape të trasha leshi
të mohoj afërsinë e njerëzve
dhe një herë në muaj të vizitoj
dhelpra të bardha

Uroj një ngrirje të përjetshme
Do të doja që oborri i dhomës sime
të bëhej perandoria e saj
të shtrihesha mbi jastëkët e saj

dhe të më tregonte se në rini

ulej mbi kraharorë burrash të rinj
dhe qëndronte aty
derisa të mbaronte
ajri në mushkëritë e tyre

*

Të shkruaj nga Islanda:
këtu është gjithçka e bardhë
si në fotografinë mbi retë
nga dritarja e avionit
kur po vija tek ti

Gjatë ditës, qielli dukej
si të ishte Poli i Veriut
dhe Toka ishte e padukshme

Gjatë natës, pista e uljes

ngjante me rrjetë yjesh

Lë në heshtje detajet errëta
Gënjej se ra borë
Letrën nuk e dërgoj përfundimisht
nuk filloj të urrej botën
shtrihem lakuriq nën mbulesa
dhe nuk qaj

MARIJA DEJANOVIĆ

Islandë

Poezi | Përktheu: Alma Braja



*

Bërthama jote është e vogël
e kuqërremtë, e butë, e lëmuar
ind nën një grumbull thikash

Një mëngjes të bardhë
do t'i nxjerr jashtë një nga një
si kunjat e një tende
dhe do t'i ngul në ballët e njerëzve
që të lanë të pambrojtur

MIRËSIA NDAN DITËN NGA NATA

Në kopsht ka dy qen – bastardë
kush e di nga sa rraca të ndryshme.
Pas shtëpisë, shkurret e shegës duken si
plagë
që u hap nga mungesa e krehjes,
larjes, përkujdesjes

Çdo ditë e dëgjoj t'i bërtasë atij
këlthet si një zog gri e pastaj
një e qarë njerëzore e mbytur
Kur drejtoj veshët ta dëgjoj,
si nga brenda ujit
më shkatërrova jetën dhe për fajin tënd
nuk kam askënd
dhe lehja e qenit
por do ta shohësh, një ditë që nuk do të

jem më,
gjakun e kujt do të pish me pipëz

dhe nuk e di nëse ia thotë burrit të saj
dhe i sillet sikur të ishte qen,
apo qenit, dhe i sillet sikur të ishte burri i
saj.

Jam e sigurt se dashuria ndan kafshën
shtëpiake nga endacaku
ashtu si dashuria ndan ditën nga nata
dhe jam gjithnjë e më e bindur se asgjë e
rëndësishme
nuk e ndan njeriun nga kafshët e tjera.

Asgjë e sigurt nuk duket në errësirë
shkurret e shegës
duket se lulëzojnë nxitimthi mes gëzofit
të tyre.

Shegët e pjekura janë polipe
që fryhen në qafë nga shtrëngimi i
zinxhirit

dhe dalin nën gëzof.
Nuk jam e sigurt nëse shpërthen vdekja
nga lëkura
apo është jeta që përshkon zinxhirin.

Një dimër të rëndë
rrëshqiti ajo në rrugën e ngrirë teksa sillte
ushqim për qentë
dhe theu këmbën.

Ëndërrova se më në fund vdiq
dhe pushoi së torturuari veten dhe qentë
se kishte rënë ngricë dhe mbuloi shegët
këmbën dhe polipet.

Ëndërrova se erdha me një sharrë preva
zinxhirët e tyre

dhe i lirova njëqind qentë e saj që
të gjallë e të vdekur
më në fund ikën

ikën në rrugën
që të nxjerr jashtë oborrit
për të ngrënë trishtimin e saj dhe për t'i
lëpirë plagët.

ÇELËSI

Në dashuri gjithçka është mbrapsht
Të ndahesh do të thotë të fillosh nga e
para
dhe të largohesh do të thotë të vish

Të enjten të mbledhësh veten:
të qëllosh e të përqafosh veten
ta bësh të ndihet ngushtë

Diçka e çuditshme ndodh në qafë
lindi një fjalë e vogël

Të mërkurën tha kam një dhuratë për ty
diçka që të të kujtojë mua
dhe më dhuroi një kuti bizhuterish të
lidhur me spango

kaluar në spang ishte çelësi i shtëpisë

Nuk doja ta merrja çelësin ndaj më tregoi

si të hapja me forcë apartamentin e tij
duke përdorur një kartë krediti

Megjithatë, e vura varësen në qafë
– mbrapsht, që të mos më grabisnin –

dhe dola për një shëtitje të gjatë

Ishte e enjte, mbrëmje e ngrohtë

Ishte një mbrëmje e bukur kthjelltësie

Të premten në mëngjes ndërrova bravën
që t'i përshtatej çelësit të tij

E PAVDEKSHME

Forca ime më e madhe është
që ndonjëherë dëshiroj të mos ekzistoj
Kështu, kur ekzistoj, atëherë vërtet
ekzistoj

Do të duhej të vinit të më vizitonit
të shihnit se jam mirë
Mbjell bimë në vazo të shtëpisë
helmuese dhe shëruese si dashuria e nënës

Në kopsht – barishte të egra
rezistente dhe të heshtura si dashuria e
babait

Më përkasin ato që janë të miat
Dhe asgjë tjetër
Prandaj mund t'i ndaj me ty
natën dhe ditën

Ti nuk je e vdekur
E pavdekshme je si moda e vetullave të
dendura
Dhe si kafeja e mëngjesit

Herë pas here dikush thotë se nuk ekziston
– atëherë si ka mundësi të të shoh në
fytyrat e të gjithëve?

Marija Dejanović është poetë,
kritike dhe redaktore, që jeton midis
Kroacisë dhe Greqisë. Përmbledhja
e saj e parë poetike, u nderua me
Çmimin Goran për Poetët e Rinj dhe
Çmimin Kvirin. Përmbledhja e saj e
dytë, fitoi Çmimin Zdravko Pucak.
Përmbledhja e saj e tretë, ishte
kandidate për Çmimin Tin Ujević
dhe u botua në Serbi (2022), në Greqi
(Thraka, 2023), në Shtetet e Bashkuara
(Sandorf Passage, 2023) dhe në
Maqedoninë e Veriut (2024). Në vitin
2020, drama e saj u nderua me Çmimin
Marin Držić nga Ministria e Kulturës
së Kroacisë. Përzgjedhje trigjuhëshe
të poezive të saj janë botuar në Greqi
(Κύκλος Ποιητών, 2020), në Gjermani
(Hausacher Lese-Lenz, 2022) dhe në
Turqi (Istanbul Ofine, 2024). Poezia
e saj është përkthyer në rreth njëzet
e pesë gjuhë. Marija Dejanović është
anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve të
Kroacisë, e Qendrës

Kroate PEN dhe përfaqësuese
në Komitetin e Grave Shkrimtare të
PEN-it Ndërkombëtar (IPWWC). Ajo
bashkëpunon, duke shkruar ese dhe
kritika librash, me gazetën kroate
Jutarnji List. Punon në shtëpinë
botuese greke Thraka.

Poezitë e përkthyer janë
përzgjedhur nga përmbledhja
"Dashuria ndan ditën nga nata, shtëpia
botuese Thraka, 2023

E panë
trupin lakuriq e të copëtuar të atdheut
tim.
E filmuan dhe i shpërndanë fotografitë
dhe xhirimet me rezolucion t’lartë.

U tmerruan n’tana anët, mallkuan,
u shqetësuan e u mbuluan djersësh.

Brohoritën dhe i dhanë zemër,
u çuditën që hala po merr frymë.
I duartrokitën qëndresës dhe trimërisë
së tij.

I ofruan bukë e ujë,
peceta t’lagura,
një vend me fjetë,
leje pune,
krejt falas.

E ndërkohë
një qen i tërbuar
ia shqyente mishin me dhambë,
prej gishtit t’vogël
deri te damari i fytit.
U mblodhën te tanë,
Me armë e gishta n ’këmbëz,
por asnjë s’shtini,
se mos po trazohet qeni
nga tundja e beftë.

26.03.2022.

sa t’ pakëndshme, sa t ’frikshme këto
vargje,
t’ mbushura me mllef,
pa asnjë pikë korrektese politike

as hijeshi,
as estetikë,
metaforat kanë vdekë para se me lindë,
janë shkërmoqë

janë varrosë
në parqe fëmijësh,
poshtë kryqeve
t ’ngulura me ngut

janë ngri
n’ pozita të panatyrshme,
afër hyrjeve të ndërtesave,
mbuluar me hi

kanë pjekë bukë mbi flakë,
me mbet gjallë

kanë vdekë prej etjes,
nën gërmadha

nën flamur t ’bardhë
prej një çarçafi t ’rëndomtë,
janë shoshitë prej plumbave në makinë

me çanta të mëdha në shpinë,
rrinë të shtrime mbi asfalt,
me fytyrë nga toka

afër qenve e maceve të t ’ngordhura

më falni, por veç këso vargje,
kaq kemi sot për ju,
të nderuar zonja e zotëri
publik i dashur
i teatrit të luftës

31.03.2022.

E barti trishtimin në një bohçe,
në rrugën e mbushur me njerëz.
Trishtimi qan me zë t ’mprehtë.



Njerëzit acarohen:
“Qetësoje trishtimin,
boll ma me gjamë.
Mbuloje ma diçka ma t’ngrohtë,
jepi me hangër,
vene me fjetë.
Trishtim asht trishtim,
secili prej nesh e ka.”
Por trishtimi ma ven gjoksit n’flakë,
si ballë i skuqur zjarrmie.
N’ sytë e tij,
mijëra si na,
t’ rraskapitur. Këtu e tash.
Qaj, trishtimi jem, qaj.

3.04.2022.

Aidës
Nuk jemi pa qe një çerek shekulli.
Dhe folëm pafundësisht për luftën.
Tre vjet e gjysmë nën rrethim.
Një vjet e gjysmë nën raketa e dronë
Shahedë.
Sot, fëmijët tanë janë dy rrjedha zërash
që s’kanë si të mos shkrihen në një,

sikurse përvojat tona.
Në sfond pulsojnë ndërtesat,
të kafshuara nga copëzat e predhave. Ky
ishte dikur
qyteti i fëmijërisë tënde,
i përgjakur,
mbeti në këmbë
mbi shputa të rrahura.
Me trëndafila të rritur përgjithmonë në
lëkurë,
me të bardhën therëse të gjembave
të gurëve të varreve,
me vrima, me çarje,
të ndriçuara nga dielli.
Me një etje të egër
për festë.
Do ta mbijetojmë edhe këtë, – thua ti –
Jeta do të vazhdojë. Do të bëhet mirë,
edhe pse ndryshe.
Uji rrjedh nën urë, i murrinë, i turbullt,
zemra e qytetit që pompon gjak,
dhe mendimet shpërndahen
si kotele.
Njëra vrapon mbi çati,
një zot i vogël i zi i së tashmes.
Do të mbijetojmë,
por jo të gjithë.
Përqafohemi, dhe – mirupafshim.

“You’re still alive, thotë ajo. And do I
deserve to be?”
Dhe për të pestën herë para gjumit
jehon
ose thirrja për namaz,
ose thirrja për shpresë.

2.07.2023., Sarajevë

FJALËT

Kush tha se fjalët nuk vlejné më sot?
Fjalët tona, që po shkruhen në ajër
me shufrën e përvëlur të ajrit që
nxjerrim,
që godasin si gjak i mpiksur në buzë të
zbehta,
po priten në dheun përfundi këmbëve,
po ulen mbi rrobat e këpucët tona,
si pluhuri i shtëpive të rrënuara.
Fjalët tona
shtrihen deri tek ata që i duam – tek ata
që janë shpërndarë
mbi hartën e vendit të shpuar me
plumba,
përgjatë fijeve të forta që lidhen në
zemra,
përgjatë litarëve të tendosur të
qëndrimit bashkë.
Sa shumë dimë të duam si një.
Sa shumë dimë të urrejmë.
Fjalët që i fusim çanta shpine
pak para se të ikim.
Fjalët që i rrëmbejmë
për të mbajtur një zot e di çfarë lloj
ekuilibri,
kur toka na zhduket nën këmbë si një
stol i paqëndrueshëm.
Fjalët që i shtypim fort mbi një plagë të
hapur,
mbi barkun e shqyer të njomë të vajzës
së re, siguri.
Fjalët tona, të rënda e të fryra nga
zemërimi,
të nxira prej zisë,
si mbulesa prej betoni të një bunkeri të
vjetër.
Nuk ka asgjë më të qëndrueshme,
asgjë më pak të përkohshme.

21.03.2022

Yuliya Musakovska është poete, shkrimtare dhe përkthyes nga Ukraina. Ajo është autore e gjashtë përmbledhjeve me poezi, përfshirë Бор свободи (Zoti i lirisë), e cila u botua në anglisht nga Arrowsmith Press, dhe hyri në listën e ngushtë për Çmimin e Qytetit të Lvivit dhe u shpall nga Kyiv Independent si një nga 10 librat më të mirë që lidhen me Ukrainën. Poezitë e saj janë përkthyer në mbi 30 gjuhë dhe janë botuar, ndër të tjera, në The Southern Review, Tupelo Quarterly, The Common, AGNI dhe The Continental.

Në vitin 2023, ajo ndërpreu karrierën e saj njëzetvjeçare në fushën e IT-së dhe biznesit ndërkombëtar për t’iu përkushtuar letërsisë dhe avokimit për Ukrainën në botë. Është anëtare e PEN Ukraine. Ajo ishte rezidente e programit International Writing Program (IWP), në Universitetin e Iowa-së në vjeshtë 2025. Jeton dhe punon në Lviv.

UNË DAL NË RRUGË ME ENGJËLLIN

Unë dal në rrugë me engjëllin.
Si një zinxhir i mbështjellë rreth dorës.
I zbardhur nga gëlqerja e mureve.
Burrat që takoj më lëpijnë dorën dhe nyellin* e këmbëve,
më ndjekin nga afër.
Unë eci mbi ta si mbi thëngjij të ndezur,
Si mbi një dallgë, si mbi çatira.

Nuk kam pik mëshire për burrat që më duan.
Zinxhiri im ka hapur në kurrizin e tyre bebëza gjarpri.
Më përshëndesin të gjithë ata që kanë fjetur ndanë çative të larta,
Ata që i kanë zhytur mushkëritë e tyre deri në thellësi të ujërave
-si qen gjahu hollakë - dhe i kanë mësuar të marrin frymë atje.
Më përshëndesin nga poshtë, të tjerët civilët.
Të sëmurë nga komatoza.
Ata të cilët i kanë thyer dhëmbët me një shufër hekuri.
Klinikat kryesore, ndërmjetësuesit.
Më përshëndesin të pafatët, gandimet, kolla.
Ndoshta nën shtrat ende nxjerrin tym tytat e armëve.
Unë dola në rrugë me engjëllin. Kthehem në shtëpi.
Si një zinxhir i mbështjellë rreth dorës.

PISTOLETA E NDËRZIMIT

Krejt si ajo dritë që e skërfitin nga retina
në një bodrum të fshehtë, si një projektor që të lëshojnë në sy,
kështu e përfytyroj unë vdekjen e poezisë.
Meqenëse nuk është përcëllima e vdekjes ajo që i nxin
eshtrat, por, të lerosura, *kodi bar* dhe trapanot
e dekorimeve,
gotat që të ftuarit, të hareshëm, i hedhin deri në tavan,
-fosforeshehte!-
dhe muzikantët e egër që vijnë t'i kapin me gojë.

Për këtë arsye unë shkruaj poemën më të mirë
që mund të shkruaj.
Poemën që zhbiron rrashtën, shqyen të qepurat e plagës të bëra me tegel
dhe i lë arteret e saj, si tuba
me presion, të përpëliten, të lirë, rreth qafës.
Që i çallaton kyçet e duarve të ajrit
dhe i çliron prej tyre zotat, gurët.

Praktikon kruarjet më të mëdha mbi fletën e letrës
dhe nën armë.
Por dora, me të cilën shkruaj, ndahet nga trupi,
si duart e të burgosurve siberianë
të fshehura midis trupave të stivuara në trena të gjatë
të kallkanosur që nisen nëpër botë.
Asgjë, as edhe një rënkim nuk gjëmon
përmes tunelit metalik të gjuhës.

Unë e zgjat dorën, e ruajtur nga kanatet e klinikës,
nga qen stani të bardhë stani të kanateve,
pikërisht aq sa duhet, me qëllim që ajo të shkruajë poemën që i lan këmbët e tua me urinën e saj.
Asnjë gji, asnjë re nuk dridhet.
Ndoshta armët e sulmit.

Rrugët.

Dora ime e lidhur si një prangë
me vizionin që ajo ka për poezinë.
Dora – e shkëputur nga trupi – duke u valëvitur mbi botë.
Një pistoletë ndërzimi në fushëveprimin e saj.

ANJË BURRË NUK TË MBROJTI

Burrat që të takojnë gjithnjë bien në peshë.
Asnjë burrë nuk të mbrojti dhe ata që u përpoqën
fshehurazi, ti i çave më dysh, me shpatë,
deri në brez.
Asnjë burrë nuk të mbrojti , dhe ata që u përpoqën
i dëbuan gatat kobtare nga gjinjtë e tu
me gjuhën e tyre harruan që çdo fallus i vdekur



beson se gjinjtë e grave lëshojnë një dritë që ndizet e shuhet.
Asnjë burrë nuk të mbrojti dhe ata
Që u turrën si free-runners¹ të tërbuar nga një këllk në tjetrin, ti i përzure.
pas kokëçarjesh, caqesh, ilaçesh,
ti i përzure në farkën e vjetër, përmes së cilës ata kishin kaluar dikur. Asnjë burrë nuk të mbrojti, nuk e kuptoi nga vinte hapi yt i lehtë, që përhapte aq shumë trishtim mbi zverkun e trashë të atyre që të ndiqnin. Asnjë burrë nuk të mbrojti dhe ata që u përpoqën, duke veshur uniformën mbi lëkurë, të kërkuan t'u bëje vend në trupin tënd të qashtër.
Dhe trupi yt duhej t'i mbështillte krejt ashtu si një mollë e butë që, pa e ditur, mbështjell krimbat.
Asnjë burrë nuk të mbrojti, dhe ata që u përpoqën befas u fshehën në gardërobat e notareve.
Ata u shpërndanë në shtëllunga përrallore, duke u përpjekur të ngjitesh përsëri e përsëri.
Asnjë burrë nuk të mbrojti dhe ata që u përpoqën, Nën dritën e kamxhikut tënd, me fjalët e tyre të paralizuara, ecnin mbi to si elefantët me feçkë,
dhe plandoseshin në shtrat. Fillikate, ti ngrije ballin
Dhe vështroje muzgun, qiellin e mbushur me enë gjaku.
Asnjë burrë nuk të mbrojti. Sikur midis tyre disa të ishin djelmosha që gjithnjë ndalen ca kohë në shurrëtore.
Dhe të tjerët, ca ujq të vjetër deti, të cilët presin që erërat, mjegullat, sirenat të ndezin flakët e rrufesë si dukur në majë të pajorëve, asnjë burrë nuk të mbrojti
Dhe atyre që të vështruan, në pavetëdijen e tyre përmes mjegullës së prirjes së tyre curriluese ti u the me një zë bubullues se asnjë burrë nuk të kishte mbrojtur.

Se ata ishin shtrirë të gjithë në shtratin e zi të shqisë, të verbuar e të infibuluar² si para vajzave të eksizuara të Afrikës.
dhe asnjë burrë nuk të mbrojti dhe ata që u përpoqën të përgjërroheshin natën dhe qanin për një kohë të gjatë
me gulçe mbi ogivën e legenit tënd. Mbi thurimën e tij të trëndafilte prej krisoberili. Dhe ti u thoshe se gjatë kësaj kohe në parkun që rritej natyrshëm prapa azilit, vajza e kopshtarit germonte kraharorin e dashnorit tënd me gjinjtë e saj.
Ti u thoshe se asnjë burrë nuk të kishte mbrojtur.
Dhe qysh atëherë asnjë burrë nuk të mbrojti dhe madje nuk u përpoq. Sepse ti, eunukun tënd e fsheh nën lëkurë, nën kubin vaginal, me presion normal dhe burrat që të takojnë gjithnjë bien në peshë.

REALITETI TOUCHSCREEN

Ne ulëritëm, shamë e mallkuam,
Ne u rrokullisëm përtokë.
Midis banesave sociale të periferisë ngriheshin ngadalë pistonat e natës.
Ne hipëm në kamionë dhe pimë.
Në rrugë, vajzat shpaloseshin si flamurë.

1 *free-runners: vrapues të lirë

2 i infibuluar: që ka bërë një operacion, i cili e pengon kontaktin seksual

Ne vallëzuam e pështymë, në pimë deri në mëngjes, deri te kilometri zero.
Aty erdhën gjahtarët dhe na trokitën në derë; neve nuk na dilte gjumi, ata gërhinin.
Ata e mprehën sqepin në mure;
Me të qara, në korridoret e mugëta,
Ata i mbushën armët
Dhe u masturbuan.
Ndoshta disa shkopinj të zinj prej kauçuku,
I ndriçuan, nga afër, gandimet tona,
ata na i ndanë mollëzat e faqeve,
kur ne vallëzonim si njerëz të egër.
Realiteti na u ngjit drejt në fyt.
Dhe erdhën ata që ishin në Reanimacion.
Por ata nuk na njohën.
Ata nuk na e zgjatën më dorën, nuk na kërkuan më pakëz dritë
përmes vitrinave touchescreen³.

Ndoshta qitësit e dalluar që kalbeshin në çatira.
Janë ata që mprehën sqepin
te brinjët tona prej qelqi,
që frynë në shtonat⁴ tona prej të sëmurësh me tuberkuloz dhe u mbështetën lehtazi te pistonat e natës.
dhe të mbështjellë me disa flamurë,
ne nuk i njohëm.

URA E TREFISHTË. FOLEJA E SYRIT TË EPIFIZËS

Sikur të kishe qenë prerë më tresh, ti deshe të kaloje nëpër lumin e qetë të Ljubjanikës,
të shkoje deri në cep të urës
krijesë luspore në oborrin e kishës
që sillet atje tej, në shesh,
si një sharrë rrotullare.

Nënë, duke qarë, me një çantë me fruta në krah.
Ndoshta e mblidhte përdhe me duar,
mishin që ta kanë zhvoshkur nga kockat.
Syri i mbyllur si gjëndër epifize.

Nënë, ajo do ta dinte sesi mblidhet një sumbull loti tek ti,
e strukur si një egërsirë,
sipas ligjeve të sipërfaqes më të vogël,
mbi të cilën mund të përhapet dhimbja.
Siç kthehet një lot, atje tej, në vend gjithnjë i errët, si një trapano,
ajo shakullinë gjaku, me të cilën ti i ngrohe shkallinat e katedrales, muret, ritmin e qitjes;
Një lot, në të cilin nëna lan për një kohë të gjatë,
Si për një bir të humbur, thonjtë e shkukur,
(me)? shputën e këmbëve.

Prapa është ura e trefishtë:
përgjatë së cilës ti ikën, ti ikën,
përgjatë së cilës ti vjen, ti vjen,
përgjatë së cilës ti ikën.
Syri i mbyllur, si gjëndër epifize. Foleja e tij.

QARKU I SHPËRBLIMIT. DOPAMINË DHE KËNAQËSI

Përnatë, nyja pubiane shtrëngohet ca nga ca.
Lëkura lëmohet.
Me disa vegla të buta prej mishi,
Ne përpiqemi të shqyejmë qepjen kafkore të mendjes,
të hapim kutitë e zeza të kënaqësive.

Kështu fillon qarku i shpërblimit. Me lakoren e një viole që ruan në dhomë akustikën e dihatjeve të instrumentistëve.
Ne gënjejmë veten. Ne kërkojmë një tjetër djegie, një shtrëngim të ri – njëfarë lenteje
Përmes së cilës bota duket ndryshe,
gjërat ashtu siç janë bërë.
Trupi le të mos varet më sipër shtratit sikur ai të kjasonte nga një grremç.

Natën ne harxhojmë kaq shumë ngulmëri.
Frushullima e çarçaftit, vezullimi nator

3 touchscreen : ekran me prekje

4 shtonë: kanal i mbuluar, tub për kullimin e ujërave të tokës

i lëkurës që sekreton shumë trishtim.
Heshtja gjuha që ngulmojnë
si një urë për t'i afruar njerëzit.
Të gjitha nyjat zgjidhen shkallë-shkallë,
sipas mitit të riciklimit të shterpët.
Në kërkimin e përjetshëm e të dëshpëruar të dashurisë.
Dhe gjërat më në fund na shfaqen para syve,
ashtu siç janë.
Të zhveshura nga emrat e tejdukshëm që
i shënjojnë,
të pastruara nga fshikëza e çdo koncepti.
Të kulluara, të pashmangshme, me një mizori të
pambaruar.

Dhe nën dritare lumi përplaslet pas urës.
sikur t'i ushqente të mbyturit e tij
të katit të fundit.

URA E KËMBËVE

Ka net kur unë nuk fle.
-si një gjuhë e lidhur, pikërisht kështu fle unë-
nën këtë urë.

Në hije, ca braziliane të reja bëjnë ski në ujë,
përpiqen t'i mbërrijnë
jahtet luksoze fantazmagorike,
dhe, në udhë e sipër, buzagaz, më hedhin
monedhat e vogla të kraharorëve të tyre
vezullues,
Notaret e krolit që çajnë ujërat me shpejtësi të madhe
më blatojnë gjysma këllqesh,
qafash.

Dhe atëherë vihen në lëvizje litarët e lartë,
përtej të cilëve rrotullohen
vinçat brinjëdalë të gravitacionit universal:
si një baticë e pamasë,
realiteti dyndet drejt qiellit.

Dhe atëherë ngjiten deri tek unë britmat e atyre që
kalojnë,
pendët notuese të bishtit, hinkat prej rëre
dhe kukullat e tjera të bardheme,
të zhgojuara, të lumit,
ata ngjiten të gjithë, fantazmagorikë,
deri te breglumi im i lartë e i zhalitur.

Dhe unë si një zhytës i thellësive të mëdha
Më në fund fle,
E mbytur nën këtë urë.

ZOTI NUK E MBYLLI PËRSËRI GRUAN

Zoti nuk e mbylli përsëri gruan.
Trupi i saj u bë për t'u shporuar.⁵
Burrat gjejnë përditë
gjithfarë mjetesh
për t'u kthyer prapë aty,
Për të dalë së andejmi.
Ndoshta vetëm zhvidhosja e gjuhës,
e mendimeve, është më e ashpër.

Në hutimet nevrotike, edhe poeti thotë se
midis të gjitha formave që zotëron burri,
guri është forma që reziston më pak.
Ai thyhet.

Kjo është diçka e njohur, barku i gruas
Nuk e lë trishtimin
të ngjitet në qiell,
ai riciklon acidet brejtëse të kujtimit
gjatë një pajtimi të shkurtër - të
rrufeshëm –
me përjetësinë.
Ai dëshiron errësirën.
Dhe muskuli që e qep, e tradhton çdo çast:
ai ndryshon formë në dritën e një seksi tjetër.
Ja përse unë them se Zoti nuk e ka rimbyllur mirë
gruan.



Se trupi i saj mund të shporohet
Por shumë pak. Pikërisht aq sa mjafton
për të parë aty,
plotësisht, të ndrydhur, zotat.

REJA E OORTIT

Në mëngjes herët ti nuk i dëgjon më sesi thyhen shtrat e
tu.
Ka vetëm fiskime të djeshme që dalin nga trupi yt.
Thua se janë nënshkrime:
Ato dridhen si gjilpëra sizmike
në njëfarë seance të zgjatur
akupunkture,
voduje.

Fiskimet që ikin nga lingota poroze,
prej platini, të eshtrave të tu të vjetër
dhe ndodhen – në nënvetëdijen tënde tribale -,
si sekse, si qielli dhe toka.
Që shpojnë kraharorin,
vënë emra, shpojnë me trapano,
që rrojnë, që vallëzojnë në ajër krejt si flakët,
më gjatë sesa oksigjeni rrethues.

Të gozhduara në mishin tënd. Të prera nga mishi yt.
Në pikën e nisjes, i rilidh një fill i padukshëm,
që kuis nga larg, që nga një mish tjetër,
që nga një udhë tjetër periferike.

Ti i sheh sesi shkëputen nga trupi yt
përgjatë kësaj shmangieje narkotike,
sesi fluturojnë copë-copë diku, jashtë teje.

Ato shpërthejnë. Të lyejnë me qiriç.

GJINDJA DALIN NË RRUGË NË FETA TË HOLLA

Çdo mbrëmje, unë zbres në rrugë
dhe rruga mbështillet rreth meje
si fasha mbi plagë.

Kapërcej lumin. Qentë e tij të pabesë
më lëpijnë dorën.

Poshtë urave,
rrjedh mishi i armiqve të mi,
i ndarë në kortarë, i mavijtë.
Kështu unë eci përmes qytetit,
si një zot përtac e mizor.
Të ngjitshme, rrugët mbështillen
rreth meje, njëra pas tjetrës,
dhe kjo mbështjellje është vetë qyteti,
nën zhelet ushtarake të mëngjesit.

Gjithnjë e më imcake, gjithnjë e më mendjekthjellët.
Ja kështu eci përmes qytetit.
Si një gisht që rrëmon plagën,
që e zgjeron atë.

KUAJT E MINIERËS

Shtëpia që të ka mbajtur me bukë ndoshta të ka treguar,
natën, historinë e kuajve të minierës:
Kuajt e minierës lindin dhe rrojnë në thellësi të tokës;
Midis mureve të galerisë gjendet shtëpia e tyre, tryeza e
tyre.
Pikërisht atje, ata ushqehen me copa të stërmëdha
errësire,
thëngjilli.
Ata ushqehen me hamendje, në dritën e llambave.
Dhe, si të dënuar me punë të detyruar, ata i tërheqin
verbërisht vagonët.
Ata mbartin pareshtur,
aq sa zgjat jeta e një kali.
Ata mbartin dritën drejt sipërfaqes së tokës.

Por në sipërfaqe, në dritë, ata nuk mund të rrojnë,
madje edhe kur dalin në pension, kur i lënë të lirë
nga punët e minierës.
Prandaj ata dalin në botë me sy të lidhur.
Errësira u është ngjitur në ballë.

Kështu ata rrojnë edhe pak kohë, të urtë.
Fërgëllojnë kur ndiejnë puhizat, aromat,
Në hangarin e capërluar, në oborrin e minierës.

Me sy të lidhur,
Derisa të zbresin përsëri në thellësi të tokës.
Përgjithmonë shtëpia e tyre mbetet errësira.

5 *shporoj: shpoj tejpertej

Ndër sfidat më të mëdha me të cilat i nevojitet letërsisë sonë të përballet, mund të rreshtojmë edhe çështjen e çlirimit të figurës femërore nga hija e mashkullit. Duke përjashtuar Medean e Euripidit, vërtet të rralla mbeten ato figura femërore të cilat arrijnë të hedhin poshtë rendin tiranik mashkullor. Ky sundim, si sundimi i një diktatori të mirfilltë mbi një shtet, është i pamëshirë ndaj kundërshtarëve dhe synon të legjitimojë autoritetin duke gdhendur parimet e tij në qendër të moralit tonë, përmes librave fetarë. Tekste të cilat pikërisht për shkak të natyrës së tyre të shenjtë, e bëjnë edhe më të vështirë çdo tentativë kundërvënije.

Por nëse ne kemi mësuar një ose dy gjëra nga rrëmuja e luftës së ftohtë edhe më tej, ato na sygjerojnë se çdo regjim totalitar mund të hidhet poshtë, dhe se çarjet e tij (në këtë rast edhe të rendit mashkullor në fjalë) bëhen për ne shekuj më pas, tepër të dukshme. Kështu ne do të trajtojmë edhe **“Vdekjen e Gjon Pagëzorit”** në dhjatën e re, duke e zëbërthyer atë në një **“formulë të përgjithshme”** përbërë nga dy kushte për të identifikuar se si formësohet një karakter femëror letrar “i fortë”:

Kushti i parë: Mashkulli i dobët ose i trembur

“dhe u tha shërbëtorëve të vet: Ky është Gjon Pagëzori; ai u ngjall së vdekuri dhe prandaj fuqitë e mbinatyrshme veprojnë mbi të...Herodi kishte frikë nga populli që e konsideronte Gjonin profet...” (Mateu 14:2-14:5)

Kushti i dytë: Femra me pushtet, ambicie dhe e patrembur së cilës mashkulli i dobët i bindet

“Ajo doli dhe i tha s’ëmës: Çfarë duhet t’i kërkoj? Ajo u përgjigj: Kokën e Gjon Pagëzorit!...Dhe mbreti megjithëse u trishtua shumë nga kjo, nuk deshi të refuzojë për shkak të betimit...” (Marku 6:24)

Ç’është e vërteta, prej një strukture të tillë ne nxjerrim më shumë se një femër “të fortë”, pasi këtu Herodi (mbreti ynë i dobët) bie jo vetëm nën kurthin e gruas së tij (Herodiada ose Herodia), por edhe të bijës, Salome, e cila e joshi atë aq shumë. Për më tepër, ne këtu mund të shprehim me bindje se kemi të bëjmë me gra më të forta se edhe Medea e lartpërmendur. Kjo pasi ndryshe nga Medea e cila duhet të kërkojë ndihmë nga përtej “diktaturës patriarkale” (me zotin e diellit Helios) në arratinë e saj, dy gratë biblike nuk e kanë të nevojshme një gjë të tillë. Kundërgjithësi se vepra e Medeas ishte më e rëndë se ajo e Herodias dhe Salomesë mund të bëhet, por megjithatë ai mbetet një kundërgjithësi i dobët. Kjo pasi “pesha morale” e aktit nuk e ndryshon dot faktin themelor të çështjes: **Medea mund të shpëtonte vetëm duke thyer sistemin nga jashtë, ndërsa Herodiada e Salomeja arrijnë ta nënshtrojnë atë nga brenda.**

Por pavarësisht kësaj vërtetësie, ato do të mbeteshin të fshehura brenda miliona kopjeve të dhjatave të reja dhe trojeve të Judesë. Deri në rizbulimin e tyre nga autori i shquar francez Gustav Flober rreth viteve 1870. Flober në veçanti nuk ishte një shkrimtar i huaj me trajtimin e gruas së fortë në veprat e tij.

Rreth viteve 1840 (si na mësohet edhe ne nëpër gjimnaze) një artikull i shkurtër i papritur do të shfaqej nëpër gazetën e krahinës franceze të normandisë. Një grua 27 vjeçare me emrin Véronique Delphine Delamare, e cila jetonte pranë qytetit francez Rouën, kishte helmuar veten e saj pasi ishte e pakënaqur me jetën e saj martesore. Ajo ishte zhytur në borxhe dhe vazhdimisht e tradhëtonte burrin e saj. Kjo histori përbën pikërisht bërthamën e zonjës Bovari (tentativa e parë e francezitetit për të krijuar një grua të fortë). Sado me këto që dëshiroj të them, synimi im nuk është ulja e figurës së Ema Bovari, duhet përmendur se:

Fati i figurës femërore në letërsi dhe dy gratë që urdhëruan vrasjen e Gjon Pagëzorit

Nga Orin Maxhari

Nëse ajo do të kishte qenë e mjaftueshme për të udhëhequr revoltën kundër strukturave narrative mashkullore, Floberit nuk do ti lindte nevoja që ti rikthehej edhe një herë rrëfimit biblik në vitet 1870 (kujtoni se “Zonja Bovari” kishte në këtë kohë rreth 20 vite që ishte botuar), duke vendosur në qendër të tij Herodiadën (Herodian).

Herodiada e Flober, po ashtu si Ema e tij, gëzon dije dhe pushtet të pamatë mbi burrin e saj. Për shembull, ajo është e para që merr vesh për arrestimin e Agripës:

“- Cezari është miku ynë! Agripën e kanë arrestuar!

- Kush e tha vallë këtë gjë?

- E di unë çfarë them! - iu përgjigj ajo tetrarkut, duke theksuar ndërkaq: - Ndodhi meqë paska synuar kurorën e Kaligulës...”

Duke na treguar se ajo i njeh ndodhitë politike aktuale më mirë se edhe partneri i saj mbret.

Ajo ka vetëm një synim, të cilin e bën të qartë që në fillim. Vrasjen e profetit Johanen (Jokanan ose Gjon Pagëzori). Për të cilin ajo gradualisht merr masat, përmes manipulimit dhe mashtrimit të tetrarkut Herod Antipa. Ajo në fillim duke kërkuar mëshirën e tij shpreh:

“-...Për ty, hirësi, a nuk kam bërë edhe më shumë se kaq? A nuk hoqa dorë vallë edhe nga fëmija im?”

Ndërsa më pas ne na bëhet mëse e qartë se Salomeja ndodhet aty bashkë me ta:

“- Kush është vallë ajo vashë? – pyeti më në fund tetrarku.

Herodiada u përgjigj se ajo nuk e dinte këtë gjë, teksa qëndrimi i saj, gjer atëhere i egër, befas u shndërrua në një sjellje të butë edhe të ëmbël.”

Dhe se ajo në fakt kishte një kohë të gjatë që po përgatitej nga mamaja e saj për mbrëmjen e ditëlindjes së tetrarkut:



“Valltarja ishte Salomeja, bija e Herodiadës, të cilën e ëma përgjatë disa muajve me rradhë e pati mësuar të vallëzonte...”

Ajo kështu tregohet e matur edhe gjakftohtë. Ndryshe nga Ema e cila dështon në manipulimin e burrit të saj (ose më saktë heq dorë), duke i dhënë fund jetës së saj. Herodiada, në të kundërt, triumfon duke arritur atë që dëshiron, edhe del prej tregimit tërësisht e paprekur.


Pa dyshim një pohim i tillë do të ketë qenë edhe ndër arsytet përse Oscar Wilde do të zgjidhte të zgjeronte edhe më tej këtë vepër të Flober, kundrejt më të famshmes “Zonja Bovari” (madje edhe brenda të njëjtit shekull). Irlandezi i famshëm brenda saj do të provonte gjithashtu fatin e tij në krijimin e një femre tjetër të fortë, këtë herë përmes bijës Salome në dramën e tij me të njëjtin emër.

Me vajzën në qendër, struktura e ngjarjeve merr një rrjedhë tërësisht ndryshe. Herodia ende kërkon vrasjen e profetit Jokanan, por kjo nuk është më arsyeja se përse profetit i pritët koka. Tani ajo bëhet si pasojë e dëshirave epshore të Salomesë për të puthur buzët e tij:

“Është goja jote ajo që gjakoj, Jokanan. Goja jote është si një fashë alle mbi një kullë të fildishtë. Është si një shegë e çarë më dysh me thikë fildishi... Nuk ka në botë gjë aq të kuqe sa goja jote... Lërmë të puth gojën tënde.”

Këtu më duhet të ndërhyj e të shpreh se përftimi i konkluzionit që Salomeja e Wilde, ashtu si Herodiada e Flober të jetë një “karakter gruaje e fortë”, ajo duhet parë përmes një lenteje tjetër ndryshe nga mënyra se si ne i kemi gjykuar “femrat e forta” deri tani. Kjo pasi Salomeja, gjithashtu si Ema Bovari në fund pashmangshmërisht do të humbasë jetën, por edhe sepse po ashtu si Medea, ajo nuk mund të shkëputet dot plotësisht nga rendi patriarkal. Kështu ajo kurrësesi nuk mund të konsiderohej një histori suksesi, **por në fakt është!** Prandaj, një përfundim i tillë nuk mund të pranohet.

Së pari humbja e jetës së saj ishte një zgjedhje artistike tërësisht e Wilde dhe nuk ndodh as në rrëfimin biblik, as në tregimin e Flober. Së dyti vrojtimi se Salomeja dhe dëshirat e saj mund të plotësohen vetëm për aq kohë sa ato i shërbenin edhe fantazisë së mashkullit (në këtë rast të Herodit), ashtu si pretendonim me krahasimin tonë me Medean, nuk qëndron. Ishte dëshira e Salomesë të shikonte profetin dhe me një urdhër të saj siriani i ri e kreu. Më pas ishte dëshira e saj të puthte buzët e profetit, dhe në fund ishte dëshira e saj të kërcente për babanë që ta manipulonte atë. Ajo përbën yllin në qendër të sistemit rreth e rrotull së cilit vërtitet çdo burrë në vepër. Prandaj momenti kur tetrarku urdhëron vrasjen e saj (“*Vriteni atë grua!*”) nuk mund të shihet aspak si një pikë e fortë për mbretin. Ai në asnjë pikë të shfaqes nuk arriti ta kthente Salomenë në anën e tij, pa qenë kjo vetë një dëshirë e Salomesë. Ai nuk e kushtëzonte dot atë. Ajo nuk ishte nën urdhërin e tij. Dhe momenti kur ai urdhëron vrasjen e saj nuk është dëshmi pushteti, aq shumë sa mund të merret si xhelozie e marrë ose dobësi e fshehur pas së njëjtit pushtet.



The Apparition, Gustave Moreau, 1876

“A i qe i pastrehu i përjetshëm, i urituri i përhershëm, bujtësi i përkohshëm, njeriu që vazhdimisht e kërkoi, por kurrë nuk e gjeti shtëpinë e tij.”¹ Të tillë e përshkruan A. Tufa poetin rus (të akmeizmit por jo vetëm) **Osip Mandelshtam**. Fëminor e lojcek, i habitur e i mahnitur ndaj fjalës e kulturës, i lidhur ngushtë me gjuhën dhe të folurin si manifestim të ekzistencës njerëzore përballë heshtjes si pritje dhe mundësi të përhershme të muzikës e të fjalës, ai u njoh për një ndërgjegje të veçantë poetike e artistike, duke u përbetuar kundër zbrazëtisë dhe mosqenies.

Një ndër poezitë e viteve të hershme të krijimtarisë së tij letrare, (*poezitë e tij të para të mahnisin me përsosmërinë e tyre*), e vitit 1910, titullohet pikërisht **“Silentium”**³:

*Ajo ende nuk ka lindur,
Ajo është muzikë, dhe fjalë,
Prandaj çdo gjë e gjallë
Është një nyje e pazgjidhur.*

Fjalën “si të tillë” Mandelshtami e shihte si realitet të vetë poezisë, si Logos e si mendim të ndërgjegjshëm⁴. Kjo poezi është një shkrim/krijim për vetë shkrimin/krijimin, për procesin dhe forcën krijuese. Në këtë strofë të parë ndodhemi në pritje të “lindjes” së fjalës, të krijimit të saj si një proces krijimi poetik, ku ajo gërshetohet me muzikën pa të cilën nuk lind dot, duke na kthyer pas në kohë në artin e vjetër, veçanërisht atë antik, aq të adhuruar prej Mandelshtamit, ku mbizotëronte shkrirja/sinkretizmi i arteve në një entitet dhe ekzistencë të përbashkët estetike e shpirtërore. “E djeshmja ende nuk ka ndodhur me të vërtetë. Unë dua sërishmi Ovidin, Pushkinin, Katulin.”⁵

Në këtë pritje të gjatë e të heshtur çdo gjë mbetet *një nyje e pazgjidhur* ende, një identitet dhe ekzistencë e pamanifestuar akoma në fjalë, në Logos. Kështu, kjo strofë e parë, rima e përmbyllur e së cilës lidh/kryqëzon “moslindjen” ende të fjalës me “pazgjidhjen” e nyjes të së gjallës dhe këtë të gjallë me fjalën në sajë të së cilës arrin ta shenjojë qenësinë e vetë, krijon atmosferën e një pritjeje të zgjatur e të heshtur, gati një pritje epifanie. Kryqëzimi i këtyre vargeve me njëri-tjetrin shënjon pikërisht harmoninë metrike që synon Mandelshtami në mënyrë më se të vetëdijshme. A. Tufa shkruan: “Nëse nuk ka një kryqëzim të drejtpërdrejtë të imazheve, atëherë lidhja ndërmjet sosh kapet (ndjehet) përmjet masës së njëlojtë të vargut - ajo është e para që jep atë inerci tingullore, prej së cilës ngjizen vargjet.”⁶

*Parzm’ i detit frymon qetë –
Por si e çmendur dita çelet,
I shkumës jargavani zverdhjet –
Në të bruztën enë të zbehtë.*

Heshtja e qetësia e natyrës evokohen nga pamjet e detit të qetë e të shkumës së jargavanit, e duket sikur poeti po kërkon atë heshtjen zanafillore para krijimit përfundimtar, një qetësi e botës së jashtme që i lejon asaj të brendshmes paqen për të lindur krijimin e pastër e të çiltër poetik. Përballë imazhit të jargavanit të zverdhur poeti vendos ditën e çelur, shpresën dhe pritjen e nxjerrjes së krijimit në dritë, krijim që turret si i çmendur të lirohet e që nuk pranon të mbetet i syrgjynosur dhe i fshehur, por që gjakon qenësinë, metamorfozën/

Memecëria zanafillore e fjalës poetike: poezia e Osip Mandelshtamit

Nga Noel Boci

shndërrimin nga mendim/entitet mendor në fjalë për të arritur ekzistencën e plotë vetjake e të pavarur. Kështu, poeti kërkon qetësinë epifanike e natyrore, të izoluar nga zhurma e rrëmuja njerëzore dhe urbane, që siguron lindjen e poezisë. Ai vetë shkruan: “Gjaku ynë, muzika jonë, shtetësia jonë – të gjitha këto e gjejnë vazhdimin e tyre në qenien e brishtë të një natyre të re, natyrës-Psike. Në këtë mbretëri të frymës pa njeriun, çdocila pemë do të jetë driedë dhe çdocila dukuri do të flasë për metamorfozën e saj.”⁷ Vetë kjo poezi (metonimikisht i gjithë arti poetik) po flet për lindjen dhe metamorfozën e saj si një proces natyror dhe i papengueshëm. “Ta ndalosh? Përse? Kush e ndalon diellin kur ai rend me krahë harabeli në vatrën atërore, përpirë prej ethes së kthimit? A nuk është më mirë ta dhurosh atë ditiramb, se sa t’i lypësh lëmoshë?”⁸

*Në prekshin pra buzët një ditë
Memecërinë zanafillore,
Mu si një notë kristalore
Të kulluar prej se lind!*

Poeti ecën në vijimësi të idesë së strofës paraprake. Ai ndjen nevojën e heshtjes, qetësisë, “memecërisë” zanafillore, natyrore, paraurbane, për të krijuar poezinë e vërtetë. Ai do që t’i largohet kaosit të botës moderne (Llurjë: “Kaosi i shtinte lemerinë”) që shkatërron dhe mohon atë çka është krijuar, në mënyrë që të ketë lirinë dhe paqen që të lindë krijimin artistik si një notë kristalore e të kulluar, të paprekur apo të painfektuar nga sëmundja e çmendurisë bashkëkohore. Gjakon kohën e vjetër, antiken, ku arti qe në pedestalin e vet dhe krijuesi qe

⁷ Mandelshtam, Osip. “Fjala dhe kultura”, *Tristia* (poezi të zgjedhura, përkthyer nga Agron Tufa), Pika pa sipërfaqe, 2016, 259.

⁸ Po aty.

hyjni. “Po, bota e vjetër – është ‘bota e vdekur’, por ajo është më e gjallë se kurrë ndonjëherë. Kultura u bë një kamp lufte: ne s’kemi ushqimin, por trapezën; nuk kemi dhomën, por qelën; nuk kemi rrobat, por veshmbathjen. Së mbrami ne kemi fituar lirinë e brendshme, harenë menjëmend të brendshme. Ujin në shtambat e argjilta e pijmë si verë dhe diellin e shijojmë më mirë në një kuzhinë manastiri, sesa në një restaurant. Mollët, buka, patatet – ç’prej sodit shuajnë jo vetëm urinë fizike, por edhe atë shpirtërore. Bashkëkohësi nuk njeh veçse urinë fizike, veçse urinë shpirtërore. Për të dhe fjala është kurm, dhe buka e thjeshtë – hare dhe mister.”⁹ Kjo botë e vjetër është memecëria zanafillore, kjo paqe e krijuesit dhe e botës me krijimin, me stilin, me të bukurën. Kjo memecëri zanafillore krijuese i kundërvihet memecërisë vetjake (Ahmatova: “Më shumë se gjithçkaje në botë i trembej memecërisë vetjake. E quante atë ‘mbytje marrafrymëse’”), mungesës së frymëzimit apo pengesës së tij, dhe shtron terrenin e krijimit artistik.

*Qëndro shkumë, o Afërditë,
Ti, kthehu në muzikë, o fjalë!
Dhe zemra, zemrës turp t’i ngjallë
Njësh me të jetës themelitë!*

Lutja që poeti i drejton perëndeshës dhe kërkesa e tij për kthimin e fjalës në muzikë motivohen me lutjen, kërkesën dhe nevojën e tij për t’u kthyer në artin e vërtetë, artin e fjalës ku fjala ka peshën dhe magjinë e saj primordiale, artin e pashkëputur nga harmonia melodike dhe lidhja shpirtërore me njerëzimin, artin që bashkohet e

⁹ Mandelshtam, Osip. “Fjala dhe kultura”, *Tristia* (poezi të zgjedhura, përkthyer nga Agron Tufa), Pika pa sipërfaqe, 2016, 260.

njëjtësohet me zemrën e njeriut dhe me themelet e jetës, artin letrar si krijim të mirëfilltë realitetesh të përtëjbotshme ku përthyeret bota e brendshme memece. “Unë nuk kam shkrim, sepse nuk shkruaj kurrë,” shprehet autori në “Prozën e katërt”. “Jam i vetmi në Rusi që punoj me zëtin... Çfarë drej shkrimtari qenkam unë!”¹⁰ Kjo prirje e poetit për të krijuar letërsi përmes zërit e jo përmes shkrimit dëshmon dhe manifeston pikërisht pikëpamjen e tij mbi artin dhe krijimin. Krijimi letrar për Mandelshtamin nuk mbyllet brenda kufijve hapësinorë të shkrimit e atyre kohorë të bashkëkohësisë, por i kapërcen ata dhe arrin komunikimin dhe bashkekzistencën me atë që gjendet përtej së ashtuquajturës “unë-këtu-tani”. “Poeti sintetik i bashkëkohësisë [...] [është] njëfarë Verleni i kulturës. Për të gjithë ndërlikimi i botës së vjetër – është po ajo gjajda pushkiniane. Në të këndojnë idetë, sistemet shkencore, teoritë shtetërore me po aq saktësi, sikundërse këndonin bashkëkohësit e tij, bilbilat dhe trëndafilat.”¹¹

Në këtë shkrirje të talentit krijues me heshtjen, si parakushte, lind krijimi i vërtetë artistik e letrar. Lind fjala, mendimi i ndërgjegjshëm, Logosi, poezia, qenësia... “Fjala është Psikeja. Fjala e gjallë nuk e shenjon sendin, porse e zgjedh lirisht, mu si për banesë bujtjeje, këtë apo atë kuptimësi sendore, gjësendi, një trup të dashur. Dhe përreth sendit fjala bredh lirisht, njashtu si shpirti përreth kurmit të braktisur, por të paharruar.”¹²

Ungjilli sipas Gjonit nis me Mëshërimin e Fjalës: “Në fillim ishte Fjala. Fjala ishte me Perëndinë. Fjala ishte Perëndi. Fjala ishte që në fillim me Perëndinë.”¹³ Paralelisht, fjala është ajo që lind në fillim krijimin (letrar por jo vetëm); ajo është me krijuesin (poetin), është krijuesi (poeti) dhe ka qenë që në fillim me krijuesin (poetin) dhe Poezia e vërtetë gjithmonë lind me Fjalën dhe përfundon me të, duke metamorfizuar heshtjen dhe memecërinë vetjake në *notën kristalore të kulluar njësh me të jetës themelitë...*

¹⁰ Shih: Tufa, Agron. *Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX*, Vëll. I, Botimet M&B, Tiranë, 2018, f. 103.

¹¹ Mandelshtam, Osip. “Fjala dhe kultura”, *Tristia* (poezi të zgjedhura, përkthyer nga Agron Tufa), Pika pa sipërfaqe, 2016, 264.

¹² Po aty, f. 263.

¹³ BIBLA, Shkrimi i Shenjtë. Besëlidhja e Re, Ungjilli sipas Gjonit 1:1-2 (përkthimi “Së Bashku”: Atë Joan Lena, Dom Marian Paloka, Pastor Zefjan Nikolla), Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë, 2020, f. 1259.



¹ Tufa, Agron. *Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX*, Vëll. I, Botimet M&B, Tiranë, 2018, f. 105

² Po aty.

³ Fragmentet e poezisë janë marrë nga: Mandelshtam, Osip. *Tristia* (poezi të zgjedhura, përkthyer nga Agron Tufa), Pika pa sipërfaqe, 2016, f. 47.

⁴ Shih: Mandelshtam, Osip. “Mëngjesi i Akemizmit”, *Tristia* (poezi të zgjedhura, përkthyer nga Agron Tufa), Pika pa sipërfaqe, 2016, 254.

⁵ Mandelshtam, Osip. “Fjala dhe kultura”, *Tristia* (poezi të zgjedhura, përkthyer nga Agron Tufa), Pika pa sipërfaqe, 2016, 261.

⁶ Tufa, Agron. *Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX*, Vëll. I, Botimet M&B, Tiranë, 2018, f. 104.

Panairi i Parë i librit shqip në New York

OPENING: FRIDAY, NOVEMBER 28!

Albanian BOOKFEST® 2025

FEDERATA PAN-SHQIPTARE
E AMERIKËS - "VATRA"



- ♦ Rrënjet Shqiptare ♦ Albanian/American student organizations at: Seton Hall University, Saint Francis College, Montclair State University, Fordham University
- ♦ Shoqata Rozafa ♦ Shoqata Malësia e Madhe ♦ Grupi Rozafati ♦ Shoqata Ana e Malit ♦
- ♦ Qendra Kulturore Nënë Tereza ♦ Shoqata Kraja ♦ Shkolla Shqipe "Alba Life" ♦
- ♦ Shoqata Skënderbej, Inc. ♦ Shkolla Shqipe "Gjergj Fishta" ♦ Shoqata Bijtë e shqipes ♦

email: albanianbookfest@gmail.com

MOTHER TERESA ALBANIAN CULTURAL CENTER
at Our Lady Of Shkodra Church
361 W. Hartsdale Ave., Hartsdale, NY

EVENT HOURS:
Saturday at 12 PM to 7 PM and Sunday 1 PM to 7 PM